

*Senad Maku*  
*Shpifjet ndaj të vërtetave Islame*

**Librin mund ta botoj çdo shtëpi botuese apo individ që dëshiron ta botoj, duke pasur parasysh jo për fitime materiale, por me kusht që libri të shpërndalet FALAS. Kontakto autorin në adresat elektronike të shënuara në këtë libër për tju dërguar verzionin komplet në word në rast botimi dhe për ta informuar në lidhje me botimin.**



Titulli:  
**Shpifjet ndaj të vërtetave Islame**  
Autori:  
**Senad Maku**  
E-Mail kontaktues:  
**senad\_maku@yahoo.com**  
**senadmaku@gmail.com**

Recensent:  
**Dr. Zija Abdullahu**

Redaktor gjuhësorë:  
**Feriz Gashi**

Realizimi kompjuterik:  
**Nuhi Simnica**

**[www.bibladhekurani.com](http://www.bibladhekurani.com)**  
**Shpërndalet FALAS**

Ribotimi dhe shumëzimi pa lejen e autorit nuk lejohet.  
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Senad Maku

# Shpifjet ndaj të vërtetave Islame

**Botimi i parë**

**Prishtinë  
2007**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*“Me emrin e Allahut, Bëmirësit të përgjithshëm,  
Mëshiruesit të posaçëm”*

### Parathënie

Falënderimi i takon Allahut të Madhërishëm, Krijuesit të kësaj gjithësie, ndërsa paqa, mëshira e Allahut qofshin mbi Pejgamberin, Muhamedin s.a.v.s, mbi familjen e tij, shokët e tij dhe mbi pasuesit e tij të ndershëm deri në përfundim të jetës së kësaj bote.

*“O Zoti ynë, na jep mëshirë dhe na udhëzo në rrugë të drejtë”.*

*Sa e njëjtë është e sotmja me të djeshmen!*

*Historia ripërsëritet!*

Si në të kaluarën, ashtu edhe sot sulmet ndaj fesë Islame nuk kanë të pushuar. Në përgjithësi, për Islamin është folur shumë herë vetëm në kontekstin negativ, duke shpifur e trilluar gjëra nga më të këqijat për të. Për islamin është shkruar mjaft dhe vazhdohet të shkruhet edhe sot nëpër mediat elektronike, gazeta e revista të ndryshme, të botuara qoftë nga individët, qoftë nga grupe individesh, të cilët kanë shprehur mendime nga më të ndryshmet; disa e kanë vlerësuar si fe të një kulture e civilizimi të prapambetur, si fe e dhunes dhe e fanatizmit, që pengon modernizimin e jetës, lirinë e të menduarit dhe të shprehurit; fe afriko-aziatike e, madje disa e kanë quajtur fe të Lindjes. Por, të

shkretët sikur harruakan se edhe fetë e tjera, si: Krishterimi apo Hebraizmi e kanë zanafillen po nga Lindja.

Kështu, sipas tyre, Islami na qenka fe e pasioneve të dobëta, e cila nëpër botë është përhapur me shpatë. Trillime e etiketime të këtij lloji vazhdojnë të thuhën edhe sot për Islamin. Asnjë fe në botë s’është interpretuar në mënyrë kaq tendecioze; asnjë feje në botë nuk i janë adresuar aq shumë fyerje e urrejtje sa fesë Islame. Në këtë mënyrë shpifësit dhe trilluesit, mundohen që t’ua mohojnë Islamit dhe Kur’anit të Madhërishëm burimin Hyjnor, Muhamedit s.a.v.s. pejgamberinë, kurse muslimanët t’ua paraqesin si idhujtarë dhe heretikë. Po, megjithëkëtë emri i Muhamedit s.a.v.s. vazhdoi dhe vazhdon të përmendet më shumë se emri i cilësdo krijesë tjetër, kurse udhëzimi dhe drita Hyjnore që ai solli, edhe sot e kësaj dite vazhdon të ndriçojë zemrat e pastra dhe fisnike të miliona e miliarda njerëzve për 14 shekuj.

Shtrembërimet që iu bënë Islamit e Kur’anit nga shpifësit, kishin dhe kanë për qëllim zhvlerësimin e realitetit të Kur’anit si libër Hyjnor dhe Muhamedin s.a.v.s. si i dërguari i Zotit, duke i paraqitur në mënyrë jo objektive dhe të pandershme. Në lidhje më këtë shkencëtari dhe profesori i Universitetit të Parisit dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës, Dr. Maurice Bucaille, thotë: *“Sikur shumica e njerëzve në Perëndim, edhe unë kam mundur t’i ruaj të njëjtat ide të gabuara dhe aq shumë të përhapura për Islamin deri në ditët tona. Kështu, pra, e pranoj se isha një injorant i madh para se të krijoja për islamin pikëpamje*

*çfarë i kam sot, të drejta dhe objektive. Nëse kam pasur pak ndikim apo kam hezituar lidhur me Kur'anin, atëherë ka qenë ajo çka më kishin mësuar në rininë time; Kurrë nuk më flisnin për muslimanët, por vetëm për muhamedanët, duke e theksuar posaçërisht atë se është fjala për religjionin të cilin e ka themeluar një njeri, dhe i cili nuk ka kurrfarë vlere karshi Zotit.... Unë përsëris konstatimin tim se në Kur'an nuk është futur dora e njeriut, por ai tekst është shpallje Hyjnore, dhe për këtë s'ka dyshim".<sup>1</sup>*

Rreth imazheve të pavërteta që u serviren amerikanëve edhe sot e kësaj dite për Islamin, Paul Findley, anëtar i Kongresit amerikan që 22 vjet, thotë: *"Imazhet e rreme për Islamin që nga vegjëlja vazhduan të ruhen kaq gjatë në mendjen time, sa që sot nuk më bën përshtypje kur njihem me amerikanë të tjerë që kanë botëkuptime të ngjashme. Është për t'u habitur kur mendon për numrin tejet të madh të stereotipeve dezinformuese që kanë vazhduar për islamin, të pacënuara vit pas viti, gjatë orëve të mesimit të së dielës në të gjithë Amerikën. Miliona të rinj mund t'i kenë pranuar informacionet e rreme si të vërteta dhe gjatë viteve ua kanë kaluar të papërmirësuar miliona njerëzve të tjerë".<sup>2</sup>*

Dokumenti i Vatikanit, i vitit 1970 òOrientimi për dialog në mes të të krishterëve dhe muslimanëveò, i lëshuar pas Koncilit të Dytë të Vatikanit, dëshmoi ndryshimin the-

<sup>1</sup> Dr. Maurice Bucaille, *"Bibla, Kur'ani dhe Shkenca"*, Gjakovë, fq. 6.

<sup>2</sup> Paul Findley, *"Mjaft me heshtje"*, Shqipëri 2004, fq. 22.

lbësor të opinionit për muslimanët. Ky dokument, në formë të rezolutës, e mori përgjegjësinë e pranimit të padrejtësisë që i është bërë islamit në të kaluarën, duke dhënë një mesazh të qartë; *"Të lirohemi nga paragjykimet ndaj islamit"*.<sup>3</sup>

Duke pasur parasysh etiketimet dhe trillimet e shumta që po i bëhen Islamit në përgjithësi, si dhe shpifjet e shumta që po i adresohen kësaj feje, punimin e kemi ndarë në tre kapituj dhe kemi trajtuar dy nga çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me Kur'anin Famëlartë dhe më të dërguarin e Zotit, Muhamedin s.a.v.s..

Në kapitullin e parë kemi folur për shpifjet dhe trillimet që i bëhen Kur'anit Famëlartë rreth burimit të tij; kemi dhënë kritika dhe kundërpërgjigje ndaj këtyre shpifjeve, kurse në kapitullin e dytë kemi folur për shpifjet që i adresohen Muhamedit s.a.v.s. rreth martesave të tij me shumë gra, duke e etiketuar si njeri i dhënë pas epsheve dhe dëshirave seksuale.

Në kapitullin e tretë kemi veçuar disa nga thënie të objektive të mendimtarëve me famë botërore rreth Islamit, Kur'anit dhe Muhamedit s.a.v.s.

Këtë punim e kam ilustruar me citate Kur'anore dhe me pjesë nga jeta e tradita e të dërguarit të Zotit, Muhamedit s.a.v.s. Poashtu kam përdorur edhe citate nga Bibla, komente, sqarime dhe mendime të ndryshme të personaliteteve të shquara, qofshin ata muslimanë apo jomuslimanë,

<sup>3</sup> Dr. Maurice Bucaille, *vep. e cit.*, fq. 10.

që përmbajtja e tekstit të jetë sa më e qartë dhe punimi të jetë sa më shkencor .

Shpresoj se lexuesi i ndershëm do ta kuptojë se e vërteta që kemi thënë ne për Islamin qëndron më lart dhe më fuqishëm nga çqëndrojnë gënjeshttrat dhe shpifjet që janë thënë për të nga misionarë e njerëz që islamin nuk e shohin dot.

Urrejtja e thellë që i ka kapluar zemrat e shpifësve, ua ka verbuar sytë dhe nuk shohin të vërtetën e ndritshme. Allahu xh.sh. thotë:

بَلْ نَقْذِفُ بِالْحَقِّ عَلَى الْبَاطِلِ فَيَدْمَغُهُ فَإِذَا هُوَ زَاهِقٌ ﴿١٨﴾

**“Përkundrazi, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën dhe ajo (e vërteta) triumfon mbi të, ndërsa ajo (gënjeshttra) zhduket”.** (Kur'an; Sure: El Enbija, Ajeti: 18)<sup>4</sup>

Në këtë punim kam dhënë vetëm disa nga argumentet që flasin të vërtetën për Islamin dhe hedhin poshtë të gjitha trillimet e poshtërimet që i bëhen atij nga njerëz të pandërgjegjshëm .

Në fund, lus Allahun xh.sh. ta pranojë këtë punim modest e të thjeshtë dhe të na shpërblejë me të mirat e Tij si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Nëse në punimin tim ka ndonjë të metë në të, atëherë, kjo vjen nga dija ime e kufizuar dhe njerëzore.

Senad Maku  
Ulqin 2007

<sup>4</sup> Citimet e Kur'anit në gjuhën shqipe janë marrur nga Kur'ani-Përkthim me komentim i H. Sherif Ahmetit.

## Fenomeni i shpifjeve ndaj Kur'anit Famëlartë

### Hyrje

Kur'ani dhe prejardhja e tij janë çështjet kryesore, për të cilat kundërshtarët e tij kanë shprehur më së shumti dyshime. Disa persona të caktuar, me një mendjengushtësi dhe gjykim jo të kthjellët, mundohen që të mbjellin farën e dyshimit mbi autenticitetin (vërtetësinë) e tij si Libër Hyjnor. Shumë libra dhe revista e paraqesin Kur'anin si një vepër të mendjes njerëzore, krijuar prej një òmashtuesiò të Pejgamberisë. Shpifje dhe keqinterpretime të tilla ndaj fesë Islame hasim edhe në literaturën shqipe, p.sh. tek òÇeta e profetëve e Pjetër Bogdanit. Kohët e fundit edhe shtëpia botuese òTendaò në Prishtinë, e cila luan rrolin e tutorit, e udhëhequr nga një grup njerëzish antiislamë, ka botuar një seri librash përplot shpifje e të pavërteta rreth Kur'anit dhe parimeve të fesë Islame në përgjithësi<sup>5</sup>. Një luftë e pandershme kulturore-antiislame kohët e fundit po bëhet edhe

<sup>5</sup> Ndër librat e botuara kundër Islamit nga kjo shtëpi botuese veçojmë: a) A është Kurani fjalë e Perëndisë; b) Bibla dhe Kurani -një krahasim historik; c) Muhamedi- A është profet; d) Embrionologjia e Kuranit; e) Mbi Kurani; f) Perënditë paraislame të arabëve, etj.

nëpërmjet masmediave të ndryshme. Përpjekjet e tyre të jashtzakonshme dhe puna e madhe që kanë kryer, ka patur një objektiv të qartë: atë të çoroditjes së njerëzve të thjesh-të e të pafajshëm nën maskën e punimeve shkencore. Shpeshherë qëllimet dhe idetë e tyre janë mbështetur e përkrahur edhe nga emra muslimanë. Në këtë menyre ata kinse provojnë se idetë e tyre, të krijuara me kaq mund, përqafohen edhe prej muslimanëve òtë zhvilluar e me horizontò.<sup>6</sup>

Disa nga njerëzit, megjithëse veten e konsiderojnë si muslimanë, kanë shpërfillur parimet bazë të fesë islame, qoftë për qëllime politike, qoftë për qëllime financiare. Disa të tjerë shprehin dyshimin se Muhamedi s.a.v.s. është autori i vetëm i këtij libri. Por, shpifjeve dhe trillimeve të tilla Allahu xh.sh. u është përgjigjur në këtë mënyrë në Kur'anin Famëlartë:

وَمَا كَانَ هَذَا الْقُرْآنُ أَنْ يُفْتَرَىٰ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلَكِنْ تَصْدِيقَ الَّذِي  
بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ الْكِتَابِ لَا رَيْبَ فِيهِ مِنَ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٦٧﴾ أَمْ  
يَقُولُونَ أَفْتَرَلَهُ قُلْ فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِّثْلِهِ وَادْعُوا مَنْ اسْتَطَعْتُمْ مِنْ دُونِ  
اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٦٨﴾ بَلْ كَذَّبُوا بِمَا لَمْ يُحِيطُوا بِعِلْمِهِ وَلَمَّا يَأْتِهِمْ  
تَأْوِيلُهُ ۗ كَذَلِكَ كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ

<sup>6</sup> Hamza Mustafa Nijazi, "Burimet e Kur'anit", Mitrovicë 1996, fq. 1.

الظَّالِمِينَ ﴿١٨﴾ وَمِنْهُمْ مَنْ يُؤْمِنُ بِهِ ۗ وَمِنْهُمْ مَنْ لَا يُؤْمِنُ بِهِ ۗ

وَرَبُّكَ أَعْلَمُ بِالْمُفْسِدِينَ ﴿١٩﴾

**“Nuk është e logjikshme të mendohet se ky Kur’an është i trilluar prej dikujt pos All-llahut, por është vërtetues i asaj (shpalljes) që ishte më parë, dhe sqarues e komentues i librit. Nuk ka farë dyshimi se është (i zbritur) nga Zoti i botëve.**

**Përkundër kësaj, ata (idhujtarët) thonë se atë e trilloi ai (Muhammedi). Ti thuaj: “Sillne pra ju një kaptinë të ngjajshme me këtë, madje thirrni kë të doni në ndihmë, pos All-llahut, po qe se jeni të drejtë në atë që thoni”.**

**Por ja, ata përgënjeshtrojnë atë (Kur’anin) pa e kuptuar dhe pa ju ardhur shpjegimi i tij. Po kështu, gënjenin dhe ata që ishin më përpara. Shiko si ishte përfundimi i zullumqarëve.**

**Ka prej tyre (te të cilët u dërgua Muhammedi) që e besojnë atë (Kur’anin), e ka prej tyre edhe asish që atë nuk e besojnë. Zoti i njeh më së miri kokëfortit”. (Junus 37-40).**

لَا يَأْتِيهِ الْبَطْلُ مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَلَا مِنْ خَلْفِهِ ۗ

تَنْزِيلٌ ۗ ) ) ) ) ) ) ) ) ) ) ) ) ) ) ) ) )

**“Atij nuk mund t’i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të lavdishmit”. (Fussilet 42).**

بَلْ نَقَدِفُ بِالْحَقِّ عَلَى الْبَاطِلِ فَيَدْمَغُهُ، فَإِذَا هُوَ زَاهِقٌ ﴿١٨﴾

**“Përkundrazi, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën dhe ajo (e vërteta) triumfon mbi të, ndërsa ajo (gënjeshtera) zhduket”. (El Enbija 18).**

### A është Muhamedi autorë i Kur’anit

Teoria më e përhapur midis jomuslimanëve është ajo se “Muhamedi është autor i Kur’anit”. Për ta kuptuar pozicionin e tyre është e rëndësishme të kemi parasysh se çfarë thotë Kur’ani për burimin (originën) e tij. Allahu në Kur’anin Famëlartë thotë:

إِنَّهُ لَقُرْءَانٌ كَرِيمٌ ﴿٧٧﴾ تَنْزِيلٌ مِّن رَّبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٧٨﴾

**“Se me të vërtetë ai është Kur’an i famshëm”.**

**“Është i zbritur prej Zotit të botëve”. (El Vakia 77,80).**

وَإِنَّهُ لَتَنْزِيلُ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٨٢﴾ نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ ﴿٨٣﴾

**“E edhe ai (Kur’ani) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve. Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili)”. (Esh Shuaraë 192-193).**

Mënyra se si thuhet kjo, të jep përshtypjen se këto janë fjalë të Krijuesit drejtuar krijesave të tij. Të gjithë kapitujt përveç kapitullit të 9-të fillojnë me formulën:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**“Me emrin e Allahut, Bëmirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit të posaçëm”.**

Pretendimi se Muhamedi s.a.v.s. ka shkruar Kurʿanin nuk është i sotëm; ai daton që nga koha e Pejgamberit. Një pretendim të tillë e kishte shprehur madje edhe vetë populli i tij.

Për të hedhur poshtë këto pretendime, Allahu Fuqiplotë i kërkoi Pejgamberit, Muhamedit s.a.v.s., t’i drejtohet popullit me fjalët:

وَإِذَا تَتَلَّىٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُنَا بَيِّنَاتٍ قَالَ الَّذِينَ لَا يَرْجُونَ لِقَاءَنَا آتَتْ بِقُرْآنٍ غَيْرِ هَذَا أَوْ بَدَّلَهُ ۗ قُلْ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أُبَدِّلَهُ مِنْ تَلْقَائِي ۚ نَفْسِي إِنِّي أَتَّبِعُ إِلَّا مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ ۚ إِنِّي أَخَافُ إِنْ عَصَيْتُ رَبِّي عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿١٥﴾ قُلْ لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا تَلَوْتُهُ عَلَيْكُمْ وَلَا أَدْرَأْتُكُمْ بِهِ ۚ فَقَدْ لَبِثْتُ فِيكُمْ عُمُرًا مِّن قَبْلِهِ ۚ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿١٦﴾

**“Dhe kur atyre u lexohen ajetet Tona të qarta, ata që nuk besojnë takimin Tonë (ringjalljen), thonë: “Sillna një Kur’an tjetër, ose ndryshojë këtë!” Thuaj: “Mua nuk më takon që ta ndryshojë vetë, unë përcjelli vetëm atë që më shpallet, unë nëse kundërshtoj Zotit tim i frikësohem dënimit të një Ditës të madhe.**

**Thuaj: “Sikur të kishte dashur All-llahu, unë nuk do t’ua kisha lexuar juve atë, as nuk u kisha njoftuar me të. Unë para tij kam jetuar në mesin tuaj (as nuk ditur as nuk kam lexuar), a nuk mendoni?” (Junus 15-16).**

Dihet se Muhamedi s.a.v.s. ishte një njeri që nuk dinte shkrim e lexim. Ai jetoi mes popullit të tij dyzet vjet pa

treguar as edhe njëherë ndonjë shenjë të madhe të dijes. Prandaj, si mund të shpjegohet që ai arriti të shkruante Kurʿanin, madhështia e të cilit është e pakrahasueshme? Besojmë se ky është një argument i fuqishëm që hedh poshtë pretendimet e atyre që thonë se Kurʿani është libër i Muhamedit s.a.v.s.

Thomas Carlyle në lidhje me arsimimin e Muhamedit s.a.v.s. ka thënë: *“Nuk duhet të harrojmë edhe një rrethana: se ai nuk ka vijuar shkollën; atë që ne e quajmë shkollim, ai kurrë nuk e ka bërë”*.<sup>7</sup> Poashtu Inxhinieri dhe studiuesi me origjinë çifute, Dr. A.N. Sousa, në lidhje me këtë thotë: *“Zoti i Madhëruar, mrekullinë e Kur’anit dhe analfabetizmin e Muhamedit, i ka bërë argument për vërtetësinë e pejgamberisë së tij dhe për vërtetësinë Hyjnore të Kur’anit”*.<sup>8</sup>

Se Pejgamberi, Muhamedi s.a.v.s., nuk dinte shkrim e lexim, këtë e dëshmon edhe Allahu në Kurʿanin Famëlartë:

وَمَا كُنْتَ تَتْلُوا مِنْ قَبْلِهِ ۚ مِنْ كِتَابٍ وَلَا تَخْطُهُ بِيَمِينِكَ ۚ إِذَا لَأَرْتَابَ الْمُبْطُلُونَ ﴿٢٤﴾

**“Ti (Muhammed) nuk ishe që lexon ndonjë libër para këtij, e as që shkruajshe atë me dorën tënde të djathtë, pse atëherë do të dyshonin ata të prishurit”.** (El-Ankebutë 48).

<sup>7</sup> Ahmed Deedat, *“Kur’ani- Mrekullia e mrekullive”*, Podujevë, fq. 13.

<sup>8</sup> Ajmi Sinani, *“Të tjerët për Islamin”*, Prishtinë 2005, fq.108.



Atëherë si mund të jetë e arsyeshme dhe a mund të pranojë logjika që një njeri që nuk dinte shkrim-lexim të jetë autor i një libri kaq madhështor, plotë dituri e përkushtim dhe sfidues i gjithësisë si Kur'ani?

Një njeri i paarsimuar, pa parë derën e shkollës, të sjellë e të predikojë një sistem individual, familjar, shoqëroro-ekonomik dhe juridik, pa të meta, kjo bie në kundërshtim me aparencën mendore e logjike, sidomos po të jetë ky sistem aq i shkëlqyer, sa të zbatohet për shekuj të tërë nga një sërë kombesh miq e armiq midis tyre e të ruajë gjer më sot freskin e vet!<sup>9</sup>

Si dje, ashtu edhe sot është po ai Person i pa shkrim e i palexim që vazhdon t'ia sfidojë të gjitha ç'janë shkruar e thënë nga dijetarët dhe letrarët më të mëdhenj të të gjitha kohëve. Sot, kur në përgjithësi pranohet se shkencat kanë arritur një zhvillim të madh, ai sikur u thotë fizikantëve, kimistëve, astronomëve, mjekëve, sociologëve, poetëve e shkrimtarëve, të gjithëve: “*Bëhuni bashkë e sillni jo shumë, por vetëm një pjesë, sa një sure e Kur'anit!*”.<sup>10</sup> Në Kur'anin Famëllartë Allahu xh.sh. i kërkon Muhamedit s.a.v.s. që tu drejtohet atyre që pretendojnë se Kur'ani është vepër e njeriut, me fjalët:

<sup>9</sup> M. Fethullah Gylen, “*Lëkundjet që solli shekulli*”, Tiranë 1998, fq. 93.

<sup>10</sup> M. Fethullah Gylen, “*Nen hijen e Besimit- 2*”, Tiranë 2004, fq. 129-130.

قُلْ لِّئِنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَىٰ أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا ﴿٨٨﴾

**Thuaj: “Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky sado që do ta ndihmonin njëri-tjetrin”. (El Israë 88).**

أَمْ يَقُولُونَ أَفَرَّغْنَا قُلُوبَنَا بِعَشْرِ سُوْرٍ مِّثْلِهِ مُفْتَرِيْنَ وَادْعُوا مَنْ أَسْتَطَعْتُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِيْنَ ﴿١٣﴾

**“Apo, pse ata thonë: “Ai (Muhamedi) e trilloi atë (Kur'anin)”. Thuaj: “Formuloni pra, dhjetë kapitina si ai (Kur'ani) ashtu të trilluara (siç thoni ju) dhe thirrni, pos All-llahut, po qe se jeni të drejtë (çka thoni), kë të mundeni për ndihmë!” (Hudë 13).**

وَإِنْ كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِّمَّا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَأْتُوا بِسُوْرَةٍ مِّثْلِهِ

وَادْعُوا شُهَدَاءَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِيْنَ ﴿٢٣﴾

**“E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillnie ju një kapitinë të ngjashme si ai (Kur'ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) pos All-llahut, nëse jeni të sinqert (në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit)”. (El Bekare 23).**

أَمْ يَقُولُونَ افْتَرَاهُ ۗ قُلْ فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِّثْلِهِ ۚ وَادْعُوا مَنِ اسْتَلَطَعْتُمْ مِنْ

دُونِ اللَّهِ ۚ إِنَّ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٣٨﴾

**“Përkundër kësaj, ata (idhujtarët) thonë se atë e trilloi ai (Muhammedi). Ti thuaj: “Sillne pra ju një kaptinë të ngjajshme me këtë, madje thirrni kë të doni në ndihmë, pos All-llahut, po qe se jeni të drejtë në atë që thoni”.** (Junus 38).

Ndryshimi ndërmjet mënyrës së shprehjes së Kurʿanit dhe mënyrës së shprehjes së Pejgamberit s.a.v.s. Muhamed dallohen mjaft lehtë. Ndërmjet stilit gjuhësor e letrar të Kurʿanit dhe stilit gjuhësor e letrar të hadithëve (porosive) të Pejgamberit s.a.v.s., ka një ndryshim shumë të madhë. Gjuha e hadithëve të pejgamberit ishte shumë më e kuptueshme, karshi shprehjeve Kurʿanore, nga të cilat habiteshin dhe mahniteshin edhe vetë arabët. Duke lexuar porosinë e Pejgamberit s.a.v.s., kuptohet qartë se aty pervijohet imazhi i një njeriu që mendon e bisedon i përlurur nga frika e Allahut xh.sh., kurse në zërin e Kurʿanit ndihet një guxim i lartë, një vizion tronditës e një tingëllim madhështore. Logjikisht, nuk është as e mundur dhe as e pranueshme që në shprehjen e një njeriu të sendërtohen aty për aty dy stile aq të ndryshme nga njëra-tjetra.<sup>11</sup> Këtu shihet se Muhamedi është një njeri si të tjerët, me dallimin e vetëm se atij i shpallet, relevatë nga Zoti xh.sh., gjë të cilën e pohon vetë Kurʿani:

<sup>11</sup> M. Fethullah Gylen, “Lëkundjet që solli shekulli”, fq. 93.

قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُكُمُ إِلَهُهُ ۚ وَاحِدٌ ۗ

فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا

وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ ۚ أَحَدًا ﴿١١٠﴾

**“Thuaj: Unë jam vetëm njeri, sikurse ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos përziejë askë”.** (El Kehf 110).

Dhe, në fund, përse askush dhe asnjëherë nuk e dëgjoj Muhamedin s.a.v.s. të pranonte apo të theksonte se ai vetë ishte autor i Kurʿanit?

## Përfitimi material si motiv?

Shpifja tjetër që i adresohet Muhamedit s.a.v.s. është ÷përfitimi material si motiv. Ndoshta Muhamedi a.s. ishte dhënë pas pasurisë, ndaj ia atriboi Kurʿanin Allahut xh.sh. me qëllim që të përfitonte më tepër”. Megjithatë kjo hipotezë nuk përputhet me faktet historike.

Për ata që e njohin mënyren e të jetuarit të Muhamedit, vetëm aludimi në përfitimin material është një ofendim i rëndë. Në dokumentet historike është përshkruar në detaje mënyra e tij e të jetuarit, si para pejgamberisë, ashtu edhe gjatë pejgamberisë e deri në vdekjen e tij. Nuk ka dyshim, Muhamedi s.a.v.s. ishte i pasur edhe para se te shpallej

Pejgamber; ai ishte martuar me Hatixhen r.a., e cila ishte mjaft e pasur.<sup>12</sup>

Pra pozita financiare e Muhamedit s.a.v.s. ishte shumë më e mirë përpara sesa gjatë Pejgamberisë së tij. Në moshën 25 vjeçare (15 vjet para se ai të shpallej Pejgamber) u martua dhe pati jetë të rehatshme me Hatixhen r.a., e cila ishte një tregtare e pasur. Gjatë Pejgamberisë së tij, standarti i jetës dhe gjendja e tij financiare nuk ishin për t'atatur zili.

Transmetohet shpeshherë që ushqimi i tij i vetëm ditor ishin ca hurma. Një nga gratë e Pejgamberit s.a.v.s. tregonte se zjarri në shtëpinë e tyre ndodhte të mos ndizej një deri në dy muaj, ngaqë nuk kishin asgjë për të gatuar. I vetmi ushqim për të jetuar ishin hurmat dhe uji. Nganjëherë këtij ushqimi i shtohesh edhe qumështi i dhisë, të cilin ia dhuronte populli i Medinës.

Umeri r.a. tregon: *“Vërtet e kam parë të dërguarin e Allahut s.a.v.s. gjatë tërë ditës, me barkun e ngjitur nga uria; nuk kishte as hurma të këqija që ta mbushte barkun e tij”*.<sup>13</sup>

Martin Lingsi në librin e tij: *öMuhamedi a.s., Jeta e tij, bazuar mbi burimet më të hershme, thotë: “Pejgamberi dhe familja e tij jetonin një jetë plot kursime. Aisha tregon se përpara pushtimit të Kaiberit ajo nuk kishte ngrënë*

<sup>12</sup> Edukata Islame, nr. 24, fq. 12; Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *“Kush e shkroi Kur'anin”*, Prishtinë 2006, fq. 13.

<sup>13</sup> Imam Nevevi, *“Rijadus-Salihin”*, Prishtinë 1997, hadithi nr. 477 (shiko dhe hadithet 474-478).

*kurrë hurma, sa të ngopej. “Varfëria e këtyre njerëzve ishte e tillë, sa që gratë e Pejgamberit nuk i kërkuan kurrë atij ndonjë gjë, përveç atyre gjërave më të nevojshme për të jetuar”*.<sup>14</sup>

Enesi thotë: *“Nuk e di ndonjëherë Resulullahu s.a.v.s. në jetën e vet të ketë parë në shtëpinë e vet pogaçe të butë dhe taze, samun apo dele të tërë të pjekur”*.

Ajshja r.a. ka thënë: *öNë shtëpinë e Resulullahut s.a.v.s. rrallëherë ndizej zjarri, ndoshta, dy-tri herë në dy muaj”*. Urvetja e kishte pyetur: *“E me çka ju ushqente?”* Ajshja i ishte përgjigjur: *“Me hurma dhe me ujë”*.<sup>15</sup>

öShumë herë Pejgamberi s.a.v.s. dhe familja e tij flinin krejtësisht të uritur dhe mbulonin trupin e tyre me robe të arnuara.<sup>16</sup>

Omeri r.a. e përshkruan dhomën e Muhamedit s.a.v.s. si një kthinë skajshmërisht të varfër, me tri lëkura të thara bagëtie për shtrirje dhe një grusht elb për ushqim diku në qoshe. Duke parë gjendjen e rëndë në të cilën jetonte Pejgamberi, sytë e Omerit ishin mbushur me lotë. Muhamedi s.a.v.s. i kishte thënë: *öPërse po qan?ö* Omeri i ishte përgjigjur: *öO Pejgamber i Allahut! E si të mos qaj kur shoh se në çgjendje ndodhesh. O Pejgamberi i Allahut! Lutu që Allahu të na japë ushqim të mjaftueshëm. Si ka mundësi që Persianët dhe Bizantinët, të cilët nuk kanë fe të vërtetë*

<sup>14</sup> Hamza Mustafa Nijazi, *Vep. e cit.*, fq. 16.

<sup>15</sup> Saffijurrahman El-Mubarekkfuri, *“Nektari i vulosur i xhenetit”*, Prishtinë 2001, fq. 559.

<sup>16</sup> Edukata Islame, nr. 24, fq. 13.

dhe nuk adhurojnë Allahun, por mbretërit e tyre, Kaizerin dhe Kohesrohen, të jetojnë në kopshte të lulëzuara e buzë shadërvanëve të pastër, ndërsa Pejgamberi i zgjedhur dhe robi i nënshtruar i Allahut të jetojë në varfëri të plotë! Pejgamberi i ishte përgjigjur: *“O Omer akoma vazhdon të dyshosh për këtë gjë? Qetësia dhe rehatia në botën e përtejme janë shumë më të mira se qetësia dhe rehatia në këtë jetë. Të pafetë po shijojnë shumë të mira në këtë botë, ndërsa për ne të gjitha këto të mira janë rezervuar në jetën tjetër”*.<sup>17</sup>

Kur Muhamedi s.a.v.s. filloi të thërriste arabët tek Zoti i vetëm i vërtetë, ata i premtuan gjithçka, vetëm të hiqte dorë nga ky mision. I premtuan pasuri të pafundme, gratë më të bukura, pozitën më të lartë, por ja çfarë ishte përgjigja e Pejgamberit, Muhamed s.a.v.s.: *“Sikur të më jepni hënën në krahun e majtë dhe diellin në krahun e djathtë, unë nuk do të heq dorë nga thirrja e Allahut”*.<sup>18</sup> Cfarë nënshtrimi prekës!

Muhamedi s.a.v.s., sa herë që merrte ndonjë dhuratë, (si në rastin kur kryetari i Fidakut i dhuroi 4 deve të ngarkuara me mall) ai ua shpërndante të varfërve dhe s'pranonte të merrte asgjë për vete. Kur Muhamedi s.a.v.s. vdiq, nuk kishte kurrfarë parash. Pasuria e vetme e tij ishin 7 dinarë,

<sup>17</sup> Hamza Mustafa Nijazi, *Vep. e cit.*, fq. 18; Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *Vep. e cit.*, fq. 14.

<sup>18</sup> Për më tepër lexo te, Saffijjurrhman El-Mubarekfuri, *“Nektari i Vulosur i Xhennetit”*, fq. 114; Edukata Islame, nr. 24, fq. 12; Halil Ibrahim, *“Islami dhe Krishterimi”*, fq. 44.

të cilat ai ua shpërndau të varfërve disa ditë përpara se të vdiste, duke patur frikë se mos i linte prapa.<sup>19</sup>

Ka gjithashtu edhe mjaft raste të tjera, të cilat tregojnë se jeta e Muhamedit s.a.v.s., nga fillimi i Pejgamberisë së tij e deri në vdekje, ishte një jetë e një njeriu që kurseu shumë, dhe ia privoi vetes shumë gjëra. Ideja se qëllimi i tij ishte përfitimi material, nuk përputhet me faktet historike. Kjo vërehet fare mirë edhe tek Enciklopedia e Re Katolike, vol I, fq. 1001: *“Thuhet se frymëzimi kryesor që e shtyu Muhamedin për të kryer revolucionin e tij fetar, ishte thjeshtë përfitimi ekonomik. Kjo hipotezë nuk u përshtatet fakteve që ne njohim”*.<sup>20</sup>

### Dëshira për pushtet dhe lavdi?

Shpifja tjetër është se *“Dëshira për pushtet dhe lavdi e shtyu Muhamedin s.a.v.s. të përpilonte Kur'anin”*. Poashtu edhe kjo hipotezë nuk përputhet me faktet historike. Ai për vite të tëra përjetoi fyerje nga arabët, megjithëse mund të ishte prijës i tyre, sepse një gjë të tillë ia kishin afruar vetë arabët. Edhe kur u bë udhëheqësi i tërë muslimanëve, mbeti po i njëjti. Karakteri i tij tregon qartë se ai nuk ishte i etur për pushtet e as për lavdi personale.

Muhamedi s.a.v.s. ishte një shembull i mahnitshëm modestie. Me gjithë rangun shoqëror, si pejgamber që ishte dhe me gjithë përgjegjësinë e madhe, si burrë shteti, Mu-

<sup>19</sup> Hamza Mustafa Nijazi, *“Burimet e Kur'anit”*, fq. 18.

<sup>20</sup> Po aty, fq. 19.

hamedi s.a.v.s. angazhohej edhe në punët e shtëpisë. Ai kujdesej për veshjet, riparonte këpucët dhe milte dhinë e tij.

Erdhi një kohë kur muslimanët, në shenjë respekti, filluan të çohen në këmbë sa herë që ndodheshin para tij, por Pejgamberi s.a.v.s. ua ndaloi një gjë të tillë. Poashtu Pejgamberi s.a.v.s. punonte bashkë me shokët e tij, edhe pse ata nuk dëshironin ta lejonin të punonte krah me ta. Po, në të tilla raste Muhamedi s.a.v.s. u përgjigjej: *“E di që doni të më bëni një nder, por nuk do të doja”*.

Pasuesit e tij ishin gjithmonë të gatshëm t’i bindeshin, por ai gjithmonë ngulte këmbë se bindja duhej treguar ndaj Allahut xh.sh. e jo ndaj tij personalisht. Njëherë atij iu afrua një i huaj, i cili pothuajse dridhej nga nderimi që kishte për të dhe Muhamedi s.a.v.s., ngrohtësisht, ia hodhi dorën në qafë, duke i thënë: *“Qetësohu vëlla, unë jam vetëm biri i një gruaje e cila e hante bukën thatë”*.<sup>21</sup>

Muhamedi s.a.v.s. kishte urdhëruar që varri dhe personaliteti i tij të mos ktheheshin në idhull pas vdekjes së tij. *“Mos e ktheni varrin tim në një vend adhurimi”, “Mos më lëvdoni mua ashtu siç lëvdonjë krishterët Isain, birin e Merjemes, por thoni: Ai ishte rob i Allahut dhe lajmëtar i Tij”*.

Ata që thonë se Muhamedi e shkroi vet Kur’anin me qëllim që ti kënaqte ambicjet e tij për pushtet dhe lavdi, mund t’u them: Muhamedi s.a.v.s. natyrisht që do ti kishte

<sup>21</sup> Po aty, fq. 21.

hequr nga Kur’ani ato ajete të cilat mund të binin ndesh me ambicjet e tij. Por ai nuk e bëri këtë. E përse duhej të shkruante ai një libër i cili e detyronte t’i thoshte popullit se ai ishte i pafuqishëm dhe nuk dinte asgjë mbi forcat e mistershme, se ai nuk kishte sjellë asnjë doktrinë (parim) të re; se nuk di të shkruante dhe të lexonte dhe se ky libër nuk ishte fjalë e tij? (shih ajetet: Araf 188, Huxhurat 6, Kasas 86, Kehf 110, En’ām 50 etj.). Po të jetë se Muhamedi s.a.v.s. pati për motiv, gjatë shkrimit të Kur’anit, dëshirën e marrë për pushtet, atëherë është mjaft e vështirë të shpjegohet ekzistenca e këtyre ajeteve.<sup>22</sup>

### **Bashkimi dhe çlirimi i arabëve?**

Teoria se *“Muhamedi s.a.v.s. e përpiloi Kur’anin me qëllim që t’i bashkonte dhe çlironte arabët”*, është e vështirë të mbrohet, sepse bashkimi i arabëve nuk ishte qëllimi i tij. Ideja që qëndron në thelb të Kur’anit, është një bashkim i njerëzve nën ombrellën e ligjit të Allahut, pa dallim ngjyre, race apo kombi. Po të jetë se uniteti i arabëve ishte ëndërra e përhershme e Muhamedit s.a.v.s., atëherë ai do ta kishte pranuar mjaft mirë ofertën për t’u bërë mbret i Arabisë dhe në këtë mënyrë do ta përdorte pushtetin dhe influencën e tij për të ndërtuar një Arabi të bashkuar. Por, Muhamedi s.a.v.s. e refuzoi një ofertë të tillë. Kështu, të pohosh se Muhamedi s.a.v.s. kishte për qëllim arritjen e

<sup>22</sup> Po aty, fq. 23.

pushtetit, lavdisë, apo bashkimin e arabëve nëpërmjet të të shkruarit të Kur'anit dhe atribuimin e tij Allahut, është një naivitet i paskrupull.

Henri De Kastro, kur flet për Muhamedin ndër të tjera thotë: “Nuk qe i dhënë pas stolive të kësaj bote dhe nuk ishte koprac. Ishte i përmbajtur dhe derisa u largua nga kjo botë, asnjëherë nuk u ngop me bukë elbi. Iu shmang ambicieve të kota, megjithatë arriti dhe ia doli të zërë vendin më të lartë në vendet arabe. Por, ai nuk u dha pas totalitarizmit. Nuk pati fron, ministri dhe as gradë”.<sup>23</sup>

Faktet e tjera që hedhin poshtë tezën se Muhamedi s.a.v.s. është autor i Kur'anit, është se vetë Muhamedi korrigjohet nga Kur'ani për veprimet e tij. Për këtë mjafton të përmendet rasti kur Hamza r.a., axha i Pejgamberit s.a.v.s., u vra në betejën e Uhudit. Nxitur nga Hindi, gruaja e Ebu Sufjanit, trupi i tij u masakrua keq. Kur Pejgamberi s.a.v.s. erdhi dhe pa çfarë kishte ngjarë, tha: “Kurrë nuk kam ndjerë në shpirt zemërim si ky që po provoj në këto çaste dhe, kur Allahu të më ndihmojë herën tjetër që të fitoj mbi Kurejshët, betohem se do të masakroj, dërmoj tridhjetë nga të vdekurit e tyre”. Por menjëherë pas kësaj atij i erdhi ajeti Hyjnor, i cili ia tërhiqte vërejtjen:

<sup>23</sup> Ajni Sinani, *Vep. e cit.*, fq. 147.

وَإِنِّ عَاقِبَتُمْ فَعَاقِبُوا بِمِثْلِ مَا عُوقِبْتُمْ بِهِ

وَلَيْنَ صَبْرَتُمْ لَهُوَ خَيْرٌ لِّلصَّابِرِينَ

**“Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju; e nëse duroni pa dyshim ai është më i mirë për ata që durojnë”.** (En Nahl 126)

Dhe është e vërtet se ai nuk e përmbushi kërcënimin e tij, përkundrazi ai e ndaloi përgjithmonë masakrimin e kufomave pas betejës.<sup>24</sup>

Në mënyrë të ngjajshme, kur Pejgamberi s.a.v.s. u plagos në luftën e Uhudit, ai i mallkoi armiqtë duke thënë: “Si mund të begatojë ai popull që plagosë të Dërguarin e Allahut!”. Si përgjigje ndaj këtij mallkimi, zbritën ajetet për t’ia tërhequr vëmendjen Pejgamberit s.a.v.s. (shih: Ali Imran 128-129)<sup>25</sup>

Njëherë kishin ardhur te Pejgamberi s.a.v.s. disa mushrikë të Mekës për ta pyetur (provokuar) rreth disa ndodhive të padëgjuaara në Hixhaz. Në këtë mënyrë ata donin të provonin nëse Pejgamberi kishte ndonjë burim të të dhënave për gjërat e fshehta dhe të papara. Pejgamberi s.a.v.s. u ishte përgjigjur: “**Nesër do tua them**” por ai nuk tha “**Po të dojë Allahu**”. Kur u kthyen ditën tjetër, Pejgamberi nuk pati ndonjë përgjigje për ta, dhe kjo gjë vazhdoi 15 ditë më radhë; Atij nuk i erdh asnjë lajm nga Allahu xh.sh.. Por,

<sup>24</sup> Martin Lings, *oMUHAMMAD, his life based on the earliest sources*, Australia 1983, fq. 191.

<sup>25</sup> Hamza Mustafa Nijazi, *Vep. e cit.*, fq. 32.

pastaj Allahu xh.sh. ia zbriti nëpërmjet Xhibrilit një ajet në formë qortimi:

وَلَا تَقُولَنَّ لِشَأَىٰ ۖ إِنِّي فَاعِلٌ ذَٰلِكَ غَدًا ﴿٢٤﴾ إِلَّا أَن يَشَاءَ اللَّهُ ۖ وَادْكُرْ

رَبِّكَ إِذَا نَسِيتَ وَقُلْ عَسَىٰ أَن يَهْدِيَنِّي رَبِّي لِأَقْرَبَ مِن هَٰذَا رَشَدًا ﴿٢٥﴾

**“Dhe mos thuaj kurrsesi për ndonjë çështje: “Unë do të bëj këtë nesër!” Vetëm (nëse i shton): “Në dashtë All-llahu!” E kur të harrosh, përmende Zotin tënd dhe thuaj: “Shpresohet se Zoti im do të më japë udhëzim edhe më të afërt prej këtij (të as-habi kehfît)”. (El Kehf 23-24)<sup>26</sup>**

Martin Lings, te vepra e cituar, fq. 77, duke trajtuar domethënien e kësaj pritjeje pak a shumë të gjatë, shprehet: “Vonesa e përgjigjes Hyjnore, ndonëse e dhimbshme për Pejgamberin dhe pasuesit e tij, ishte më të vërtetë një forcë më e madhe për të. Armiqtë e mohuan domethënien e kësaj vonese, por për ata Kurejsh, që ishin akoma të pavendosur, ky fakt ishte një pohim i qartë i asaj se Fjala e Shenjtë i vinte Muhamedit nga Qielli dhe ai as nuk kishte gisht e as nuk mund ta kontrollonte atë. Është e kuptueshme se, nëse Muhamedi do të kishte trilluar të gjitha ato çfarë kishte thënë më parë, nuk do të ishte vonuar kaq gjatë për këtë trillim të ri, veçanërisht në një çast të tillë ku rreziku qe mjaft i madh”.<sup>27</sup>

<sup>26</sup> Martin Lings, “MUHAMMAD, his life based on the earliest sources”, fq. 77.

<sup>27</sup> Po aty, fq. 77.

Në Kurʿan, më se 50 herë, Pejgamberit i thuhet **“Të pyesin ty për...”** dhe i jepen përgjigje që fillojnë me urdhërin **“Thuaj”**. Është krejt e qartë se Allahu është ai që u jep përgjigje pyetjeve për çështjet e kaluara e të padëgjuaara, për haramet dhe hallallet, për format e adhurimit e të shpirtit, për Dhulkarnejnin etj., çështje të cilat tejkalojnë aftësitë dhe mundësitë e mendjes njerëzore. Kur i bënin pyetje, ndodhte që Pejgamberi të heshte duke pritur ajetin Kurʿanor, që tʿa zbriste si përgjigje. Ndodhte që kalonin ditë të tëra dhe atij nuk i vinte lajmëtari i qiellit, kështu që disa filluan të talleshin me të, duke i thënë: **“Të la Zoti ty... Hoqi dorë prej teje,** etj., derisa zbriti ajeti:

مَا وَدَّعَكَ رَبُّكَ وَمَا قَلَىٰ ﴿٣٣٢﴾

**“Zoti yt nuk të ka braktisur, as nuk të ka përbuzur”.** (Ed-Duha 3)<sup>28</sup>

Nëse meditojmë pak për ajetet që lexuam më sipër dhe që do tʿa lexojmë në vazhdim, si dhe për fjalën **“Thuaj”** e cila në Kurʿan përsëritet 332 herë, bëhet e qartë se kjo fjalë u jepet njerëzve për të bërë një deklaratë të caktuar. Në pjesët e tjera të Kurʿanit Pejgamberi urdhërohet: **“Shpall”, “Lëvdëro Zotin tënd”, “Gjunjëzohu”,** etj., prandaj me të drejtë pyesim: **A është kjo mënyra se si një njeri i flet vetes apo shkruan një libër?**<sup>29</sup>

<sup>28</sup> M. Fethullah Gylen, “Nen hijen e Besimit- 2”, fq. 146; Muhamed Sytari, “Përpjekje të dështuara”, Shkodër 2003, fq. 40.

<sup>29</sup> Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *Vep. e cit.*, fq. 10.

Cili autor e kërcënon veten në veprën e vet, qoftë edhe në emër të dikujt tjetër ose me gojën e dikujt tjetër? Për më tepër, ndërsa pretendonte se fliste në emër të Allahut, a mund të bënte ndonjë deklaratë që do t'ia sillte dëm prete-ndimit të vet? Gjithashtu, a fuste në librin e vet shprehje akuzuese ndaj vetes? Në Kurçan thuhet:

وَلَوْ تَقَوَّلَ عَلَيْنَا بَعْضَ الْأَقَاوِيلِ ﴿٤٤﴾ لَأَخَذْنَا مِنْهُ بِالْيَمِينِ ﴿٤٥﴾  
ثُمَّ لَقَطَعْنَا مِنْهُ الْوَتِينَ ﴿٤٦﴾

**“Sikur të trillonte ai (Muhammedi) për Ne ndonjë fjalë! Ne do ta kapim atë me fuqinë Tonë. E pastaj do t’ia këputnim atij arterien e zemrës”.** (El Hakka 44-46)

Në Kurçan Muhamedit s.a.v.s. i tërhiqet vërejtja për mospjesmarrësit e fushatës së Tebukut: òPse u dhe leje atyre?ö.<sup>30</sup>

Në Kurçan tregohet për martesën me Zejneben, e cila para divorcit ishte gruaja e Zejdit. Pejgamberi s.a.v.s. nuk kishte dëshirë të martohej me të, por urdhëri qe i tillë. Që t’ia tregonte se Zejdi nuk ishte djali i Muhamedit a.s., Pejgamberi i thoshte òbirö libertit të vet, Zejdit, por Allahu xh.sh., me anë të një ajeti, e hoqi birësimin:

<sup>30</sup> Shiko sureja Teube, ajeti 43; M. Fethullah Gylen, “Nen hijen e Besimit- 2”, fq. 140.

مَا جَعَلَ اللَّهُ لِرَجُلٍ مِّن قَلْبَيْنِ فِي جَوْفِهِ ۚ وَمَا جَعَلَ أَزْوَاجَكُمُ اللَّائِي تُظَاهِرُونَ مِنْهُنَّ أُمَّهَاتِكُمْ ۚ وَمَا جَعَلَ أَدْعِيَاءَكُمْ أَبْنَاءَكُمْ ۚ ذَٰلِكُمْ قَوْلُكُمْ بِأَفْوَاهِكُمْ ۗ وَاللَّهُ يَقُولُ الْحَقَّ وَهُوَ يَهْدِي السَّبِيلَ ﴿٤٧﴾

**“All-llahu nuk krijoi dy zemra në gjoksën e asnjë njeriu e as nuk ua bëri gratë tuaja, prej të cilave largoheni me dhihar nëna tuaja, (duke krahasuar shpinën e gruas me atë të nënës), e as nuk ua bëri djem tuaj të adoptuarit tuaj (fëmijët e tjetërkujt që po i adoptoni si të tuaj). Këto janë vetëm thënie tuaja që i shqiptoni me gojë të tuaja, e All-llahu e thotë atë që është realitet, dhe Ai udhëzon në rrugën e drejtë”.** (El Ahzabë 4).

Pejgamberi s.a.v.s. do të qëndronte për t’ia falur namazin e të vdekurit kreut të hipokritëve, Abdullah ibën Selulit, meqë e njihte për musliman, por e la, sepse e paralajmëroi Allahu i Gjithdijshëm:

وَلَا تُصَلِّ عَلَىٰ أَحَدٍ مِّنْهُمْ مَّا تَأْتُوا وَلَا تَقُمْ عَلَىٰ قَبْرِهِ ۚ إِنَّهُمْ كَفَرُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ ۚ وَمَاتُوا وَهُمْ فَسِقُونَ ﴿٤٨﴾

**“Dhe asnjërit prej tyre kur të vdesin, mos ia fal namazin (e xhenazës) kurrë, e as mos qëndro pranë varrit të tij (për lutje e vizitë), pse ata mohuan All-llahun dhe të dërguarin e Tij dhe vdiqën kryeneçë”.** (Et Tevbe 84)<sup>31</sup>.

Këta urdhëra apo ndalime të ngjajshme tregojnë se ai kurrë nuk vreponte me kokën e vet, sepse ai ishte një për-

<sup>31</sup> Po aty, fq. 147.



faqësues që vetëm zbatonte urdhërat e Allahut xh.sh. edhe sjelljet nuk i ndryshonte sipas vetes, por vetëm pasi Allahu e paralajmëronte ose i tërhiqte vërejtjen. Allahu xh.sh. për Muhamedin s.a.v.s. thoshte:

وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ ﴿٣٢﴾ ۝ إِنَّ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ ﴿٣٣﴾

**“Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpalljes që i shpallet”.** (En Nexhm 3-4).

Studiuesi anglez Lightner, i cili ka doktoruar në legjislaturë, filozofi dhe teologji, thotë: “Nga ajo që di unë për dy fetë, për Krishterizmin dhe Hebraizmin, them se ajo, që ka predikuar Muhamedi, nuk është plagjiat, por relevantë, që i është shpallur atij. Për këtë, nuk duhet të dyshohet, përderisa besojmë se, edhe më parë, ka ardhur shpallja nga i Gjithfuqishmi dhe i Gjithdituri Zot... Një herë, Zoti e qortoi në mënyrë të rreptë, përmes shpalljes që ia zbriti, sepse ai e largoi fëtyrën e tij nga një njeri i verbër varfanjak, në kohën kur ishte duke biseduar me parinë e pasur. Muhamedi a.s., këtë gjë (këtë rast), ua komunikoj njerëzve. Sikur të ishte mashtrues, ashtu siç pretendojnë të krishterët, ai në të vërtetë, nuk do ta komunikonte një gjë të tillë.”<sup>32</sup>

Unë them, me zërin tim të lartë, dhe shpresoj se do të vijë dita, kur të krishterët, do të shprehin, në mënyrë të madhërishtme respektin e tyre, ndaj Isait, duke nderuar Muhamedin. Ska dyshim, se çdo i krishterë, i cili e pranon

<sup>32</sup> Shiko suren: Abese.

misionin e Muhamedit dhe beson atë që solli ai, do të jetë i krishterë i vërtetë”.<sup>33</sup>

## A janë Arabët autorë të Kur’anit?

Disa nga shpifësit e Islamit pretendojnë se “arabët janë autorë dhe përpiluesit e vërtet të Kur’anit”. Në periudhën kur zbriti Kur’ani, poezia kishte marrë një zhvillim të jashtzakonshëm. Njerëzit e përdornin të folurit poetik pothuajse edhe në bisedat e zakonshme dhe grindjet. Çdo vit organizoheshin konkurse poetike dhe poezia fituese shkruhej mbi një copë me shkronja të arta dhe varej në muret e Qabesë për të qëndruar aty gjer në konkursin e vitit të ardhshëm. Me fjalët e poetëve, të cilët konsideroheshin si heronj kombëtarë, fiset hynin në luftë ose bënë paqe. Me që Muhamedi s.a.v.s. ishte rritur në mesin e tyre, të gjithë Mekasit e dinin fort mirë se ai s’ ishte marrë kurrë as me poezi, as me prozë poetike, as me ligjëratë prozaike. Ndërkaq, shprehjet enigmatike dhe të mrekullueshme të Kur’anit nuk u ngjanin as shprehjeve të tij, as të tjerëve, ato nuk hynin as në fushën e poezisë dhe as të prozës së zakonshme dhe asaj poetike, por, me origjinalitetin e tyre të posaçëm, i mrekullonin dhe i magjepsnin të gjithë! Prandaj, parësia e politeistëve, të cilët kërkonin të largonin njerëzit nga Kur’ani, përpiqeshin të kundërviheshin me këto fjalë: “Po të themi se është poezi- s’ është, po të themi se

<sup>33</sup> Ajni Sinani, *Vep.e cit.*, fq. 168-170.

është prozë poetike - s'është, po të themi se është fjalë orakulli-s'është; as si vepër e një të çmenduri- s'ngjan; po u themi njerëzve se është magji, prandaj t'i mbyllin veshët se, ndryshe, i zë magjia!". Por, ndërsa mblidheshin, diskutonin e vendosnin së bashku kështu, kur vinte nata, nuk rrinin dot pa shkuar fshehurazi nga njeri-tjetri për të ndëgjuar Kur'ân, kur Pejgamberi s.a.v.s. lexonte duke u falur natën.<sup>34</sup>

Njerëz që e donin të vërtetën, si poetët e njohur Hansa dhe Lebid, pasi u bënë muslimanë, e lanë poezinë dhe, kur u kërkohej të shkruanin poezi, shkruanin një sure nga Kur'âni dhe ua dërgonin kërkuesve, duke ua theksuar këto fjalë: "Pas këndimit të Kur'anit, unë kam turp të shkruaj poezi".<sup>35</sup>

E kemi të qartë faktin se çdo Pejgamber që dërguar të sfidonte popullin e tij në çështjen më të përhapur ndër ta. P.sh.: Musai a.s. u dërgua në mesin e një populli ku magjia ishte shumë e përhapur por ai i sfidoi dhe i mahniti ata me mrekullitë e Zotit Fuqiptotë. Këtë e tregon Kur'âni i Madhërisëm:

<sup>34</sup> Saffijjurrâhman El-Mubarekfuri, *Vep. e cit.*, fq. 95-96; Taxhedin Bislimi, "Hyrje në shkencën e Usuli Fikhut", Shkup 2003, fq. 51-52; Ajni Sinani, *Vep. e cit.*, fq. 131-132

<sup>35</sup> Po aty, fq. 132

فَأَلْقَىٰ عَصَاهُ فَإِذَا هِيَ ثُعْبَانٌ مُّبِينٌ ﴿١٧﴾  
 قَالَ أَلْقُوا ۖ فَلَمَّا أَلْقَوْا سَحَرُوا أَعْيُنَ النَّاسِ وَاسْتَرَهُبُوهُمْ وَجَاءُوا  
 بِسِحْرِ عَظِيمٍ ﴿١٨﴾ وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ مُوسَىٰ أَنْ أَلْقِ عَصَاكَ ۖ فَإِذَا هِيَ  
 تَلْقَفُ مَا يَأْفِكُونَ ﴿١٩﴾ فَوَقَعَ الْحَقُّ وَبَطَلَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٢٠﴾ فَغُلِبُوا  
 هُنَالِكَ وَانْقَلَبُوا صَغِيرِينَ ﴿٢١﴾ وَأَلْقَى السَّحْرَةَ سَاجِدِينَ ﴿٢٢﴾ قَالُوا ءَأَمْنَا  
 رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٢٣﴾ رَبِّ مُوسَىٰ وَهَارُونَ ﴿٢٤﴾

**"Ai (Musai) e hodhi shkopin e vet, kur ja, u shfaq gjarpër i vërtetë".**

**Ai (Musai) tha: "Hidhni ju"! E kur i hodhën ata (shkopi-një e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe. E Ne e frymëzua Musain (duke i thënë): "Hidhe shkopin tënd!" Kur qe, ai gëlltiste atë që kishin magjepsuar. Atëherë u dëshmuua e vërteta dhe u zhduk ajo që kishin përgatitur. Aty u mundën ata (magjistarët dhe faraoni) dhe u kthyen të poshtëruar. E magjistarët u hodhën (u përulën) në sexhde, Dhe thanë: "Ne i besuam Zotit të gjithësisë, Zotit të Musait dhe të Harunit!" (El A'rafë 107, 116-122)<sup>36</sup>**

Ndërsa Isai a.s. u dërgua në mesin e një populli që e njihte mjekësinë dhe shërimin e sëmundjeve. Mrekullitë e tij sfidonin pikërisht njerëzit e kësaj fushe. Ja si e tregon Kur'âni Famëlartë këtë fakt:

<sup>36</sup> Muhamed Sytari, "Hap pas hapi me "Udhën Islame", Shkodër 2004, fq. 51.

وَرَسُولًا إِلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنِّي قَدْ جِئْتُكُمْ بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ أَنِّي أَخْلُقُ  
لَكُمْ مِّنَ الطَّيْرِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ فَأَنْفُخُ فِيهِ فَيَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِ اللَّهِ  
وَأُبْرِئُ الْأَكْمَهَ وَالْأَبْرَصَ وَأُحْيِي الْمَوْتَىٰ بِإِذْنِ اللَّهِ وَأُنَبِّئُكُم بِمَا  
تَأْكُلُونَ وَمَا تَدَّخِرُونَ فِي بُيُوتِكُمْ ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَةً لَّكُمْ إِن كُنتُمْ

مُؤْمِنِينَ ﴿٤١﴾

**“Dhe, të dërguar te bijtë e Israilit: unë kam ardhur nga Zoti juaj me argument, unë nga balta ju bëj diç si shpendi, i fryej atij dhe ai me lejen e All-llahut bëhet shpend, unë i sheroj të verbërit, të sëmurit ne lëkurë, dhe unë me lejen e All-llahut ngjalli të vdekurit: unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që e depononi në shtëpiat tuaja. Vertetë, kjo është fakt për ju nëse jeni besimtarë”. (Ali Imran 49)<sup>37</sup>**

Ndërsa Kur’ani erdhi si një mrekulli në mesin e një populli që krenoheshin me letërsinë dhe ligjërimin, duke i sfiduar ata me mënyrat e tij të jashtzakonshme e të shkëlqyera, qoftë në të shprehur, qoftë në ligjërim! Velid Ibnul Mugire, një jomusliman i parisë së Mekes, pasi e dëgjoi Kur’anin, ndër të tjera tha: “Kur’ani ka një ëmbëlsi, qëndron në një lartësi... dhe mbi të gjitha nuk është fjalë njeriu”. Ndërsa prof. Sadik er Rafii, dijetar i letërsisë arabe të shekullit të kaluar, në librin e tij *“Mrekullia e Kur’anit”,* fq. 218, thotë: “Pas daljes në pah të Kur’anit, arabëve s’u

<sup>37</sup> Po aty, fq. 51.

*mbetët më emër në listën e letërsisë, pasi kjo mrekulli i sfidoi... ”.*<sup>38</sup> E si mund të mendojmë pastaj se Kur’ani është krijim i arabëve?!

Shumë jomuslimanë e kanë konfirmuar elokuencën e pashoqe të Kur’anit. Hamilton Gibi, arabolog i njohur i universitetit të Oksfordit, ka thënë: “... *Mekasit megjithatë kërkonin nga ai një mrekulli, e Muhamedi me një guxim dhe vetëbesim të jashtzakonshëm i referoi te vetë Kur’ani, si konfirmim suprem i misionit të tij. Si të gjithë arabët, ata ishin njohës të gjuhës dhe të retorikës. Pra, nëse Kur’ani ishte kompozim i tij, njerëzit e tjerë do të mund ta sfidonin atë. Le t’i kompenzojnë dhjetë vargje të tilla. Nëse nuk mundën (dhe është e qartë se nuk mundën), atëherë le ta pranojnë Kur’anin si një mrekulli të dalluar qartë”.*<sup>39</sup>

Alfred Guijomi ka shkruar: “Kur’ani është njëra ndër letërsitë klasike botërore që nuk mund të përkthehet pa humbje të mëdha. Ka ritëm të një bukurie të veçantë dhe një kadencë që magjeps veshin. Shumë arabë të krishterë flasin për stilin e tij me një admirim të ngrohtë dhe shumica e arabologëve e pranojnë persosmërinë e tij. Kur lexohet me zë apo recitohet, ka pothuajse një efekt hipnotik që e bën dëgjuesin indiferent ndaj sintaksës herë-herë të çuditshme të tij si dhe përmbajtjes që nganjëherë na duket e pakëndshme. Është pikërisht kjo veçori e Kur’anit, që e ka shuar

<sup>38</sup> Po aty, fq. 52.

<sup>39</sup> H.A.R. Gibb, “*Islam- A Historical Survey*”, 1980, Oxford University Press, fq. 28, sipas Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *Vep. e cit.*, fq. 34-35.

*kritikën me tingullin e ëmbël të gjuhës së saj dhe që lindi besimin e paimitueshmërisë së tij. Vërtetë mund të arrihet në përfundim se brenda letërsisë arabe, e cila është e gjërë dhe e begatë si me poezi, ashtu edhe me prozë të avancuar, nuk ekziston diçka që mund të krahasohet me të”.*<sup>40</sup>

Është mrekulli në vete se si, pas më tepër se 1400 vitesh, ftesa, për ta sfiduar Kur’anin, ka mbetur pa përgjigje akoma sot e kësaj dite, me gjithë tentativat e shumta.

### A janë xhinët autorë të Kur’anit?

Shtrohet pyetja: “A janë xhindët apo djalli autorë të Kur’anit”?

Duke lexuar ajetet e Kur’anit në vijim, do ta shohim se edhe ky mendim nuk qëndron:

قُلْ أُوْحِيَ إِلَيَّ أَنَّهُ اسْتَمَعَ نَفَرٌ مِّنَ الْجِنِّ فَقَالُوا إِنَّا سَمِعْنَا قُرْءَانًا عَجَبًا ﴿١٠٠﴾  
يَهْدِي إِلَى الرُّشْدِ فَآمَنَّا بِهِ وَلَنْ نُشْرَكَ بِرَبِّنَا أَحَدًا ﴿١٠١﴾

**Thuaj: “Mua më shpallet se një grup i vogël nga xhinët i vuri veshin dhe dëgjoi (Kur’anin) dhe (kur u kthyen te të vetët) thanë: “Ne kemi dëgjuar një Kur’an që mahnit, që udhëzon në të vërtetën, andaj ne i besuam atij dhe Zotit tonë, kurrsesi nuk do t’ia shoqërojmë më askë”. (El Xhinn 1-2)**

<sup>40</sup> Alfred Guillaume, “Islam”, 1990 (Reprinted), Penguin Books, fq. 73-74, sipas Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *Vep. e cit.*, fq. 35.

Shtrohet pyetja: A është e mundur që ata vetë ta kenë shkruar këtë libër e njëkohësisht të mahnitën prej veprës së vet dhe pastaj të shkojnë te populli i tyre dhe t’i bëjnë thirrje të besojnë në Allahun, që është Një dhe i vetëm? Në Kur’an thuhet se ky grup, pasi kishte dëgjuar Kur’anin, i ishte drejtuar popullit të vet në këtë menyrë:

قَالُوا يَنْقُومَنَا إِنَّا سَمِعْنَا كِتَابًا أُنزِلَ مِنْ بَعْدِ مُوسَىٰ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ يَهْدِي إِلَى الْحَقِّ وَإِلَى طَرِيقٍ مُّسْتَقِيمٍ ﴿١٠٢﴾ يَنْقُومَنَا أَجِيبُوا دَاعِيَ اللَّهِ وَآمِنُوا بِهِ يَغْفِرَ لَكُمْ مِّنْ ذُنُوبِكُمْ وَيُجِرْكُمْ مِّنْ عَذَابِ أَلِيمٍ ﴿١٠٣﴾  
“**Thanë: “O populli ynë, e dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton atë para tij, që udhëzon në të vërtetën dhe në rrugën drejtë!”**

**O populli ynë, përrigjuni thirrësit të All-llahut dhe besoni atij! Ai ju falë mëkatet tuaja dhe ju shpëton prej një dënimi plot vuajtje”. (El Ahkaf 30-31).**

Po të ishin xhindët autorë të Kur’anit, pse nuk thanë: “Ja libri që shkruam dhe e vetëshpallet!”, por thanë: “Ne dëgjuam një libër të shpallur”. Dallim i madh në mes dy shprehjeve, për ata që mendojnë dhe logjikojnë drejt?!<sup>41</sup>

Disa studiues mendojnë se ndoshta autorë i Kur’anit është Djalli. Dobësia e kësaj hipoteze duket në faktin se Kur’ani, jo vetëm që e mallkon djallin dhe e deklaroi atë armikun më të madh të njerëzve, por urdhëron që, para le-

<sup>41</sup> Muhamed Sytari, “Përpjekje të dështuara”, fq. 43-44.

ximit të Kur'anit, njeriu duhet së pari të kërkojë ndihmën e Allahut xh.sh. për t'ua mbrojtur nga Djalli.

﴿٩٨﴾ فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ ﴿٩٨﴾

**“Kur të lexosh Kur'anin kërko mbrojtjen e All-llahut prej djallit të mallkuar”.** (En Nahl 98)<sup>42</sup>

Gjithashtu, sapo ta hapësh Kur'anin, do të lexosh: “Me ndihmën e Allahut mbrohem prej dëmit të djallit të mallkuar”.<sup>43</sup> Në qoftëse djalli është autor i këtij libri, këtu ai e ka demaskuar vetveten.

### A është Kur'ani kopje e burimeve hebreo-kristere?

Ndër shpifjet tjera që bëhen ndaj Kur'anit dhe Muhamedit s.a.v.s., janë edhe këto: ÷Muhamedi nuk ishte autor i këtij libri, por thjesht e kopjoi atë nga autorë dhe burime tjera ÷, pra, sipas tyre, “Kur'ani është kopje e burimeve hebreo-kristiane”.

Faktikisht kjo akuzë është ripërtëritje e pohimeve të vjetra pagane të kohës së Pejgamberit Muhamed s.a.v.s., por në një formë tjetër:

<sup>42</sup> Hamza Mustafa Nijazi, “Burimet e Kur'anit”, fq. 97.

<sup>43</sup> Kur'ani ó Përkthim me komentim i H. Sherif Ahmetit, fq. 23.

وَقَالُوا أَسْطِيرُ الْأَوَّلِينَ

﴿٥﴾ أَكْتَبَهَا فَهِيَ تُمَلَّى عَلَيْهِ بُكْرَةً وَأَصِيلًا ﴿٥﴾

**“Edhe thanë: (për Kur'anin) Janë legjenda të të parëve, që ai (Muhammedi) kërko t'i shkruhen ato, e i lexohen atij mëngjes e mbrëmje”.** (El Furkanë 5).

Sipas logjikës së kësaj akuze, duke qenë se Kur'ani flet për shumë ngjarje të cilat përmenden gjithashtu edhe në Bibël, ky u dashka të jetë një kopje e saj. Mirëpo, kjo akuzë është fare e paargumentuar. Pikë së pari, ngjajshmëria nuk do të thotë medoemos kopjim. Allahu xh.sh. e bëri të qartë në Kur'an se mesazhi që ai po shpallte nëpërmjet Muhamedit s.a.v.s., nuk ishte diçka e re, por ishte vetëm një vazhdim i zinxhirit të mëhershëm të porosive dhënë nga Zoti nëpërmjet Pejgamberëve.

﴿١٠٠﴾ إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّنَ مِنْ بَعْدِهِ ؕ وَأَوْحَيْنَا

إِلَى إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطَ وَعِيسَى وَأَيُّوبَ

﴿١٠٠﴾ وَيُونُسَ وَهَارُونَ وَسُلَيْمَانَ ؕ وَءَاتَيْنَا دَاوُدَ زَبُورًا ﴿١٠٠﴾

**“Ne të frymëzuar ty me shpallje sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe pejgamberët pas tij; e patëm frymëzuar Ibrahimin, Ismajlin, Is-hakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin, e Davudit i patëm dhënë Zeburin”.** (En Nisaë 163)

وَكَمْ أَرْسَلْنَا مِنْ نَبِيِّ فِي الْأَوَّلِينَ ﴿٦﴾

**“E, sa pejgamberë kemi dërguar te popujt e lashtë?! (Ez Zuhruf 6)**

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ رَسُولٌ فَإِذَا جَاءَ رَسُولُهُمْ قَضَىٰ بَيْنَهُمْ بِالْقِسْطِ

وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٤٧﴾

**“Secili popull kishte të dërguarin e vet, e kur u vinte i dërguari i tyre bëhej gjykimi i drejtë mes tyre, atyre nuk u bëhet padrejtësi”. (Junus 47)**

Është e natyrshme që mesazhi i këtyre Pejgamberëve ishte i njëjtë, duke qenë se ata vinin nga Zoti i njëjtë dhe tash, meqë në Bibël kanë mbetur gjurmë të mesazhit të vërtetë, të përcjellë nga Pejgamberët, nuk është aspak e çuditshme nëse edhe në Kur'an gjejmë paralelizma me ngjarje të caktuara. Akuza se Kur'ani është kopje e biblës vetëm sepse të dy librat flasin për disa ngjarje të njëjta, është shumë naive.<sup>44</sup>

E metë tjetër e kësaj akuze është fakti se kurrë nuk është gjetur se cili ishte ai person misterioz nga i cili Muhamedi s.a.v.s. mësoi biblën apo mësimet hebreo-kristiane, për t'aj futur pastaj ato në Kur'an. Ai apo ata njerëz nuk u gjetën kurrë për një arsye të thjeshtë: ata nuk ekzistonin. Muhamedi s.a.v.s. gjatë tërë jetës së tij nuk mësoi shkrimin e leximin, dhe kjo është një tjetër pengesë e rëndësishme që hedh poshtë akuzat e sipërpërmendura.

<sup>44</sup> Halil Ibrahim, *Vep. e cit.*, fq. 45-46.

Ishte e pamundur që ai të mblidhte tërë ato materiale nga çifutët, krishterët apo nga burimet e tjera pagane<sup>45</sup>, me qëllim që këtë material ta përpunonte dhe ta recitonte më pas për 23 vjet në gjuhën e madhërishtme të Kur'anit, pa ndihmën e një pende. Kur'ani thotë:

وَمَا كُنْتَ تَتْلُوْا مِنْ قَبْلِهِۦٓ مِنْ كِتٰبٍ وَلَا تَخْطُوْهُۤ بِيَمِيْنِكَ

إِذَا لَأَزْتَابَ الْمُبْتَلُوْنَ ﴿٤٨﴾

**“Ti (Muhammed) nuk ishe që lexon ndonjë libër para këtij, e as që shkruajshe atë me dorën tënde të djathtë, pse atëherë do të dyshonin ata të prishurit”. (El Ankebutë 48).**

Është e mos ishte që nuk dinte shkrim lexim, siç thuhet në Kur'an, a nuk do të ishte e lehtë që kjo gjë të vërtetohej gjatë jetës së tij nga armiqtë e vet, të cilët ishin të etur ta diskreditonin atë? Ky fakt tregon se të gjithë kishin njohuri se ai me të vërtetë nuk dinte shkrim-lexim dhe askush nuk dyshonte për këtë.<sup>46</sup>

Me të drejtë mund të pyesim: Cili mësues mund ti mësonte Muhamedit s.a.v.s. një besim të plotë e koherent që ktheu faqen e historisë? Përse ai apo ata nuk u ngriten (në qoftëse ka patur ndonjë) kundër të ashtuquajturit nxënës i

<sup>45</sup> PAGAN/IZËM-MI. Besimi në shumë hyjni a perëndi, formë e lashtë e feve, (por edhe e tashme S.M.) para kalimit në monoteizëm. (Fj. i gj. së sotme shqipe, fq. 1324; shiko më gjërësisht Dr. Ekrem Murtezai, “Fjalori i feve”, Prishtinë 2000, fq. 337; poashtu tek: Dr. Ivan Cvitkovi, “Rječnik religijski pojmovna”, Sarajevo 2005, fq. 333).

<sup>46</sup> Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *Vep. e cit.*, fq. 23.

cili vazhdonte t'aj mësonte dhe t'aj injoronte ata në të njëjtën kohë duke shpallur se mësimet a tij vinin nga një burim Hyjnor, siç është vetë Allahu xh.sh.? E si mundet që disa nga bashkëkohësit e tij të krishterë dhe çifutë u kthyen në muslimanë dhe besuan në vërtetësinë e tij, në qoftëse e dinin se ai po kopjonte shkrimet e tyre të shenjta apo po mësonte nga rabinjtë ose priftërinjtë e tyre?<sup>47</sup>

Pretendimeve se dikush e mësonte Muhamedin s.a.v.s., Kur'ani u përgjigjet duke ua tërhequr vërejtjen se gjuha arabe, e përdorur në Kur'an, ishte e pastër, kurse gjuha e tyre ishte e paqartë.

وَلَقَدْ تَعَلَّمَ أَنَّهُمْ يَقُولُونَ إِنَّمَا يُعَلِّمُهُ بَشَرٌ لِّسَانُ الَّذِي

يُلْحَدُونَ إِلَيْهِ أَعْجَمِيٌّ وَهَذَا لِسَانٌ عَرَبِيٌّ مُبِينٌ ﴿١٠٣﴾

**“Ne dimë shumë mirë se ata thonë: “Atë (Muhammedin) është kah e mëson një njeri!” Mirpo, gjuha e atij nga i cili anojnë (supozojnë) ata është jo arabe (e paqartë), e kjo (e Kur'anit) është gjuhë arabe e stilit të lartë e të qartë”.** (En Nahl 103)

Verzióni i parë arab i Dhjatës së Vjetër doli 200 vjet pas vdekjes së Muhamedit s.a.v.s. dhe verzióni më i vjetër i Dhjatës së Re doli 1000 vjet pasi Muhamedi s.a.v.s. na kishte lënë. Tomas Patrik Hjuze thotë: *“Nuk kemi asnjë provë se Muhamedi pati mundësi t'i njihje shkrimet e shenjta. Duhet gjithashtu të kemi parasysh se nuk kemi asnjë gjur-*

<sup>47</sup> Hamza Mustafa Nijazi, *Vep. e cit.*, fq. 61.

*më për ekzistencën e teksteve arabisht të Dhjatës së Vjetër përpara ardhjes së Muhamedit”.*<sup>48</sup>

Sidni Grifit, pas një studimi të mirëfilltë, arriti në përfundim se: *“E tërë ajo që mund të thuhet për mundësinë e ekzistimit të një versioni të krishterë të ungjillit në arabisht, para ardhjes së Islamit, është se ende nuk është shfaqur ndonjë dëshmi e sigurt për ta vërtetuar...”*<sup>49</sup>

Ernst Vurthvaini, në librin e tij *“Teksti i Dhjatës së Vjetër, shkruan: “Me fitoren e Islamit, përdorimi i arabishtës u përhap gjerësisht, duke u bërë gjuhë e përditshme për hebrenjtë dhe të krishterët e vendeve të pushtuara. Kjo i dha shkas nevojës për paraqitjen e versioneve të Biblës në arabisht...”*<sup>50</sup> Pra, është e qartë se gjatë jetës së Muhamedit s.a.v.s. nuk ekzistonte asnjë përkthim i Biblës apo i Apokrifëve në gjuhën arabe.

Edhe pse Kur'ani në disa raste flet për ngjarje të njëjta sikur edhe Bibla, ato në asnjë mënyrë, nuk janë identike, por ndërrojnë thelbësisht, prandaj mendojmë se edhe kjo është një tjetër akuzë e palogjikshme.

Misioni themelor i Muhamedit s.a.v.s. ishte përmirësimi i imazhit të Zotit, të cilin deri atëherë e kishin korruptu-

<sup>48</sup> Po aty, fq. 62.

<sup>49</sup> The Gospel in Arabic: *“An Enquiry Into Its Appearance in The First Abbasid Century”*, Oriens Christianus, vëll. 69, fq. 166, sipas Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *Vep. e cit.*, fq. 23.

<sup>50</sup> *“The text of the Old Testament”*, 1988, William B. Eerdmans Publishing Company, Grand Rapids, Michigan, fq. 104, sipas Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *“Kush e shkroi Kur'anin”*, fq. 23.

ar. Ideja se Kur'ani ka huazuar nga bibla nuk qëndron, për shkak të dallimeve themelore që ekzistojnë në besim në dy tekstet.<sup>51</sup> Këto dallime janë: P.sh.: në konceptin e Zotit, Bibla Zotin e tregon si një Zot që lodhet (Ekzodi 31:17- Zanafilla 2:2); një Zot që harron (Psalmi 13:1- Vajtimet 5:20); i pafuqishëm (Zanafilla 32:28); një Zot që fle (Psalmi 44:23- 78:65); i pamëshirshëm (Psalmi 77:7-9); dituria e mangët e Zotit (Zanafilla 3:8); Zoti përshkruhet në formën njerëzore (Zanafilla 1:26- 9:6); një Zot që ka familje (Ekzodi 4:22- Ligji i përtërirë 32:19- Ezekieli 16:3-32- Hebrejve 5:5- Psalmi 2:7), e shumë gjëra të tjera që janë në kundërshtim me qenien e Zotit xh.sh., po ajetet e Kur'anit i hedhin poshtë dhe u kundërvihen këtyre citateve biblike: Kaf 38, Taha 52, Haxh 74, Bekare 255, Zumer 53, Bekare 115, Shuara 11, Nahl 74, Ihlas 1-4, Maide 18, e shumë citate tjera.<sup>52</sup>

Poashtu edhe në konceptin e Pejgamberëve ka dallime. Bibla i quan profetët si mëkatarë, gënjeshtarë, tradhtarë, e shumë epitete të tjera, që kryejnë vepra të shëmtuara dhe të ndyra etj. P.sh. Luti a.s. bëri zina me dy bijat e tij (Zanafilla 19:30-38); Haruni a.s. si njeri i cili e konstruktoi viçin që ta adhuronin Izraelitët (Ekzodi 32:1-20); Sulejmani, i cili u martua me 700 gra dhe 300 konkubina dhe u kthye në idhujtar (1 Mbretërve 11:3-7) etj., kurse Kur'ani Pejga-

<sup>51</sup> Citatet e theksuara më poshtë janë marrë nga Bibla ó Diodati i Ri përkthim 1991-94, në gjuhën shqipe.

<sup>52</sup> Për më tepër shih tek Dituria Islame, viti IX, nr.178, Maj 2005, Prishtinë, "Koncepti i Zotit në Bibel dhe në Kur'an", Senad Makoviq.

mberët i ngre në pedestalin më të lartë dhe i bën shëmbëllyrë për ne.<sup>53</sup> Dallime thelbësore gjejmë edhe sa i përket besimit në jetën e tanishme dhe të përtejme, në konceptin e shpëtimit dhe të drejtimit në jetë. Kur'ani dhe Bibla gjithashtu nuk përputhen edhe sa u përket të dhënave për personazhet historikë, Ademin e Havën, Ibrahimin a.s., Isamilin, Ishakun, Lutin, Musain, Isain a.s. etj. Pra, ideja se Kur'ani ka huazuar të dhëna nga bibla, është padyshim e gabuar.

Keneth Kreg thotë se: "*Muhamedi nuk pati asnjë kontakt personal me shkrimet e shenja paraardhëse... Kemi pothuajse një mungesë absolute të asaj që mund të quhej citim i drejtpërdrejtë nga secila Dhjatë*".<sup>54</sup>

Në Enciklopedinë e Re Katolike lidhur me kohën e Muhamedit s.a.v.s. thuhet: "*Hixhazi (Gadishulli Arab) nuk është prekur nga predikimet e krishtera. Kështu që organizimi i kishës së krishterë as nuk është pritur të ndodhë e as nuk është gjetur atje*".<sup>55</sup>

<sup>53</sup> Për më tepër shih tek Dituria Islame, viti IX, nr.180-181, Korrik - Gusht 2005, Prishtinë, "Koncepti Pejgamberik në Bibel dhe në Kur'an", Senad Makoviq.

<sup>54</sup> Hamza Mustafa Nijazi, *Vep. e cit.*, fq. 68.

<sup>55</sup> New Catholic Encyclopedia, vëll. I, fq. 721-722, sipas Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, "*Kush e shkroi Kur'anin*", fq. 24.



## KUR'ANI – Fjala e përjetshme e Zotit drejtuar njerëzimit

Dallimi më i madh midis Kur'anit dhe cilitdo libër tjetër të shenjtë, i çfarëdo besimi qoftë, qëndron në faktin se Kur'ani vazhdimisht e pohon origjinën e tij hyjnore nga Zoti i gjithësisë. Në Kur'an ekzistojnë një mori shembujsh të tillë:

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ

يَتْلُوا عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ

وَالْحِكْمَةَ وَإِن كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿١٧٤﴾

**“Është e vërtetë se All-llahu u dha dhurata të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t’u lexojë shpalljen e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë Kur’anin dhe shariatën, edhepse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur”.** (Ali Imran 164)

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْفُرْقَانَ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِندِ غَيْرِ اللَّهِ

لَوْ جَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا كَثِيرًا ﴿٨٢﴾

**“A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur’anin? Sikur të ishte prej dikut tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në te shumë kundërthënie”.** (En Nisaë 82)

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَتْكُمْ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَشِفَاءٌ لِّمَا فِي الصُّدُورِ

وَهُدًى وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٥٧﴾

**“O ju njerëz! Juve ju erdhi nga zoti juaj këshilla (Kur’-ani) dhe shërimi i asaj që gjendet në krahorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët”.** (Junus 57)

وَمَا أَنزَلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ إِلَّا لِتُبَيِّنَ لَهُمُ الَّذِي اخْتَلَفُوا فِيهِ

وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٦٤﴾

**“Ne nuk të shpallëm ty për tjetër Kur’anin, vetëm që t’u sqarosh atyre atë për çka u përçanë, (ta zbritëm) që të jetë udhëzim e mëshirë për njerëzit që besojnë”.** (En Nahl 64)

Ajete të tilla ka shumë. Pothuajse çdo sure e Kur'anit e përmban pohimin dhe vulën e autorësisë së Allahut xh.sh. Ai jo vetëm që e shpalli Kur'anin, por edhe premtoj se mesazhi dhe forma e tij do të mbeten të pandryshuara përgjithmonë.

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ ﴿٩٦﴾

**“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur’anin dhe Ne gjithësesi jemi mbrojtës të tij”** (El Hixhr 9)<sup>56</sup>

Çdo fjalë e Kur'anit dhe e jetës së Muhamedit s.a.v.s. e dëshmojnë prejardhjen e Tij Hyjnore. Karakteri i sinqertë i Muhamedit s.a.v.s. dhe sinqeriteti me të cilin pohonte se Kur'ani është fjalë e Allahut xh.sh., nuk lë asnjë fije dyshi-

<sup>56</sup> Halil Ibrahim, “Islami dhe Krishterimi”, fq. 48-49.

mi për të menduar të kundërtën. Ai, edhe para se të shpallej Pejgamber, kishte qenë i njohur si “*i besueshmi, i sinqerti*”. Edhe armiqtë e tij më të mëdhenj e pranonin çiltërsinë e personalitetit të tij. Aq shumë e kishte fituar Muhamedi s.a.v.s. besimin e arabëve politeistë, saqë edhe armiku i tij më i pamëshirshëm, Ebu Xhehli, i pati thënë një ditë: “*O Muhamed, unë nuk po të them se je gënjeshtar, por këtë fe që ke sjellë, s’e dua...*”.<sup>57</sup> Edhe armiqtë e tij më të tërbuar e pranonin se Muhamedi ishte profet i vërtetë, por e kundërshtonin për shkak të egoizmit që kishin ndaj tij! Kur’ani thotë kështu:

قَدْ نَعْلَمُ إِنَّهُ لَيَحْزُنُكَ الَّذِي يَقُولُونَ فَإِنَّهُمْ لَا يُكَذِّبُونَكَ وَلَٰكِنَّ

الظَّالِمِينَ بَعَايَتِ اللَّهِ يَحْحَدُونَ ﴿٣٣﴾

**“Ne dimë se ty të brengos ajo që thonë, e ata nuk të gënjejnë ty, por ata mizorë mohojnë argumentet e Allahut”.** (El En ‘Amë 33)

Perandori Bizantin, Herakliusi, mori një letër nga Pejgamberi Muhamed, me të cilën e ftonte në Islam. Herakliu, në vend që të zemërohej nga përmbajtja e letres, ai shfaqti interesim për të dhe, duke dashur të mësonte se për çfarë bëhej fjalë, dha urdhër t’i sillnin pranë tij disa prej bashkëvendasve të letërdërguesit. Në mesin e tyre, në Siri, në krye të një karvani tregtarësh nga Meka ndodhej njëri prej armiqve më të tërbuar të Muhamedit s.a.v.s., Ebu Sufjani.

<sup>57</sup> Osman Nuri Topbash, “*Frymera meshire nga Muhamedi*”, Stamboll 2004, fq. 54.

Njerëzit e perandorit e gjetën Ebu Sufjanin dhe e nxorën para tij. Perandori e priti Ebu Sufjanin me shokët e vet në prani të parësisë. Herakliusi i pyeti ata me anë të përkthyesit: òCili prej jush është më i afërt në fis me këtë person që thotë se është Profet?ö. òMë i afërti jam unë!ö, iu përgjigj Ebu Sufjani. Herakliusi iu drejtua përkthyesit: òThuaju këtyre se do ta pyes këtë njeri për disa gjëra. Po të gënjejë, shokët të thonë se gënjen!ö. Ebu Sufjani tha: òVallahi, po të mos harroja, se shokët do të thoshin se kam gënjyer, do ta kisha gënjyer për të!ö Dhe vazhdon: òPyetja e parë që më bëri Herakliusi, qe kjo: òç’vend zë prejardhja e tij mes jush?ö òPrejardhja e tij është e fisme!ö òA pati më parë ndër ju ndonjë që të ketë pretenduar si kyö-më pyeti Herakliusi. òJoö- i thashë unë. òA pati sundimtarë mes të parëve të tij?ö òJoö- i thashë. òAta që e ndjekin atë, a janë parësia, apo shtresa e ulët?ö òShtresa e ulëtö- i thashë unë. òAta që e ndjekin shtohen apo pakësohen?ö òShtohenö- iu përgjigj unë. òA ka mes tyre që, pasi ta kenë pranuar fenë e tij, të kenë ndërruar mendje?ö òJoö i thashë unë. òPara se të dilte me këtë pretendim, a pati ndodhur ndonjëherë ta keni akuzuar për gënjeshtëri?ö òJoö- iu përgjigj unë. òA pati ndodhur ndonjëherë të mos e ketë mbajtur fjalën?ö òJoö i thashë. òA keni luftuar me të?ö- vazhdoi të më pyeste Herakliusi. òPoö iu përgjigj unë. òSi përfunduan këto luftëra?ö òDisa herë na mundi ai, disa herë e mundëm ne!ö òMirë, po ç’kërkon prej jush?ö òNa thotë: òFaljuni vetëm Allahut, mos i bëni asnjë shok Atij dhe braktisni idhujt të cilëve u janë lutur etërit tuaj! Pastaj na porosit të falim na-

maz, të jemi të drejtë e të ndershëm dhe të kujdesemi për prindërit dhe të afërmitö.

Pas kësaj, Herakliusi i tha përkthyesit: òThuaji atij: òTë pyeta për prejardhjen e tij dhe më the që është shumë e fisme. Të tillë janë profetët; ata zgjidhën mes fisnikëve të fisit.

Të pyeta nëse pati para tij ndonjë që të ketë dalë me këtë pretendim dhe më the jo. Po të kishte pasur, do të thosha se e merr si shembull atë.

Të pyeta nëse ka mes të parëve të tij sundimtarë dhe mu përgjigje jo. Po të kishte, do të thosha se përpiqet ta rifusë në dorë sundimin e të parëve të vet.

Të pyeta nëse pati ndodhur më parë ta shihnit nëse po gënjente dhe më the jo. Unë e di se njeriu që nuk thotë gënjeshtër për njerëzit, nuk thotë gënjeshtër as për Allahun!

Të pyeta nëse ata që e ndjekin, janë prej parisë apo shtresës së ulët, më the se janë të shtresës së ulët. Kështu ndodh në fillim me profetët; ata që e ndjekin janë njerëz të shtresës së ulët.

Të pyeta nëse ata që e ndjekin shtohen apo pakësohen dhe më the se shtohen. E veçanta e feve të vërteta është se gjer në plotësimin e kumtesës numri i ndjekësve vjen gjithmonë duke u shtuar.

Të pyeta nëse pati ndodhur të mos e ketë mbajtur fjalën dhe më the jo. Të tillë janë profetët, nuk e kthejnë fjalën!

Të pyeta se ç-kërkon prej jush dhe më the se ju kërkon të adhuronit vetëm Allahun duke mos barazuar asgjë tjetër me Të; të largoheni prej idhujve, të falni namaz të jeni të

drejtë e të ndershëm. Po që se këto që the janë të vërteta, ai njeri do të sundojë shumë shpejt në këtë vend ku më shkel këmba. Unë e kam ditur se do të dalë një profet, por nuk e parashikoja se do të ishte prej jush. Po ta dija se mund të takohesha me të, do të merrja parasysh të gjitha vështirësitë dhe, po t'ia ndodhesha pranë, do t'ia laja këmbëtö.<sup>58</sup>

Kemi shumë shembuj nga jeta e Pejgamberit Muhamed s.a.v.s. të cilët tregojnë se Muhamedi ishte rob dhe i dërguar i Zotit dhe se Kur'ani nuk është vepër e tij por fjalë e Allahut të Plotfuqishëm që ia dërgoi robit të vet Muhamedit s.a.v.s. Megjithëse fjala e Allahut është dëshmia më e fortë që konfirmon origjinën hyjnore të Kur'anit dhe karakterin e dëlirë e të sinqertë të Pejgamberit Muhamedit s.a.v.s., përmes të cilit na e dërgoi Kur'anin, ne do të përmendim edhe disa fakte tjera të cilat e bëjnë të besueshëm faktin se Kur'ani është libër i Zotit.

Sa u përket njoftimeve, kushtuar së shkuarës dhe së ardhmes, Kur'ani jep të dhëna të sakta të cilat në asnjë mënyrë s'mund të jenë pjellë e mendjes njerëzore. Sot, zbulimet e reja kanë nxjerrë në shesh mënyrën e të jetuarit të popujve të kaluar, fundin e tyre të mirë apo të keq, ashtu siç kishte njoftuar fjalë për fjalë Kur'ani i Madhërisëm shekuj më parë. Ai tregon për Pejgamberët, Nuhin, Salihun, Lutin, Ibrahimin, Musain, Isanë (Paqë e Zotit qoftë mbi ta) etj., të cilët bartnin me vete nga një dëshmi të shpa-

<sup>58</sup> Po aty, fq. 54-57.

losur për t'u marrë shembull; tregon për popujt dhe vendbanimet e tyre.<sup>59</sup> Kur'ani na tregon:

أَوَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ  
كَانُوا أَشَدَّ مِنْهُمْ قُوَّةً وَأَثَارُوا الْأَرْضَ وَعَمَرُوهَا أَكْثَرَ مِمَّا عَمَرُوهَا  
وَجَاءَتْهُمْ رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَمَا كَانَ اللَّهُ لِيَظْلِمَهُمْ وَلَكِن كَانُوا  
أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿٩﴾

*“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të shohin se si qe përfundimi i atyre që ishin para tyre!? Ata ishin edhe më të fortë se këta, ata e lëruan tokën dhe e rindërtuan atë më shumë se sa këta, atyre u patën ardhur të dërguarit e vet me fakte të qarta. Pra, Allahu nuk ishte që t’ju bëjë të padrejtë atyre, por ata vetvetes i bënë të padrejtë”.* (Er Rrum 9)

أَفَلَمْ يَهْدِ لَهُمْ كَمْ أَهَلَكْنَا قَبْلَهُم مِّنَ الْقُرُونِ يَمْشُونَ فِي مَسْجِدِهِمْ  
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّأُولِي الْأَلْبَابِ ﴿١٢٨﴾

*“A nuk e kanë të qartë ata se sa breza para tyre i kemi zhdukur, e këta ecin nëpër ato vendbanime të tyre. Në gjurmët e atyre ka fakte për ata që kanë arsye të shëndoshë”.* (Ta Ha 128)

<sup>59</sup> M. Fethullah Gylen, “Lëkundjet që sollli shekulli”, fq. 94; shiko librin “Popujt e zhdukur”, Harun Jahja, Stamboll 2002, mbi popujt e mëparshëm dhe përfundimi i tyre.

فُكُلًا أَخَذْنَا بِذَنبِهِ فَمِنْهُمْ مَّنْ أَرْسَلْنَا عَلَيْهِ حَاصِبًا وَمِنْهُمْ مَّنْ  
أَخَذَتْهُ الصَّيْحَةُ وَمِنْهُمْ مَّنْ حَسَفْنَا بِهِ الْأَرْضَ وَمِنْهُمْ مَّنْ أَغْرَقْنَا  
وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيَظْلِمَهُمْ وَلَكِن كَانُوا أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿٤٠﴾  
*“Secilin prej tyre e kemi dënuar për shkak të mëkatit të vet; disa prej tyre Ne i goditëm me furtunë plot rërë, disa i shkatërruam me krismë nga qielli, kurse disa të tjerë i sharrum në tokë dhe disa përmytëm në ujë. All-llahu nuk u bëri atyre ndonjë padrejt, por ata vetës së tyre i bënë padrejtë”.* (El Ankebutë 40)

Allahu në librin e tij, kur flet për popujt dhe pejgambetë, i kërkon Muhamedit s.a.v.s. t'u tregojë njerëzve se ai nuk kishte marrë pjesë në ato ngjarje dhe as që dinte për to gjer atëherë.

ذَلِكَ مِنْ أَنبَاءِ الْغَيْبِ نُوحِيهِ إِلَيْكَ وَمَا كُنْتَ لَدَيْهِمْ إِذْ يُلْقُونَ  
أَقْلَامَهُمْ أَيُّهُمْ يَكْفُلُ مَرِيَمَ وَمَا كُنْتَ لَدَيْهِمْ إِذْ يَخْتَصِمُونَ ﴿٤٤﴾  
*“Këto janë nga lajmet e fshehta (të hershme) që po t’i shpallim ty. Ti nuk ishe ndër ta kur i hidhnin shortet se kush prej tyre do të bëhej kujdestar i Mejremes, nuk ishe pranë tyre as kur ata ziheshin mes vete”.* (Ali Imran 44)

وَمَا كُنْتَ بِجَانِبِ الْعَرَبِيِّ إِذْ قَضَيْنَا إِلَىٰ مُوسَى الْأَمْرَ  
وَمَا كُنْتَ مِنَ الشَّاهِدِينَ ﴿٤٤﴾

*“E ti nuk ishe në anën perëndimore (të vendit ku All-llahu i foli Musait) kur Ne Musait ia besuam shpalljen (e bëmë*

pejgamber dhe dërguam te faraoni), e ti as nuk ishe aty pran”. (El Kasas 44)

تَلَّكَ مِنْ أَنْبَاءِ الْغَيْبِ نُوحِيهَا إِلَيْكَ مَا كُنْتَ تَعْلَمُهَا أَنْتَ

وَلَا قَوْمَكَ مِنْ قَبْلِ هَذَا فَاصْبِرْ إِنَّ الْعَقِيبَةَ لِلْمُتَّقِينَ ﴿٤٤﴾

“Këto janë disa rrëfimet e panjohura (për ty), që po t’i shpallim ty, e që para këtij (Kur’anit) nuk i ke ditur as ti as populli yt. Pra të jesh i durueshëm se përfundimi (i lavdishëm) është për të devotshmit”. (Hudë 49)

Një njeri që s’dinte të shkruante as të lexonte, që s’kishte prekur libër me dorë (Kur’an: Ankebut 48) dhe që s’kishte marrë pjesë në ngjarjet e së kaluarës; që s’kishte dëgjuar e mësuar gjë nga të tjerët, të japë të dhëna kaq të sakta dhe të prera të cilat shkenca dhe teknologjia i ka zbuluar kohët e fundit; a nuk mjafton kjo për të kuptuar se ai person ishte i dërguari dhe përfaqësuesi i Allahut, njohësit të së fshehtës?

Aq sa janë kategorike dhe të drejta njoftimet e Kur’anit kushtuar së shkuarës, po aq të sakta janë edhe njoftimet për të ardhmen. A s’është kjo një mrekulli?!

Faktet e tjera që e argumentojnë origjinën Hyjnore të Kur’anit, janë edhe profecitë (parashikimet) e Kur’anit, të cilat u përmbushën me saktësi. Në Kur’an, në surën El-Feth, ajeti 27, besimtarët përgëzohen se do të hyjnë në Meka. Kur’ani kishte shkruar për këtë ngjarje, disa vite para se të ndodhte kjo. Në atë kohë Meka ishte nën sundimin e

paganëve, po megjithatë ndodhi pikërisht ashtu siç kishte paralajmëruar Allahu xh.sh. në Kur’anin Famëlartë .

لَقَدْ صَدَقَ اللَّهُ رَسُولَهُ الرُّؤْيَا بِالْحَقِّ لَتَدْخُلُنَّ الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ

إِنْ شَاءَ اللَّهُ ءَامِنِينَ مُحَلِّقِينَ رُءُوسَكُمْ وَمُقَصِّرِينَ لَا تَخَافُونَ

فَعَلِمَ مَا لَمْ تَعْلَمُوا فَجَعَلَ مِنْ دُونِ ذَلِكَ فَتْحًا قَرِيبًا ﴿٦٠﴾

“All-llahu ëndrën e të dërguarit të Vet e vërtetoi me realitet: se me vullnetin e All-llahut do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të siguruar, të rruani flokët e kokave tuaja, t’i shkurtoni e nuk do të keni frikë! Pra Ai ka ditur atë që ju nuk e dinit, para kësaj ju dha një fitore të shpejtë (Hajberin)”. (El Fet-h 27)<sup>60</sup>

Profecia tjetër e cila gjithashtu u përmbush, ishte paralajmërimi për fitoren e Bizantit, e bërë në kohën kur nuk kishte asnjë shenjë të vockël se do të ndodhte, pasiqë në atë kohë Bizanti sapo kishte pësuar humbje të thellë. Kështu, rreth vitit 620 pas Isait a.s., u shpallën këto ajete Kur’anore:

غَلَبَتِ الرُّومُ ﴿٦١﴾ فِي أَدْنَى الْأَرْضِ وَهُمْ مِنْ بَعْدِ عَلَيْهِمْ سَيَعْلَبُونَ

﴿٦٢﴾ فِي بَضْعِ سِنِينَ ۗ لِلَّهِ الْأَمْرُ مِنْ قَبْلُ وَمِنْ بَعْدُ وَيَوْمَئِذٍ يَفْرَحُ

الْمُؤْمِنُونَ ﴿٦٣﴾ يَنْصُرُ اللَّهُ يَنْصُرُ مَنْ يَشَاءُ ۗ وَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ ﴿٦٤﴾

وَعَدَ اللَّهُ ۗ لَا تُخْلَفُ ۗ وَوَعْدُهُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٦٥﴾

<sup>60</sup> Halil Ibrahim, *Vep. e cit.*, fq. 51; M. Fethullah Gylen, “Lëkundjet që solli shekulli”, fq. 94.

**“Bizantinët (rumët) u mundën, në tokën më afër (tokës arabe), po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjëjnë, brenda pak viteve. Çështja është vendim i All-llahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë ditë (kur do të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen, për ndihmën e All-llahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i gjithëfuqishëm, mëshirues. Premtimi i All-llahut është (ky), All-llahu nuk e thyen premtimin e Vet, por shumica e njerëzve nuk po dinë”.** (Er Rrum 2-6)

Gjithçka tregonte për një shkatërim të përjetshëm të Bizantit dhe të përmendje një fitore për të, ishte diçka shumë e palogjikshme në atë kohë, por Zoti, i cili është njohës i së tashmës dhe i së ardhmes, e dinte më së miri. Shtat vite pas kësaj profecie (paralajmërimi) Perandoria Bizantine njëmend fitoi pas një beteje të përgjakshme me Persët. Fjala e Allahut edhe një herë u bë realitet.<sup>61</sup>

Gjithashtu Kur’ani flet për historinë e Pejgamberëve të mëparshëm, duke filluar nga Ademi a.s. e deri te i dërguari i parafundit, Isau a.s. E tërë kjo histori nuk mund të njihej nga një njëri që nuk dinte shkrim e lexim; që nuk ishte ulur para ndonjë mësuesi dhe që nuk kishte lexuar e shfletuar asnjë libër. Vendi ku kishte jetuar ai, nuk ishte ambient i diturisë e as i qytetërimit, prandaj, duke jetuar në një ambient të tillë, nuk kishte nga kush të mësonte dhe të dëgjonte

<sup>61</sup> Halil Ibrahim, *Vep. e cit.*, fq. 51-52; M. Fethullah Gylen, “Lëkundjet që s’oli shekulli”, fq. 94; Taxhedin Bislimi, “Hyrje në shkencën e Usuli Fikhut”, fq. 50-51.

për historitë e popujve të mëparshëm. Lajmet që solli i dërguari, tregonin se burim i vetëm i këtyre paralajmërimeve ishte Allahu xh.sh.<sup>62</sup>

Në suren 111, El-Mesed, e cila i kushtohet xhaxhait të Pejgamberit, Ebu Lehebit dhe gruas së tij, në mënyrë të qartë thuhet se Ebu Lehebi do të digjet në zjarrin e xhehenimit sepse ai nuk do ta pranojë islamin. Ky paralajmërim ishte bërë 10 vite para se Ebu Lehebi të vdiste. Ai mund ta pranonte islamin sa për sy e faqe vetëm që ta diskreditonte Pejgamberin por kjo nuk ndodhi. Kjo është një deshmi e qartë se vetëm Krijuesi i botërave i di të gjitha dhe se Kur’ani është fjalë e Tij.<sup>63</sup>

Allahu xh.sh. në Kur’an thotë:

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِعَادٍ ﴿٦١﴾ إِرْمَ ذَاتِ الْعِمَادِ ﴿٦٢﴾

**“A nuk e di ti se ç’bëri Zoti yt me Ad-in? Me banorët e Iremit me ndërtesa të larta?”.** (El Fexhr 6-7)

Në këtë ajet përmendet një popull dhe një qytet për të cilin nuk dihej asgjë para viteve të 70-ta të shekullit XX-të. Në këtë vit gjatë gërmimeve në Siri u zbulua një qytet me emrin Elba. Qyteti besohet të jetë nja 43 shekuj i vjetër dhe gjëja më e mrekullueshme është se në disa pllaka të gjetura në rrënojat e këtij qyteti, përmenden emrat e qyteteve më të cilat Elba kishte patur kontakte tregtie. Edhe Iremi është një ndër qytetet e përmendura. Në shekullin e VII-të, kur

<sup>62</sup> Taxhedin Bislimi, *Vep. e cit.*, fq. 51.

<sup>63</sup> Halil Ibrahim, *Vep. e cit.*, fq. 52.

po shpallej Kur'ani dhe kur nuk dihej asgjë rreth këtij qyteti të vdekur, përmendet me emër Iremi. A nuk është kjo një mrekulli?<sup>64</sup>

Se Kur'ani është një mrekulli e Zotit, tregon edhe fatki se një numër i konsiderueshëm i të arriturave shkencore, të cilat njeriu mundi t'ia zbulonte vetëm me ndihmën e teknologjisë së shekullit XX-të, qenë shpallur në Kur'an 1400 vjet më parë. Sigurisht që nuk mund të pretendojmë që Kur'ani është një libër shkencor, por është një udhëzim i njerëzve drejt së vërtetës. Megjithatë, në Kur'an gjejmë shumë fakte shkencore, të cilat janë zbuluar në mënyrë të plotë vetëm në saje të fjalës së fundit të teknologjisë bashkëkohore. Këto fakte shkencore as që mund të përceptoheshin apo imagjinoeshin në kohën e shpalljes së tij, gjë që vërteton akoma më tepër prejardhjen e tij hyjnore.<sup>65</sup> Allahu xh.sh. thotë:

سُرِّيهِمْ ءَايَاتِنَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ ۗ أَوَلَمْ يَكْفِ بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٥٣﴾

**“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?” (Fussilet 53)**

<sup>64</sup> Po aty, fq. 50-51, më gjërësisht shiko tek Hamza Mustafa Nijazi, “Burimet e Kur’anit”, fq. 46.

<sup>65</sup> Për më tepër rreth këtyre zbulimeve shkencore lexo librat: “Mrekullitë e Kur’anit”, Harun Jahja, Stamboll 2002, dhe “Mrekullia e Kur’anit”, Muhammed Muteveli Esh-Sharavi, Prishtinë 1996.

Një autor jep më shumë vepra në fushën e vet. Secili dijetar është i specializuar në një fushë të caktuar. Kurse Kur'ani parashtron parime në sociologji, ekonomi, drejtësi, psikologji, politikë, ushtri, mjekësi, fizikë, biologji, pra në çdo fushë; flet për të vërtetat themelore të asaj fushe dhe diskuton për të shkuarën e për të ardhmen. Cila mendje e pranon se një libër të tillë e ka shkruar një person që nuk dinte shkrimin dhe leximin dhe nuk kishte asnjërin prej mundësive të sotme teknike e shkencore? Askush me mendje në kokë nuk mund të përdorë në emër të Allahut shprehjet që kanë të bëjnë me krijimin, me dhënien e jetës dhe të vdekjes, akte këto që i përkasin Pozitës Hyjnore. Askush nuk mund të flasë kurrë për krijimin e qiejve, tokës, yjeve, maleve, pemëve, kafshëve dhe njerëzve, si dhe për jetën e cila ende qëndron si një enigmë më vete para shkencëtarëve. Edhe nëse flet, nuk mund të mbledhë asnjë përkrahës dhe fjalët kurrë nuk mund t'ia kenë jetë të gjatë. Secili autor në veprën e vet përgjithësisht mbetet në ndikimin e kushteve dhe të mjedisit ku jeton si dhe të ngjarjeve të përjetuara pa pasur mundësi të dalë jashtë një periudhe të ngushtë kohore. Kurse, kur e lexojmë Kur'anin, vëmë re se ai përdor shprehje kategorike për fillimin dhe fundin e gjithësisë, për krijimin e njeriut dhe jetën e tij të ardhshme dhe, duam apo s'eduem, jemi të detyruar të themi se òkjo s'omund të jetë fjalë njeriu!<sup>66</sup>

<sup>66</sup> M. Fethullah Gylen, “Nen hijen e Besimit- 2”, fq. 137,139.

Merreni Kurʿanin dhe lexoni ndodhitë që janë përshkruar aty dhe keni për të parë se me çfarë stili të lartë janë treguar ato. Asnjë mënyrë e bukur e të treguarit nuk mund t'afrohet asaj të Kurʿanit, qoftë ky libër historie, morali, letërsie, i shkruar në çfarëdo gjuhe, në arabisht, turqisht, frëngjisht etj. Aq bukur përshkruhet e vërteta, sa që njeriu arrin ta përfytyrojë si diçka të prekshme, konkrete, atë që i tregohet. Kjo i ngjall njeriut besimin se Kurʿani është fjala e mrekullueshme e Zotit të Vërtetë.<sup>67</sup>

Moris Bukaj rreth kësaj teme shkruan: *“Vështrimi i mësipërm e bën të paqëndrueshme hipotezën e parashtruar nga ata që e shohin Muhamedin si autor i Kurʿanit. Si kishte mundur një njeri, nga të qenit analfabet, të bëhej autori më i rëndësishëm sa i përket meritave letrare në gjithë literaturën arabe? Si kishte mundur të shpallte të vërteta të natyrës shkencore që asnjë qenie tjetër njerëzore nuk kishite mundur t'i zhvillonte në atë kohë dhe gjithë këtë pa bërë qoftë edhe gabimin më të vogël në deklarinimin e tij rreth kësaj çështjeje”*.<sup>68</sup>

Profesori Alfred Kroner, i cili është njëri nga gjeologët më të njohur botërorë, ka thënë: *“Duke menduar për shumë nga këto pyetje dhe duke menduar nga erdhi Muhamedi, mendoj se është gati e pamundur që ai të kishte patur*

<sup>67</sup> Një pyetje drejtuar dijetarëve musliman dhe përgjigja e A. Guliamit, Tiranë 2005, fq. 23.

<sup>68</sup> Maurice Bucaille, *“The Bible, The Qurʿan and Science”*, 1978, fq. 125, sipas Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *“Kush e shkroi Kurʿanin”*, fq. 37-38; shiko dhe Ahmed Deedat, *vep. e cit.*, fq. 25.

*njohuri për gjëra si zanafilla e përbashkët e gjithësisë, sepse shkencëtarët këtë e zbuluan vetëm para disa vitesh me metoda teknologjike shumë të ndërlikuara dhe të përparuara”*.<sup>69</sup>

E ftojme lexuesin e sinqertë të persiasë dhe të logjikojë rreth këtyre fakteve.

### **Kurʿani është padyshim vepër e Allahu xh.sh.**

Kurʿani është libri me i lexuar në botë. Vargjet e tij janë recituar me dashuri e respekt dhe janë memorizuar e zbatuar në praktikë nga besimtarët myslimanë në mbarë botën që prej shekullit të shtatë kur Kurʿani iu shpall Muhamedit s.a.v.s. prej Zotit si shpallja e fundit hyjnore dhe si dëshmi deri në Ditën e gjykimit. Besimtarët frymëzohen, gjejnë ngushëllim dhe shpesh impresionohen nga stili letrar, harmonia dhe imagjinata poetike e Kurʿanit Famëlartë, sidomos kur e lexojnë atë me zë. Ndryshe nga shpalljet e tjera, Kurʿani është unik për vërtetësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së tij. Në të nuk gjendet asnjë informacion shkencor i cili nuk është vërtetuar nga shkencëtarët. E njëjta gjë është provuar edhe me kontekstin historik të tij. Megjithatë, ajo çfarë e bën Kurʿanin të qëndrojë bindshëm në krye të shpalljeve hyjnore, është fakti që fjalët e tij janë ruajtur të pa ndryshuara dhe janë përcjellë në mbarë botën Islame në gjuhën origjinale, ashtu siç zbriti (në Arabisht). Kurʿani

<sup>69</sup> Mustafa Steven Nicholas & Tariq Nelson, *Vep. e cit.*, fq. 38.



mbetet i vetmi libër i cili mund të memorizohet i tëri prej njerzëve të të gjitha moshave, niveleve intelektuale, por edhe prej kombeve që nuk janë arabë. Ky fakt e bën atë të quhet me të vërtetë një nga mrekullitë që shoqëruan Muhamedin s.a.v.s. në pejgamberinë e tij. Ky libër i mahnitshëm, me përsosmërinë e tij të lartë gjuhësore e letrare si dhe me precizitetin shkencor, arrin të depërtojë thellë në zemrat e atyre që e lexojnë dhe të memorizohet prej tyre pavarësisht nga niveli intelektual apo gjuha të cilën ata flasin.

A është shkruar gjerë më sot, vallë, një libër i cili t'aj përshtatet njeriut të çdo shtrese, moshe e niveli, qoftë ai me shkollë a njeri i thjeshtë, mendimtarë a akademik, fizikant a kimist, madje edhe çoban, nga i cili të kuptojë e përfitojë kushdo? Kur'ani është libri i vetëm që shfaqet në çdo vend, që shpërndan dritë si dielli, dhe tek i cili, duke e lexuar, gjejnë parime e zgjidhje për rrugën dhe profesionin, shërim për hallet dhe shkëlqim për idetë e tyre, poeti, oratori, sociologu, ekonomisti, juristi, administratori, politika-ni, edukatori, nxënësi, lutësi etj. etj.<sup>70</sup>

Nuk ka libër tjetër, përveç Kur'anit, që mund të lexohet disa herë pa u mërzitur. Sa e sa vepra të zgjedhura, shkri-me ideore dhe poezi e humbin origjinalitetin dhe vlerën, sa e sa vepra aktuale durojnë a s'durojnë vetëm disa vite, madje disa muaj. Ato e humbin edhe vlefshmërinë, edhe vlerën aktuale dhe hidhen e grisen si një gazetë, kurse Kur'ani, jo vetëm që nuk zbehet e vjetrohët as si fjalë, as si lexim,

<sup>70</sup> M. Fethullah Gylen, "Nen hijen e Besimit- 2", fq 133.

as si përmbajtje e kuptim, as si origjinalitet e aktualitet dhe as si drejtësi e vleshmëri, por çdo ditë që kalon, shpirtëra-ve, ndërgegjeve, mendjeve dhe zemrave u jep frymëzime të reja, u ofron ide dhe njohuri të një niveli më të përparuar dhe e ruan rininë e freskinë duke u bërë çdo ditë më i ri e më i freskët.<sup>71</sup>

Rrallë ka ndonjë libër në histori që është sulmuar me aq vrazhdësi dhe është mbrojtur me aq zell dhe dëshirë të zjarrtë sa Kur'ani. Tani do t'aj paraqiten lexuesit disa nga mendimet e dijetarëve të shquar botërorë, të cilët, pas studimeve të thella që i bënë Kur'anit të Madhërishtëm, deklaruan:

**Lora Fagliri** (studiuse Italiane) - "Kur'ani deri te brezi ynë është përcjell me një transmetim të përpiktë përmes një zinxhiri të pashkëputur dhe teksti i tij ka mbetur i pastër dhe i pandryshuar gjatë shekujve dhe i tillë do të mbetet derisa të ekzistojë jeta në sipërfaqen e tokës".

**Filip Hiti** për metodën e ligjërimit të Kur'anit thotë: "Ajo është aq e lartë, saqë nuk mund të krahasohet me të tjera, nuk mund të kopjohet, të emitohet etj."

**Carls Mills**, nisur nga pasuria e stilit të Kur'anit, shpreh se "ai zotëron një aparence të tillë të lartë, të papërkthyeshme e të papërsëritshme".

**Cl. Huart** - "Kur'ani si fjalë e Allahut iu komunikua Muhamedit nëpërmjet revelacionit".

<sup>71</sup> Po aty, fq. 133, 134.

**Artur Belegri** - *“Kur’ani i Madhërueshëm është mrekullia më e fuqishme e Pejgamberit tonë, dërguar me anë të ëngjëllit”*.

**Mr. Roduell** - *“Njeriu gjatë leximit të Kur’anit mbetet mes mahnitjesh”*.

**Di Kastro** (studiues francez) - *“Injorimi ynë kurrsesi nuk do të thotë se Kur’ani nuk ishte dhe nuk vazhdon të jetë libër hyjnor, me ndikim të madh në psikologjinë e njeriut”*.

**Ljubidd Weiss** (studiues i Kur’anit) - *“Nga Kur’ani mua më del një zë më madhështor se sa zëri i Muhamedit s.a.v.s... Kur’ani që u ligjërohej arabëve në shekullin VII dhe tundte thellësitë e tyre shpirtërore, edhe sot ka të njëjten fuqi si për lexuesin e shekullit të XX-të, ashtu edhe për lexuesin e shekullit të XXV-të”*.

**H. A. R. Gibb** - *“Kështu, pra, po të ishte Kur’ani vepër e tij (Muhamedit), atëherë njerëzit tjerë do të kishin mundur të bënë gara me të. Le t’i krijojnë vetëm dhjetë vargje, të cilat do të ishin të ngjashme, por, nëse këtë nuk mund ta bejnë, (e këtë me siguri nuk janë në gjendje) atëherë Kur’anin duhet ta pranojnë si mrekulli jashtëzakonisht të qartë”*.

Një i krishterë Indian thotë: *“Kur’ani është libri i vetëm qiellor, i cili mësohet përmendësh nga mijëra njerëz nga të gjitha anët e botës, kurse librat e tjerë të shenjtë i gjejmë të ruajtura vetëm si shkrime të shtypura. Po të ndodhë për ndonjë arsye që librat e shkruar në letra të*

*treten nga njerëzit, Kur’ani do të mbetet libri i vetëm i ruajtur në gjoksa”*.<sup>72</sup>

## Përfundim

Argumentet që cekëm deri më tani, tregojnë qartazi se Kur’ani është libër, fjalë e Allahut xh.sh., dhe jo vepër e Muhamedit s.a.v.s., as e arabëve, as e xhinnëve, dhe as kopje e burimeve çifuto-krishtere.

Disa nga karakteristikat kryesore të Kur’anit Famëlartë janë:

- a) Pastërtia në të shprehur.
- b) Transmetimi i lajmeve të padëguara më parë, të ndodhura e të pandodhura.
- c) Mos ekzistenca e gabimeve në të.
- d) Kuptimplotë.
- e) Vërtetësia e lajmeve.
- f) Ligj i përsosur, i përshtatshëm për çdo kohë e çdo vend.
- g) I pajisur me një kod matematikor të admirueshëm e të mrekullueshëm.
- h) Burim i shkencave dhe dijeve.
- i) Sfidë ndaj dijes dhe dijetarëve, etj.etj.<sup>73</sup>

<sup>72</sup> Këto thënie gjinden tek: Zgjimi Islam, viti IX, nr. 5/ Qershorë 2004, Prishtinë, òThëniet e mendimtarëve me famë botërore rreth: Islamit, Kur’anit dhe Muhamedit a.s.ö, Senad Maković; dhe te, M. Fethullah Gylen, òLëkundjet që solli shekulliö, fq. 106.

<sup>73</sup> Muhamed Sytari, Hap pas hapi me òUdhën Islameö, fq. 53-54

Atyre që akoma vazhdojnë të besojnë se Kur’ani është vepër e dikujt tjetër, përveç Allahut xh.sh., u këshilloj të lexojnë ajetin Kur’anorë:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ ۚ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا

كَثِيرًا ﴿٨٢﴾

**“A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur’anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në te shumë kundërthënie”. (En Nisaë 82)**

E, nëse akoma vazhdojnë të jetojnë në botën e ankthit dhe të dyshimit, Zoti i udhëzofte!

Këtë kapitull po e përfundoj me fjalët e Allahut xh.sh. në Kur’anin e Madhërisëm:

وَإِنَّهُمْ لَنَتَنزِيلُ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٩٢﴾

**“E edhe ai (Kur’ani) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve”. (Esh Shuaraë 192)**

وَلَتَعْلَمَنَّ نَبَأَهُ بَعْدَ حِينٍ ﴿٨٨﴾

**“E ju gjithsesi do ta kuptoni pas pak kohe vërtetësinë e tij”. (Sad 88)**

## Fenomeni i shpifjeve rreth shumësisë së bashkëshortëve të Pejgamberit s.a.v.s.

### Hyrje

Shumë njerëz të pandershëm thurrrin shpifje ndaj Muhamedit s.a.v.s., krijesës më të dashur dhe më të përsosur të gjithësisë. Këta armiq të së vërtetës Hyjnore janë përpjekur që të shpifin lloj-lloj të pavërtetash për njeriun më fisnik të mbarë gjinisë njerëzore. Njerëz të pajisur me vese dhe cilësi të ulta, argatë të iblisit e, satanait mundohen që të hedhin baltë mbi njeriun që është shembulli më i mirë dhe më i përkryer i njerëzimit.

Njëra prej çështjeve kryesore për të cilën kundërshtarët e islamit e akuzojnë dhe etiketojnë Muhamedin, është martesja e tij me shumë gra.

Shumë libra dhe revista e paraqesin Muhamedin s.a.v.s. si një njeri i dhënë pas epsheve dhe e etiketojnë në forma të ndryshme, si: ÷Muhamedi pedofilö, ÷Seksualiteti i Muhameditö, etj.. Dua të theksoj se ata që flasin pa menduar për këtë çështje, janë ndër të tillët që nuk lexojnë e as vrasin mendjen për asgjë. Këta njerëz, po që se do të merrnin pakëz mundimin dhe t’u hidhnin një sy librave rreth historisë apo jetës së Pejgamberit Muhamed s.a.v.s., nuk do ta

u lnin veten kaq posht duke bërë kësi shpifjesh. Ka prej tyre që e njohin të vërtetën, por, nga urrejtja dhe mllefi i tyre ndaj Muhamedit s.a.v.s. dhe Islamit në përgjithësi, shpifin gjëra të paqena, vetëm e vetëm të mbjellin farën e dyshimit ndër njerëz të thjeshtë e të pafajshëm nën maskën e punimeve shkencore.

### A ishte Muhamedi s.a.v.s. i dhënë pas epsheve?

Si në të kaluarën, ashtu edhe sot armiqët e islamit nuk pushojnë së shpifuri për njeriun më të dashur të Allahut xh.sh., duke bërë përpjekje që ndër njerëz të mbjellin farën e urrejtjes, të gënjeshtrove e të mashtrimeve për njeriun më fisnik të të gjitha kohërave, vetëm e vetëm që t’u bëjnë të dyshojnë në Pejgamberinë e Muhamedit s.a.v.s. dhe t’u largojnë nga besimi i vërtetë. Është për të të ardhur keq se si disa muslimanë përvetësojnë mendimet e këtyre dhe bien viktima të akuzave të tyre të rrejshme.

Një nga shpifjet është edhe kjo:

*“Muhamedi ishte i dhënë pas epshit, shkante pas dëshirave dhe kënaqësive të tij dhe vepronte nën ndikimin e epshit të tij. Nuk i mjaftoi një grua, as katra si çdo pasuesi të tij, por u martua më shumë se dhjetë herë, siç ia donte epshi dhe dëshira”.*<sup>74</sup>

Në librin ÷A është Muhamedi profet?ö të autorit Joseph Smith, botuar nga shtëpia botuese ÷Tendaö në Prishtinë,

<sup>74</sup> Muhamed Ali Sabuni, ÷Dyshimet dhe të pavërtetat rreth shumësisë së grave të Pejgamberit a.s.ö, Tiranë 2000, fq. 7-8.

thuhen shumë gënjeshtër për Muhamedin s.a.v.s. Në faqen 67-68 të këtij libri do të gjëni një shkrim të titulluar òSeksualiteti i Muhameditò ku thuhet: “*Apostulli i Allahut, që Allahu ta bekojë atë, tha: Gabrielli solli një kazan nga i cili hëngra dhe fitova fuqinë për marrëdhënie seksuale, të barabartë me 40 burra*”.

Për gënjeshtarët si këta Allahu xh.sh. në Kurçanin Famëlartë thotë:

كَبُرَتْ كَلِمَةً تَخْرُجُ مِنْ أَفْوَاهِهِمْ ۚ إِنَّ يَقُولُونَ إِلَّا كَذِبًا ﴿٥﴾

“*Sa e madhe është ajo fjalë që del nga gojët e tyre, e ata nuk thonë tjetër vetëm se gënjeshtër*”. (El-Kehf: 5)

يُرِيدُونَ لِيُطْفِئُوا نُورَ اللَّهِ بِأَفْوَاهِهِمْ وَاللَّهُ مُتِمُّ نُورِهِ

وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ ﴿٥٦﴾ هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ

لِيُظَاهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ ۚ وَلَوْ كَرِهَ الْمُشْرِكُونَ ﴿٥٧﴾

“*Ata duan ta shuajnë dritën e All-llahut me gojët e tyre, po All-llahu e plotëson (e përhap) dritën e vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët. Ai (All-llahu) është që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fe të vërtetë për ta bërë mbizotërues mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë.*” (Es Saff: 8-9)

Vërtet, ata janë urrejtës dhe gënjeshtarë, sepse Muhamedi s.a.v.s. nuk ishte i dhënë pas epshit, por i dërguar nga mesi njerëzorë. U martua si çdo njeri që të jetë shembull i mirë për pasuesit e tij. Muhamedi s.a.v.s. ishte njeri sikur

ata, por të cilin Allahu xh.sh. e veçoi duke e shpallur Pejgamber.

قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُكُمُ إِلَهٌُ وَاحِدٌ ﴿١١٠﴾

“*Thuaj (O Muhamed): Unë jam vetëm njeri sikurse edhe ju, mua më shpallet (më është dërguar shpallja)...*”. (El Kehf: 110)

Pejgamberi nuk ishte i veçuar nga pejgamberët e tjerë, ai nuk kundërshtoi rrugën e tyre, siç thonë të krishterët: “*Ekziston një dallim i madh ndërmjet Isait dhe Muhamedit, dallim mes atij që zotëronte dhe luftonte epshin e vet si Isai, i biri i Merjemes, dhe mes atij që shkante sipas dëshirës dhe epshit të tij, si Muhamedi*”.<sup>75</sup>

Këto pohime hipokrite ndaj Muhamedit s.a.v.s. mund t’i joshin disa jomuslimanë shkurtpamës, madje disa prej tyre mund t’i pranojnë edhe si të vërteta, duke menduar se po veprojnë drejt.

Një poet ka thënë:

“*Nuk është çudi i verbëri ta mohojë dritën e diellit.*

*Nuk është çudi i sëmuari ta mohojë shijen e ujit*”.

Në lidhje me këtë Allahu xh.sh. thotë:

فَأَيُّهَا لَا تَعْمَى الْأَبْصَارُ وَلَكِن تَعْمَى الْقُلُوبُ الَّتِي فِي الصُّدُورِ ﴿٤٦﴾

“*...Në të vërtet sytë nuk verbohen, por verbohen zemrat në krahëror*”. (El Haxh: 46)

<sup>75</sup> Muhamed Ali Sabuni, *vep. e cit.*, fq. 8

Mendimtari dhe shkrimtari britanez, Tomas Karli (1795-1881), i lindur në Skoci, duke folur rreth kësaj çështjeje, ka thënë (The Heroes, fq. 83): *“Muhamedi kurrë nuk ishte njeri i epsheve, pavarësisht nga akuzat e rreme e të padrejta ndaj tij. Ne kemi bërë një gabim të tmerrshëm, kur e kemi konsideruar si një beduin i cili nuk ka brengë tjetër, përveç arritjes së kënaqësive të tij. Pa dyshim, ai ishte njeriu më i largët prej kënaqësive të jetës”*.<sup>76</sup>

Nëse poligamia ishte një gjë e zakonshme në shoqërinë arabe dhe joarabe qysh para Islamit, atëherë pse e trajtojnë të Dërguarin s.a.v.s. si rast të veçantë dhe nuk i kushtojnë vëmendje poligamisë në jetët e profetëve izraelitë gjatë gjithë historisë?

Dr. Mustafa Sibai në librin e tij *“Gruaja mes fikhut dhe ligjit”* thotë: *“Kur isha në Dablin (Kryeqyteti i Irlandës) në vitin 1956, vizitova institutin e Jezuitëve atje dhe mbajta një diskutim të gjatë me drejtorin e Institutit. E pyeta, “Pse e sulmoni Islamin dhe të dërguarin e Tij, veçanërisht në librat tuaj shkollorë? Kjo nuk më duket gjë e duhur për këtë kohë, për kohën e kuptimit në mes njerëzve e kulturave të ndryshme”? Ai u përgjigj, “Ne, perëndimorët nuk mund të rrespektojmë njeriun që është martuar me nëntë gra!” Iu përgjigja: “A i rrespektoni profetët e Allahut, Davudin dhe Sulejmanin a.s.?” U përgjigj, “Po të dy janë prej profetëve të Tevratit”*.

<sup>76</sup> Edukata Islame, nr. 78, fq. 51-52.

I tregova se Davudi a.s. kishte një mijë gra, siç e dimë të gjithë. Ndërsa, siç është cekur në Tevrat, profeti i Zotit, Sulejmani a.s., kishte shtatëqind gra të lira dhe treqind rob-ëshsha, të cilat ishin prej më të bukurave të kohës. Është e rëndësishme, pse duhet të keni respekt ndaj këtyre profetëve, ndërsa sulmoni të Dërguarin s.a.v.s., i cili u martua vetëm me nëntë gra? - e pyeta unë. Heshti për një kohë dhe pastaj më tha: *“Më vjen keq që u shpreha keq. Kisha qëllim të thosha që perëndimorët nuk e rekomandojnë martesën me më shumë se një grua. Neve na duket që personi i cili praktikon poligaminë, është jo normal apo ka pasion të jashtëzakonshëm”. Pastaj e pyeta: “Ç’mendonit për Davudin e Sulejmanin dhe profetët e tjerë të cilët praktikuan poligaminë, duke filluar me gjyshin e tyre, Ibrahimin a.s.?” Kështu, heshti dhe nuk më dha përgjigje”*.<sup>77</sup> Rreth poligamisë në Bibël do të flasim më vonë .

M. Watt në lidhje me Muhamedin s.a.v.s. thotë: *“Pak kush nga njerëzit e mëdhenj të historisë, është vlerësuar aq gabimisht në perëndim sa Muhamedi. Jemi të obliguar t’i përmirësojmë këto shtrembërime, duke iu referuar karakterit virtuoz dhe të lartë të jetës së Muhamedit dhe këmbëngultësisë në thirrjen të cilën Zoti ia besoi atij”*.<sup>78</sup>

Poashtu prof. Bevan dhe W. Montgomery, kur flasin në lidhje për Muhamedin s.a.v.s. thojnë: *“Në Perëndim, asnjë figurë e madhe, gjatë gjithë historisë, nuk është vle-*

<sup>77</sup> Po aty, fq. 52-53.

<sup>78</sup> Ajni Sinani, *“Të tjerët për Islamin”*, fq. 148.

*rësuar me aq tendenca dashakeqe sa është vepruar me Muhamedin*".<sup>79</sup>

### Urtësitë dhe qëllimet e martesave

Në vijim do të lexoni urtësitë dhe qëllimet e martesave të Pejgamberit Muhamed s.a.v.s. me disa gra. Shpresojmë se do të japim argumente të mjaftueshme dhe në këtë mënyrë t'aj hedhim posht gënjeshttrat dhe trillimet që janë thënë për Muhamedin s.a.v.s. rreth kësaj çështjeje. Gjithashtu shpresojmë se rinia jonë do ta kuptojë se Islami është fe e fuqisë, e dinjitetit dhe se në të nuk ka kurrfarë lloj dyshimi e pavërtetësie.

Për të hequr çdo dyshim që bie ndesh me personalitetin e Muhamedit s.a.v.s., do t'aj shtrojmë për diskutim dy çështje shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me martesat e tij.

1. *Pejgamberi- nuk e shtoi numrin e grave, përveç kur ai hyri në moshën e pleqërisë, pra, pas të pesëdhjetave.*
2. *Të gjitha gratë e tij të pastra ishin të veja, përveç Ajshes r.a. e cila ishte beqare.*<sup>80</sup>

Dihet se Pejgamberi s.a.v.s. nuk u martua deri në moshën 25 vjeçare. Po të kemi parasysh klimën posaçërisht të nxehtë të atij vendi dhe jetën e virtytshme gjer në këtë moshë, kuptojmë se ai kishte një vullnet të jashtzakonshëm

<sup>79</sup> Po aty, fq. 152-153.

<sup>80</sup> Muhamed Ali Sabuni, *Vep. e cit.*, fq. 9.

për t'aj zotëruar dëshirat trupore. Po të shmangej qoftë edhe për një çast të vetëm nga rruga e drejtë, atëherë armiqtë e tij, të djeshëm e të sotëm, nuk do të ngurrnin aspak që për këtë ta njoftonin gjithë botën.<sup>81</sup>

Ai jetoi në një klimë jashtëzakonisht të nxehtë, ku dëshirat fizike bëjnë presion të fortë mbi njeriun; kur tek njerëzit zhvillohet shumë herët pjekuria fizike dhe kur një kënaqje e lehtë, ishte gjë e zakonshme në mesin e njerëzve të të gjitha klasave. Megjithatë, Muhamedi s.a.v.s., asnjëherë nuk i afrua grave derisa nuk i pat mbushur njëzet e pesë vjet. Në këtë moshë ai u martua për herë të parë. Në mbarë Arabinë ai qe i njohur për karakterin e tij të padyshimtë dhe e quanin oEl-Eminö (Besnik), një titull që ishte simbol për standardin më të lartë të jetës morale.<sup>82</sup>

Pejgamberi ynë martesën e parë e bëri në moshën 25 vjeçare. Kjo martesë zgjati 25 vjet. Pas vdekjes së bashkeshortës së parë, Pejgamberi s.a.v.s. jetoi si beqar derisa nuk i afrua të pesëdhjetave. Ja, pra, të gjitha martesat për të cilat akuzohet (Muhamedi s.a.v.s.), fillojnë pas kësaj moshe.<sup>83</sup>

Praktika dëshmon se mosha 25-50 vjeçare është periudhë kur epshet e njeriut janë në kulminacion; moshë kur njeriu më së shumti anon kah gjinia femërore. Muhamedi s.a.v.s. tejkalon këtë fazë të jetës së tij duke mos lënë epshet

<sup>81</sup> M. Fethullah Gylen, „Nën hijen e Besimit-2“, fq. 108-109.

<sup>82</sup> Hamude Abdulati, „Islami në Fokus“, Shkup 2000, fq. 338.

<sup>83</sup> Shih, Saffijurrahman El-Mubarekkfuri, *Vep. e cit.*, fq. 136, dhe M. Fethullah Gylen, „Lëkundjet që solli shekulli“, fq. 50.

të dominojnë mbi të. Ai gjatë kësaj kohe nuk i bëri ortakë zonjës Hatixhe .<sup>84</sup>

Po të ishte qëllimi i martesave të tij lëshimi pas epshit apo plotësimi i dëshirave seksuale, ai do të martohej në moshën rinore e jo në pleqëri dhe, natyrisht, do të martohej me beqare dhe jo me gra të veja e të moshuara.

Transmetohet se kur i biri i Abdullahut, Xhabiri, shkoi tek Pejgamberi s.a.v.s., i qeshur në fytyrë, Pejgamberi i tha: òA u martove?ò Tha: òPoò. I tha: òBeqare apo të vejë?ò I tha: òTë vejëò. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. i tha: òPo të martoheshe me një beqare, do të luaje me të, e ajo do të luante me ty, do të qeshje me të, e ajo do të qeshje me tyò.

Pejgamberi s.a.v.s. me këtë rast i propozoi martesën me beqareshë, meqë ai e dinte mirë mënyrën e kënaqjes dhe rrugën e dëshirës dhe a është e logjikshme që dikush të martohet me gra të veja e ti lë beqareshat, të martohet në moshë të shtyer e ta lë moshën e re, nëse ka për qëllim kënaqjen e epshit?

Shtrohet pyetja: Pse Pejgamberi s.a.v.s. nuk u martua me shumë gra në moshën e re? Pse nuk u martua me beqare, por me gra të veja? Pa dyshim se ky qëndrim hedh poshtë çdo thashetheme dhe shpifje nga njerëz të cilët dëshirojnë t'ia njollosin Muhamedit s.a.v.s. autoritetin e tij të pastër.<sup>85</sup>

<sup>84</sup> Irfan Abazi, Taxhedin Bislimi, Faredin Ebibi, Jusuf Zimeri, "E drejta Familjare në Islam", Shkup 1996, fq. 157.

<sup>85</sup> Muhamed Ali Sabuni, *Vep. e cit.*, fq. 10.

Kur mushrikët Kurejshë ia ofruan Muhamedit s.a.v.s. vajzën më të bukur vetëm e vetëm që ta braktiste misionin e tij Islam, ai iu përgjigj negativisht kësaj oferte. Kjo dëshmon se Pejgamberi s.a.v.s. nuk ishte i dhënë pas epsheve, siç e akuzojnë disa.<sup>86</sup>

Martesat e Muhamedit s.a.v.s. nuk bëheshin për shkak të epshit apo dëshirës, por për qëllime fisnike. Këtë do ta pranonin edhe armiqtë e Islamit, sikur ta ndrydhnin fanatizmin dhe xhelozinë që kanë brenda në shpirt dhe të gjykonin me arsye.

Abdullah Nasih Ulvan, kur flet për òMartesat e Muhamedit s.a.v.s. me më shumë se një grua, cek disa nga arsyet dhe rrethanat që e shtynë Muhamedin s.a.v.s. të martohej me më shumë se një grua. Disa nga këto arsye janë: 1. Përhapja e edukimit, 2. Arritja e përkrahjes së Islamit, 3. Perfeksioni i legjislacionit, 4. Solidariteti shoqërorë, 5. Forcimi i lidhjeve shoqërore, 6. Forcimi i një shembulli përfekt për muslimanët.<sup>87</sup>

Dijetarët Islam, duke analizuar thellë këtë çështje kaq të ndjeshme, na bëjnë me dije se urtësitë dhe motivet e martesave të Muhamedit s.a.v.s. bëheshin kryesisht për katër arsye :

1. Urtësia e martesës për motive të dijës.
2. Urtësia e martesës për motive ligjsjellëse (ligjvënës).
3. Urtësia e martesës për motive politike.
4. Urtësia e martesës për motive shoqërore.

<sup>86</sup> E drejta Familjare në Islam, fq. 156-157.

<sup>87</sup> Edukata Islame, nr. 78, fq. 55.



### Urtësia e martesës për motive të dijes.

Duke u martuar me shumë gra, Muhamedi s.a.v.s. kishte për qëllim kualifikimin e një grupi të grave të cilat do tua mësonin grave të tjera rregullat themelore të shariatit. Gratë përbënin gjysmën e shoqërisë, dhe kjo ishte e rëndësishme. Ajo që ishte bërë obligim për burrat, ishte bërë obligim edhe për gratë. Shumë prej tyre kishin turp ta pyesnin Muhamedin s.a.v.s. për disa nga rregullat islame, sidomos për çështjet që i përkisnin natyrës së tyre.

Transmetohet nga Ajshja r.a. se një grua e Ensarëve e kishte pyetur Pejgamberin se si duhej t'ia pastronte të përmuajshmet (menstruacionet). Pejgamberi, i tha: *“Merre një copë pambuk të parfymosur dhe pastrohu me të”*. Ajo i tha: *“Si të pastrohem me të, O i dërguar i Zotit”*. I tha: *“Pastrohu me të”*. Ajo përsëri e pyeti: *“Si të pastrohem me të, O i dërguar i Zotit”*. Ai i tha asaj: *“Subhanallah pastrohu me të”*. Ajshja thotë: *“Ia morra asaj pambukun prej dore dhe i thashë: “Vendose në këtë vend dhe ki vëmendjen ndaj njollave të gjakut”, dhe ia shpjegova asaj vendin se ku duhej ta vendoste atë. Me siguri se Pejgamberi s.a.v.s. kishte turp të shprehej haptazi, por, meqë kishte edhe gra të cilave u vinte turp të shpreheshin lirshëm, atëherë Pejgamberi s.a.v.s. u kërkonte atyre më shumë sqarime lidhur me atë që u interesonte.”*<sup>88</sup>

<sup>88</sup> Muhamed Ali Sabuni, fq. 13, shih edhe tek Edukata Islame, nr. 78, fq. 55 dhe Muhamed Rashid Rida, *“Të drejtat e gruas në Islam”*, Tiranë 2006, fq. 68-69.

Transmetohet nga Buhariu dhe Muslimi se njëherë kishte shkuar Ummi Sulejme, gruaja e Ebu Talhas, te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i kishte thënë: *“O i dërguari i Zotit, Allahu xh.sh. nuk turpërohet nga e vërteta. A duhet të pastrohet gruaja nëse në ëndërr përjeton orgazëm?”* Pejgamberi tha: *“Po, nëse sheh lagështi”*. Ummi Selemeja tha: *“Janë çmendur gratë. A thua edhe gruaja përjetuaka orgazëm në ëndërr?”* Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj: *“Posi, me çka do t'i përngjajë fëmija asaj?”*

Pejgamberi kishte për qëllim t'ia tregonte se foshnja krijohet nga sperma e burrit dhe vezoreja e gruas, prandaj i përngjan nënës.<sup>89</sup>

Përgjigjet për këto pyetje komplekse dhe të ndjeshme, morën përsipër gratë e tij të pastra. Andaj edhe Ajshja r.a. tha: *“Allahu i mëshiroftë gratë e Ensarëve, ngaqë nuk turpërohen të pasurohen me dituri fetare”*.

Shumë gra shkonin natën tek Ajshja për ta pyetur për gjëra që kishin të bënin me menstruacionin, lehoninë, pastërtinë etj.

Pejgamberi s.a.v.s. u martua me shumë gra me qëllim që t'ia mesonte dhe edukonte për Islamin dhe dispozitat e tij; t'ia mësonte dhe edukonte Beduinët dhe qytetarët e tij, qofshin të rinj apo të moshuar. Në këtë mënyrë gratë e Pejgamberit s.a.v.s. u bënë mësueset dhe udhëzueset më të dobishme të fesë Islame pas vdekjes së tij. Ato, në mënyrën më të mirë, perhapën Islamin tek bota femërore. Ky

<sup>89</sup> Muhamed Ali Sabuni, fq. 13-14.

edhe ishte qëllimi i tij. Që ato t'ua transmetonin njerëzve gjërat më specifike të jetës shtëpiake të Pejgamberit s.a.v.s., nga fakti se në jetën e Pejgamberit s.a.v.s. nuk kishte gjëra të fshehura për njerëzit. Nuk ka njeri në histori të cilit i është treguar i gjithë jetëshkrimi pa iu pas fshehur diç nga jetëshkrimi i tij, me përjashtim të Pejgamberit s.a.v.s.. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: *“Tregoni, transmetoni nga unë...”*, në shenjë arsimimi të ummetit dhe udhëzimi të tij.<sup>90</sup>

### Urtësia e martesës për motive ligjsjellëse (ligjvënës)

Urtësia apo qëllimi i dytë ishte martesë për motive ligjvënëse, që është pjesë e qëllimeve të martesës së Pejgamberit s.a.v.s. me shumë gra. Ky qëllim erdhi për largimin e disa traditave paraislame dhe të papëlqyera si p.sh.: çështja e bijësimit të cilët arabët e aplikonin para ardhjes së Islamit. Një veprim i tillë kishte marrë formën e zakonit fetarë që trashëgohej brez pas brezi. E merrte ndokush një fëmijë që nuk ishte nga loza e tij dhe e konsideronte si të ishte fëmija i tij. E konsideronte djalë të vet, sikur djalin nga gjaku në çdo pikëpamje në trashigimi, kurorëzim, martesë, në martesë të ndaluar miqësisht, e shumë zakone të tjera që ishin bërë zakon fetar në xhahilijet, para islamit.

<sup>90</sup> Dr. Jusuf Kardavi, *“Fetva Bashkohore II”*, Prishtinë 2002, fq. 198.

Kur ndokush e bijesonte fëmijën e tjetrit i thoshte: *“Ti je biri im, të trashëgoj dhe të më trashëgoj”*.

Vetë Allahu me madhërinë e Tij e kishte frymëzuar Muhamedin, para se të bëhej Pejgamber dhe t'ia zbriste shpallja, që të birësonte një djalë që e zotëronte Hatixheja, dhe ajo ia dhuroi. Pejgamberi s.a.v.s. e donte shumë atë. Veprimi i Muhamedit s.a.v.s. duhej bërë që të pasohej nga një veprim i mëvonshëm, nga i cili do të merrnin shembull të tjerët, për të shfuqizuar sistemin e birësimit.<sup>91</sup>

Me ardhjen e Islamit e ndaloj këtë gjë që ishte në kundërshtim me natyrën njerëzore dhe nuk i la njerëzit të hutuar në errësirën e injorancës. Pejgamberi s.a.v.s. para shpalljes e bijësoi Zejd ibën Harithin, ashtu siç vepronin arabët. Kështu pra, Muhamedi e bijësoi Zejd ibën Harithin dhe njerëzit filluan ta thirrnin *“Zejd ibën Muhamed”* (Zejdi i biri i Muhamedit).

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi se Abdullah bin Omeri kishte thënë: *“Me të vërtet Zejdin, të birin e Harithit, nuk e thirrnin ndryshe veçse Zejd ibën Muhamed (Zejdi i biri i Muhamedit) derisa nuk zbriti ajeti Kur'anorë: “Ju thirrni ata sipas etërve të tyre. Kjo është më e drejtë te Allahu”*. Atëherë Muhamedi s.a.v.s. i tha: *“Ti je Zejd, i biri i Harithit.”*<sup>92</sup>

Pejgamberi s.a.v.s. e martojë Zejdin me të bijën e Xhahshul Esedijes. Urtësia e Allahut xh.sh. ishte që Zejdi ta

<sup>91</sup> Muhamed Rashid Rida, *Vep. e cit.*, fq. 75.

<sup>92</sup> Muhamed Ali Sabuni, *Vep. e cit.*, fq. 15-16.

shkurorëzohjë Zejneben dhe urdhëroi Muhamedin s.a.v.s. që ta martojë atë, për ta asgjësuar çështjen e bijësimit, t<sup>a</sup> vendosë bazat e shëndosha të Islamit dhe të çrrënjosë xahilijetin.

Pejgamberi frikësohej se hipokritët dhe të këqinjët do të flasin dhe do të thonë: “*Muhamedi e martoi gruan e birit të vet*”, andaj edhe zvarriti, e mbajti të fshehtë një kohë, derisa erdhi urdhëri i Allahut xh.sh. në formë qortuese:

وَإِذْ تَقُولُ لِلَّذِي أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَأَنْعَمْتَ عَلَيْهِ أَمْسِكْ عَلَيْكَ زَوْجَكَ  
وَاتَّقِ اللَّهَ وَخُنْفِيَ فِي نَفْسِكَ مَا اللَّهُ مُبْدِيهِ وَخَشِيَ النَّاسَ وَاللَّهُ أَحَقُّ  
أَنْ تَخْشَاهُ فَلَمَّا قَضَى زَيْدٌ مِنْهَا وَطَرًا زَوَّجْنَاكَهَا لِكَيْ لَا يَكُونَ عَلَى  
الْمُؤْمِنِينَ حَرَجٌ فِي أَزْوَاجِ أَدْعِيَائِهِمْ إِذَا قَضَوْا مِنْهُنَّ وَطَرًا  
وَكَانَ أَمْرُ اللَّهِ مَفْعُولًا

“...E ti e mbaje fshehtë në veten tënde atë që All-llahu do ta zbulojë dhe u frikësohesh njerëzve, por më e drejtë është që t’i frikësohesh All-llahut. E pasi që Zejdi e kishte vendosur atë që kishte menduar ndaj saj, Ne ta kurorëzojmë ty atë, e për të mos pasur besimtarët vështirësi (mëkat) në martesë me gratë e të adoptuarëve të tyre, kur ata heqin dorë prej tyre. E vendimi i All-llahut është kryer”. (El-Ahzab: 37)<sup>93</sup>

Ashtu siç thoshte Aishja r.a., sikur t<sup>a</sup> lejohej Pejgamberit të fshihte diçka nga Revelacioni, do të mbante të fshe-

<sup>93</sup> Po aty, fq. 16, poashtu shih *Nektari i vulosur i xhenetit*, fq. 557-558.

hur ajetet që urdhëronin martesën e tij me Zejneben. Këtë gjë pejgamberi e kishte përjetuar shumë rënd.<sup>94</sup>

Kështu, pra, mori fund birësimi dhe u flakën shumë nga zakonet e mëhershme ndër arabët.. Allahu xh.sh. e futi në mesin e muslimanëve këtë rregull të ri, kur tha:

مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِنْ رِجَالِكُمْ وَلَكِنْ رَسُولَ اللَّهِ  
وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ ۗ وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا

“*Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijsëm për çdo send*”. (El Ahzab 40)

Martesa e pejgamberit s.a.v.s me Zejneben u sherbeu si pretekst qëllimkëqinjve për të shpifur e trilluar për të gjëra nga më të këqijat. Ata akuzuan Muhamedin s.a.v.s se kishte marrë për grua nusen e djalit të tij, që të kënaqte epshin e vet, por kjo qëndron për faktin se Muhamedi s.a.v.s. e njihte Zejneben që nga vogjelia. Vetë Allahu xh.sh. e kishte urdhëruar Muhamedin s.a.v.s. të martohej me Zejneben.

Buhariu transmeton se Zejnebja r.a. shpeshherë krenohet para grave të tjera të Pejgamberit s.a.v.s. duke thënë: “*Juve ju martuan prindërit (familjet) tuaj, ndërsa mua më martoi Allahu xh.sh.*”.

Pra, siç shihet kjo martesë u bë për shkaqe legjislative, ligjvënës dhe me urdhërin e të Urtit e të Gjithëdijshmit.

<sup>94</sup> M. Fethullah Gylen, “*Lëkundjet që solli shekulli*”, fq. 58-59.

Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

وَمَا أُوْتِيتُمْ مِّنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا

“... E juve ju është dhënë vetëm pak dije”. (El-Isra: 85)

### Urtësia e martesës për motive politike

Duke u martuar me shumë gra, Muhamedi s.a.v.s. kishte për qëllim t'ia pajtonte dhe t'ia bashkonte fiset rreth tij. Ai u martua me Xhujerijen, të bijën e Harithit, i cili ishte kryetar i fisit Beni Mustalak. Xhujerija bashkë me popullin e saj ishin zënë rob prej muslimanëve. Ajo i kërkoi Muhamedit s.a.v.s. lirim e saj, duke i ofruar pasuri, por Pejgamberi i kërkoi asaj të martohej me të, ofertë të cilën ajo e pranoi.

Pas martesës së Muhamedit s.a.v.s. me Xhujerijen, muslimanët thanë: “A miqtë e Resulullahut i kemi robëruar”? - dhe i liruan të gjithë robërit. Kur panë pjesëtarët e fisit Beni Mustalak, se sa human ishte Muhamedi s.a.v.s., e pranuan Islam in dhe u bënë prej muslimanëve të mirë.

Martesa e Pejgamberit s.a.v.s. me Xhujerijen pati ndikim të madh në fisin Beni Mustalak. Rreth njëqind familje të këtij fisi e pranuan Islam in. E gjithë kjo ngjarje, e transmetuar nga Aishja r.a., është përshkruar në sahihun e Buhariut.<sup>95</sup>

<sup>95</sup> Muhamed Ali Sabuni, fq. 20, shih edhe tek Edukata Islame, nr. 78, fq. 56-57.

Muhamedi s.a.v.s. gjithashtu u martua edhe me Safijen, të bijën e Huje bin Ahtabit. Ajo që zënë rob pas vrasjes së burrit të saj në luftën e Hajberit. Duke qenë se ajo ishte e bija e parisë së fisit Beni Kurejdha, e dërguan te Muhamedi s.a.v.s. Muhamedi s.a.v.s. ia ofroi dy zgjidhje:

1. Ta lirojë dhe ta martojë atë për vete; ose
2. Ta lirojë dhe të kthehet te familja.

Ajo u martua me Muhamedin s.a.v.s. Kjo martesë ndikoi që Islam in ta pranojnë edhe shumë njerëz të fisit të saj.

Edhe një martesë tjetër Muhamedi s.a.v.s. e bëri për qëllime politike. Ai u martua me Habiben (Remle bint Ebu Sufjan). Në atë kohë Ebu Sufjani ishte bartësi i flamurit të shirkut dhe armiku më i përbetuar i Muhamedit s.a.v.s.. Vajza e tij e pranoi Islam in qysh në Meke. Më vonë, ajo bashkë me burrin e saj bëri hixhret në Abisini për ta ruajtur fenë e vet. Atje asaj i vdiq burri dhe mbeti e vetme, pa shoqërues dhe ndihmës. Kur mori vesh Pejgamberi s.a.v.s. për këtë, i kërkoi mbretit të Abisinisë, Nexhashiut, që t'ia jepte për grua Umi Habiben. Kur Nexhashiu e njoftoi atë për këtë, ajo u gëzua, sepse, po të kthehej te familja e vet, ata do ta detyronin ta braktiste Islam in e të kthehej në kufër, ose do ta dënonin rreptë. Për të Pejgamberi s.a.v.s. dha 400 dinarë sadakë (mehër) duke ia bashkangjitur edhe disa dhurata tjera. Kur u khye ajo në Medinë, u martua me Pejgamberin s.a.v.s.

Kur i shkoi lajmi Ebu Sufjanit ati sikur i pëlqeu një gjë e tillë dhe tha: “S’është punë të mashtrohet ky djalë”. Bile

ai u krenua me Pejgamberin s.a.v.s. dhe nuk e mohoi një gjë të tillë derisa Allahu xh.sh. e udhëzoi në islam.

Martesa e Muhamedit s.a.v.s me të bijën e Ebu Sufjanit, i cili ishte armiku më i përbetuar i tij, ndikoi shumë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy fiseve, aq shumë të armiqësuar deri atëherë. Braktisja e shtëpisë dhe martesa e saj me Muhamedin s.a.v.s. për hir të fesë Islame ishte një nga veprimet e saj shumë të vlerësuara.<sup>96</sup>

### Urtësia e martesës për motive shoqërore

Duke u martuar me të bijën e Ebu Bekrit r.a. dhe me të bijën e Omerit r.a., Pejgamberi s.a.v.s. pati për qëllim të forconte lidhjet e tij shoqërore me miqtë e tij më të mirë. Po për këto qëllime ai u martua edhe me disa nga vajzat e fisit Kurejsh. Në këtë mënyrë Muhamedi s.a.v.s. arriti t'ia bashkonte njërezit rreth Islamit.

Ebu Bekrit r.a., një nga miqtë më të mirë të Muhamedit s.a.v.s. i pari e përqafoi islamit dhe me shpirt, trup e pasuri luftoi për ngritjen e fesë Islame dhe mbrojtjen e Pejgamberit s.a.v.s.

Tirmidhiu transmeton se si Muhamedi s.a.v.s., duke folur për vlerën njerëzore të Ebu Bekrit kishte thënë: *“Kushdo që ndihmon, atë ndihmë do t’ia kompenzojë Allahu xh.sh. ditën e Kijametit”*. *Asnjë pasuri nuk më ka sjellë dobi, sa ndihma e Ebu Bekrit. Nuk ka njeri të cilit ia kam*

<sup>96</sup> Po aty, fq. 22-23.

*paraqitur Islamit e të mos këtë pasur dyshime, përveq Ebu Bekrit, i cili, pa u hamendur fare, e pranoi atë. Po ta kisha marrë si të dashur ndokënd, do ta merrja Ebu Bekrit. Dijeni se ky shok juaji është i dashuri i Zotit”*.<sup>97</sup>

Martesa e Muhamedit s.a.v.s. me Ajshen që nderi më i madhë që ai i bëri mikut të tij të ngushtë, Ebu Bekrit r.a..

Poashtu Pejgamberi s.a.v.s. e nderoi edhe Omerin r.a., duke u martuar me të bijën e tij, Hafsen. Kjo martesë që një qetësim shpirtëror për Omerin r.a. Omeri ishte hero i Islamit, nëpërmjet të cilit Allahu forcoi dhe ngriti lart flamurin Islam .

Gjithashtu Pejgamberi s.a.v.s. i martoi të bijat e veta me Uthmanin dhe Aliun r.a., duke i nderuar në këtë mënyrë dy nga miqtë e tij të ngushtë.

Këta janë katër shokët më të ngushtë të Pejgamberit s.a.v.s., që ndikuan shumë në përhapjen e fesë Islame. Sa urtësi e mirë dhe qëllim fisnik.<sup>98</sup>

<sup>97</sup> Po aty, fq. 18.

<sup>98</sup> Po aty, fq. 19.

### Falsifikimet e viteve të moshës së Pejgamberit s.a.v.s.

Hatixhe bint Huvejlid ishte gruaja e parë e Muhamedit s.a.v.s. me të cilën u martua para se të shpallej Pejgamber. Kur u martua Muhamedi s.a.v.s., ishte 25 vjeç, kurse Hatixheja 40 vjeç. Ajo qe e para që inicoi marrëveshjen e martesës, ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. e pranoi propozimin e martesës.<sup>99</sup>

Hatixhja kishte qenë e martuar dy herë, para se të martohej me Pejgamberin s.a.v.s. Herën e parë me Ebu Hale ibën Zeraren, e herën tjetër me Atik ibën Aidhin.<sup>100</sup>

Muhamedi s.a.v.s kishte 25 vjet martesë me gruan e tij të parë Hatixhen, e jo 5 vjet siç shkruan në librin *o*Muhamedi - A është profet?ö, të autorit Josef Smith. Citoj: *“Muhamedi kishte 5 vjetë martesë me gruan e tij të parë Hatixhen”*.<sup>101</sup>

Në këtë libër poashtu do të gjeni shumë shpifje të tjera rreth Muhamedit s.a.v.s. dhe grave të tij. Hatixhja me Pejgamberin jetoi 25 vjet, 15 para shpalljes dhe 10 pas saj. Pejgamberi s.a.v.s. nuk u martua me ndonjë grua tjetër derisa e kishte Hatixhen.

<sup>99</sup> Hamude Abdulati, *“Islami në Fokus”*, fq. 339, dhe *Nektari i vulosur i xhennetit*, fq. 68.

<sup>100</sup> Muhamed Ali Sabuni, fq. 25, dhe shih *Nektari i vulosur i Xhennetit*.

<sup>101</sup> Josef Smith, *“Muhamedi- A është Profet?”*, fq. 65.

Kur Pejgamberi s.a.v.s. u martua me Zejneb bint Huzejme, ajo i kishte kaluar të gjashtëdhjetat. Nuk jetoi me Muhamedin s.a.v.s. më tepër se dy vjet.<sup>102</sup>

Në periudhën e poligamisë martesat me shumë gra bëheshin edhe për faktin se ato kishin humbur burrat e tyre dhe kishin nevojë për përkujdesje.

Muhamedi u martua me Ummi Seleme Hind el Mahzumije, sepse burri i saj ra shehid në luftën e Uhudit dhe ajo kishte mbetur me katër jetima, pa kujdestar dhe pa mbrojtës. Pejgamberi s.a.v.s. nuk gjeti rrugëdalje tjetër për të dhe fëmijët e saj, pos të martohej me të. Kur Pejgamberi kërkoi të fejohej me të, ajo pak u shqetësua dhe i tha : *“Unë jam shumë e moshuar, jam nënë e katër jetimave dhe jam shumë xheloze”*. Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj: *“Sa u përket jetimave, m’i lër mua dhe lus Allahun xh.sh. që ta largojë nga zemra jote xhelozinë”*, dhe fare nuk i përmendi vjetët. Pas pëlqimit të saj, Pejgamberi u martua me të dhe mori nën përkujdesjen e tij fëmijët e saj, ua hapi zemrën e tij të madhe dhe u tregua edhe më i mëshirshëm ndaj tyre nga ç’kishte treguar babai i tyre i vërtetë.<sup>103</sup>

A thua ka vend për të thënë diçka shpifësit? A mund të ketë këtu vend epshi dhe dëshira? Apo mos vallë edhe këtu nuk gjejnë bujarinë, butësinë, krenarinë, mëshirën, vlerën dhe bamirësinë e Pejgamberit të madh të njerëzimit i cili erdhi si mëshirë për botët.

<sup>102</sup> Muhamed Ali Sabuni, fq. 31.

<sup>103</sup> Po aty, fq. 35.

Muhamedin s.a.v.s. e akuzuan për pedofili kur u martua me Ajshen, derisa ajo ishte e re .

Kulturat fetare e lejojnë martesën nëse personat kanë arritur pjekurinë seksuale. Në vendet e ndryshme të botës është e rregulluar me ligj koha kur të rinjve u lejohej të kenë lidhje seksuale. Edhe këtu ka dallime të shumta. Në Japoni, p.sh., janë të lejuara marrëdhëniet seksuale nga moshë 13 vjeçare, kurse në Spanjë nga moshë 12 vjeçare. Kjo gjithmonë varet nga pjekuria seksuale dhe relacioni i dyanshëm.<sup>104</sup>

Femrat e arrijnë pubertetin në moshë të ndryshme, prej 8 deri 12 vjeç, varësisht nga aspektet gjenetike, raca dhe mjedisi. Femrat në mjedise më të nxehta e arrijnë pubertetin në moshë shumë më të re se ato në mjedise të ftohta. Këto fakte janë të njohura mirë në shkencë. Martesa në vitet e hershme të pubertetit ishte e pranueshme në Arabinë e shekullit VII siç ishte normë në shoqëritë dhe kulturat semitike, duke filluar nga Izraelitët, Arabët dhe të gjitha kombet tjera midis tyre.

<sup>104</sup> Shih tek: <http://www.islamidhekrishterimi.com/ajshe.htm>, tema: ÷Martesa e hershme e Muhamedit me Aishen- sqarim i akuzave nga Halil Ibrahim, poashtu shih sajten në gjuhën angleze më gjërësisht tek: <http://www.bismikaallahuma.org/> ("The Young Marriage of `Aishah" nga Mohd E. N. Juferi) dhe <http://www.understanding-islam.org/related/text.asp?type=question&qid=375&sscatid=362> (What was *Aysha's* (ra) Age at the Time of Her Marriage to the Prophet (pbuh)?, bazuar në ÷Tehqiq e umar e Siddiqah e Ka'inatō nga Habib ur Rahman Kandhalvi, Anjuman Uswa e hasanah, Karachi, Pakistan.

Talmudi, i cili nga Hebrejtë konsiderohet si -Tora gojore, Sanhedrin 76 b, thotë: "*Është e preferueshme për femrat që të martohen kur të kenë menstruacionet e para*".<sup>105</sup>

Akuzave të misionarëve të krishterë kundrejt Muhamedit dhe martesës së tij me Ajshen u mungojnë dëshmitë themelore. *Po të ishte martesa e tij me Ajshen diçka e pazakontë dhe e dyshimtë, do të kishte mospajtime si nga ithtarët e tij e aq më tepër nga kundërshtarët e tij.*

Po të ishte kjo martesë diçka e jashtëligjshme dhe abuzive siç duan ta paraqesin disa të krishterë, atëherë kundërshtarët e tij do ta përdornin këtë me gjithë qejf në luftën e tyre propaganduese kundër tij. Por diçka e tillë nuk është regjistruar asnjëherë.

Ajshja ishte më e reja prej grave fisnike të Pejgamberit s.a.v.s. dhe padyshim më e zgjuara prej tyre. Me zgjuarsinë dhe dijen e saj ajo ua kishte kaluar edhe shumë burrave. Shumë prej sahabëve të Pejgamberit s.a.v.s. shkonin dhe kërkonin prej Ajshes t'ua shpjegonte dispozitat fetare.

Urvete bin Zubejri thotë: "*Nuk kam parë grua më të dijshe nga lëmia e fikhut, mjekësisë dhe poezisë se sa Aishja r.a.*". Kjo nuk është aspak e çuditshme, ngase të gjitha koleksionet e Hadithit dëshmojnë për një gjë të tillë. Vetëm dy prej sahabëve kanë transmetuar hadithe më shumë se Ajshja, Abdullah ibën Amri dhe Ebu Hurejra.

Transmetuesit kanë përmendur që numri i haditheve të transmetuara nga gratë e Muhamedit s.a.v.s. është më shu-

<sup>105</sup> Po aty.

më se dy mijë. Nga gratë e Muhamedit, Ajshja është transmetuesja me numrin më të madh të hadithëve të Muhamedit s.a.v.s. Ajo transmetoi afërsisht 2210 hadithe. Pastaj Umu Seleme r.a., e cila transmetoi rreth 378 hadithe, ndërsa të tjerat transmetuan rreth 11 hadithe. Ky ndryshim në transmetimin e hadithëve ndodhi ose për shkak të vigjilencës, zgjatjes së jetës familjare apo gjatësisë së jetës pas vdekjes së Muhamedit s.a.v.s. Të gjitha këto arsye kanë qenë privilegje të Aishes r.a., pasi ajo ishte më e talentuara prej tyre. Për të përmbledhur, një prej arsyeve të poligamisë së Muhamedit s.a.v.s. mund të jetë bashkpunimi i vërtetë në transmetimin e hadithëve, pra pjesmarrja në ndërtimin dhe ruajtjen e sheriatit e sunetit.<sup>106</sup>

Roli i Ajshes r.a. nuk kufizohet vetëm në transmetimin e hadithëve. Ajo u mor edhe me jurisprudencë. Dituria e saj për jurisprudencën ishte e tillë, sa që imam Zerkeshiu thotë: *”Çereku i rregullave juridike janë transmetuar nga Ajshja. Në të vërtetë, Ajsheja ishte një juriste e madhe. Ajo jepte mendimet e saj për çështjet fetare gjatë halifatit të Ebu Bekrit, Omerit dhe Othmanit r.a. Njerëzit e pyesnin për shumë gjëra derisa vdiq, kurse gjykatësit shkonin të zgjidhnin disa nga problemet e tyre.”*<sup>107</sup>

Pra, gratë me të cilat qe martuar Pejgamberi s.a.v.s., që të gjitha ishin vejusha ose të ndara nga burrat e tyre, me përjashtim të Ajshes. Asnjëra nga gratë e ndara dhe veju-

<sup>106</sup> Edukata Islame, nr. 78, fq. 61

<sup>107</sup> Po aty, fq. 71

shat nuk ishte e njohur për bukurinë dhe sharmin e tyre. Disa nga këto gra ishin shumë të moshuara.<sup>108</sup>

Ai u martua me një femër kopte nga Egjipti, me një hebreje të religjionit dhe të racës tjetër, me një vajzë zezake nga Abisinia. Ai nuk kënaqej vetëm kur i mësonte njerëzit për vëllazërin dhe barazinë, por atë që ua mësonte, edhe e mendonte, edhe e zbatonte në praktikë njëkohësisht.<sup>109</sup>

## Poligamia në Bibël

Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلًا مِّن قَبْلِكَ وَجَعَلْنَا لَهُمْ أَزْوَاجًا وَذُرِّيَّةً ﴿١٧٨﴾

**“Ne dërguam edhe para teje të dërguar dhe atyre u mundësua të kenë gra dhe fëmijë”.** (Err-Rrad, 38)

Citati Kur'anor tregon qartazi se edhe Pejgamberët tjerë para Muhamedit s.a.v.s. kishin patur gra dhe fëmijë. Këtë e dëshmon edhe Bibla, e cila gjithashtu flet për poligaminë:

a) *“Por Saraj, gruaja e Abramit, nuk i kishte dhënë asnjë fëmijë. Ajo kishte një shërbyese egjiptase, që quhej Agar. Kështu Saraj i tha Abramit: “Ja, Zoti më ka ndaluar të kem fëmijë; oh, futu te shërbyesja ime, ndoshta mund të kem fëmijë prej saj”. Dhe Abrami dëgjoi zërin e Sarajt... mori shërbyesën e saj Agarin, egjiptasën, dhe ia dha për grua burrit të saj Abramit. Dhe ai u fut tek Agari, që mbeti me barrë...”.* (Zanafilla 16:1-5)

<sup>108</sup> Hamude Abdulati, *Vep. e cit.*, fq. 341

<sup>109</sup> Po aty, fq. 345



- b) “Dhe Jakobi hyri gjithashtu te Rakela dhe e dashuroi atë më tepër se Lean”. (Zanafilla 29:30)
- c) “Atëherë Jakobi u ngrit dhe i vuri bijtë e tij dhe gratë e tij mbi devetë”. (Zanafilla 31:17)
- d) “Por mbreti Salomon, veç bijës së Faraonit, dashuroi shumë gra të huaja, moabite, amonite, idumeje, sidonie dhe hiteje.... Ai pati si bashkëshorte shtatëqind prince-sha dhe treqind konkubina”. (1 Mbretërve 11:1,3)
- e) “Ata që do të mbijetojnë pas tij do të varrosen nga vde-  
kja dhe të vejat e tyre nuk do të qajnë”. (Jobi 27:15)<sup>110</sup>

Ligjet e mëparshme lejonin martesat me shumë gra. Ibrahim i a.s. u martua me Sarën e pastaj me Haxherën. Jakubi u martua me katër gra: Zelhën, Belhin, Rakelën dhe Lean, kurse Gedeoni, i biri i Joashit, u martua me shumë gra. Në librinö Gjykatësitorë 8:30 thuhet: “Ai kishte 70 meshkuj që kishin dalë prej kurrizit të tij, sepse ai kishte shumë gra”.<sup>111</sup>

Në Dhjatën e Vjetër thuhet se Davudi a.s. ishte martuar me shumë gra (shih: 2 Samuelit 12:8). Emrat e grave të Davudit a.s. përmenden në librin 2 Samueli 3:2-5).<sup>112</sup> Gjithashtu, duke folur për rregullat e ndarjes së pasurisë së

<sup>110</sup> Për më tepër rreth Poligamisë në Bibël, shih tek: Tahir Kukaj, “Besueshmëria e citateve Kur’anore dhe atyre Biblike”, Prishtinë 2005, fq. 147-150, dhe, Mohamed Ghonem, “200+ ways the Quran corrects the Bible”, Brooklyn NY, fq. 76-77.

<sup>111</sup> Rahmetullah El-Hindi, “Triumfi i të vërtetës”, fq. 154.

<sup>112</sup> Po aty, fq. 154.

babait midis djemve, flitet për dy gra si diçka normale, pa pas turp (shih: Ligji i Përtërirë 21: 15-17). Për pasojë, tek feja çifute përfshihet martesat me shumë gra.<sup>113</sup> Për më tepër shih citatet që flasin për Poligaminë tek: Zanafilla 4:19/ 25:6/ 26:34/; 1 Samuelit 1:1-2; 2 Samueli 12:7-8; 1 Kronikave 4:5; 2 Kronikave 11:21/ 13:21/ 24:3; Mateu 25:1, etj.

Gjatë kohës së shpalljeve biblike, poligamia u pranua nga pikëpamje religjioze, sociale dhe morale, pa kurrfarë vërejtje. Në atë kohë Poligamia ishte gjë e zakonshme. Ndoshta kjo është edhe arsyeja pse vet Bibla nuk merret me këtë çështje. Bibla këtë as nuk e ndalon, as nuk e rregullon, e madje as nuk e kufizon.<sup>114</sup>

Në besimin hebrej një njeri mund të kishte qindra gra. Teverati e lejon haptaz poligaminë. Deri kah gjysma e shekullit tetë dhe koha e Charlemagneit poligamia ishte fenomen i zakonshëm në Evropë dhe kisha këtë nuk e gjykonte.<sup>115</sup> Të gjithë profetët e përmendur në Tevrat, pa përjashtim, patën shumë gra.

Mendimtari egjiptian, Abas Mahmud el-Akadi thotë: “Nuk ka poligami të kufizuar në Tevrat ose në Bibël; ajo është e lejuar dhe u atribuohet vetë profetëve, duke filluar nga profeti Ibrahim e deri tek lindja e Isait”.<sup>116</sup>

<sup>113</sup> Dr. Beqir Topallioğlu, “Gruaja në Islam”, Stamboll 2000, fq. 102.

<sup>114</sup> Islami në Fokus, fq. 320.

<sup>115</sup> Sejjid Muxhteba Musavi Llari, “Islami dhe civilizimi perëndimor”, fq. 172.

<sup>116</sup> Edukata Islame, nr. 77, fq. 142.

Sa i përket Krishterimit, nuk ka ndonjë tekst që në mënyrë të qartë e ndalon poligaminë. Ungjilli nuk sjell asnjë dispozitë lidhur me këtë çështje. Por, në disa nga Letrat e Palit, ka dëshmi që tregojnë se poligamia është e lejuar. Ai thotë: “... është e obligueshme për peshkopin të ketë vetëm një grua”.

Historia ka vërtetuar se disa të krishterë të hershëm janë martuar me më shumë se një grua dhe se në mesin e themeluesve të hershëm të kishës kishte prej atyre që kishin disa gra.<sup>117</sup>

Askush nuk ka të drejtë të thotë se kristianizmi është ai që e detyron qytetarin e botës perëndimore të ketë vetëm një grua. Kristianizmi si religjion nuk e ka ndaluar haptas martesën me shumë gra. Këtë e kundërshtonin vetëm peshkopët dhe dhjakët. (shih: 1 Timoteut 3:2,12)... Asnjëri nga Koncilët e shekujve të parë të krishterimit nuk e kishte kundërshtuar martesën me shumë gra.

Në mjaft raste, vetë Luteri (themelues i Protestantizmit), flet për martesën me shumë gra: òkjo gjë (martesa me shumë gra) nuk është e ndaluar nga Zoti.. Pa dyshim, krahasuar me divorcin, martesa me shumë gra parapëlqehet më shumë. (Koestlin, Martin Luther, I, fq.347, dhe II, fq. 693)ö<sup>118</sup>

<sup>117</sup> Po aty, fq. 142.

<sup>118</sup> Dr. Beqir Topalliglliu, “Gruaja në Islam”, fq. 107-108.

Pra, nëse qenka kështu, atëherë përse gojëkëqinjtë çojnë në qaq pluhur për Muhamedin s.a.v.s. dhe për numrin e bashkëshorteve të tij dhe flasin fjalë të ndyta kundër tij?!

Allahu xh.sh. në suren El-Haxh, ajeti 46, i konsideron këta si njerëz që nuk shohin, edhe pse kanë sy, sepse zemrat e tyre janë të vdekura:

فَأَنبَا لَا تَعْمَى الْأَبْصَرُ وَلَكِن تَعْمَى الْقُلُوبُ الَّتِي فِي الصُّدُورِ ﴿٤٦﴾  
 “Në të vërtetë sytë nuk verbohen, por verbohen zemrat në krahëror”.

## Përfundim

Nga sa u tha më lart, kuptojmë se Pejgamberi s.a.v.s. nuk u martua me shumë gra për shkak të epshit, kënaqësisë, ose për shkak të të mirave të kësaj bote, por filozofia e martesës së tij me to ishte bashkimi i njerëzve rreth fesë Islame.

Pra, duke u martuar me shumë gra, Pejgamberi s.a.v.s. kishte për qëllim bashkimin e njerëzve, nxitjen e tyre në Islam, si dhe zgjidhjen e problemeve të shumta shoqërore. Ai ishte shembull për muslimanët në të gjitha fushat e jetës.

Qoftë kur u martua me grua të re a të moshuar, arabe ose jo arabe, të bukur a të shëmtuar; qoftë kur u martua me të bijën e mikut a të armikut, Muhamedi s.a.v.s. mbetet shembulli më i mirë për çdo musliman.<sup>119</sup>

<sup>119</sup> Dr. Jusuf Kardavi, “Fetva Bashkohore II”, fq. 199.

Kushdo që dyshon në integritetin moral apo në dëlirësinë shpirtërore të Muhamedit s.a.v.s. duhet t'ua gjej përgjigje adekuate pyetjeve që vijnë: Pse zgjodhi një grua që ishte dy herë vejushë dhe pesëmbëdhjetë vjet më e moshuar se ai? Pse gjithmonë martohej me vejusha? Pse bëri një jetë të tillë, të vrazhdë dhe të rëndë, kur pati mundësi të jetonte një jetë të lehtë dhe të begatë? Pse e bëri shumicën e martesave në pesë vitet më të zëna të jetës së tij, kur misioni dhe kariera e tij ishin në rrezik? Po ta kishte kapluar jeta e kënaqësive dhe e epsheve, si ia arriti të ishte ai që ishte? Kjo çështje nuk është aq e thjeshtë, sa të mund të interpretohet vetëm me anë të dashurisë mashkullore dhe dëshirës për gra. Kjo është një thirrje për mendim dhe për analizë më të thellë.<sup>120</sup>

Të gjitha bashkëshortet e Pejgamberit s.a.v.s. ishin të veja, përveç Ajshes. Po të mbizotëronte epshi në zemrën e tij, ai do të martohej me beqare në rini.

Urrejta e thellë që i ka kapluar zemrat e kundërshtarëve të Muhamedit s.a.v.s., ua ka verbuar sytë dhe nuk e shohin të vërtetën e ndritshme.

Po e përfundoj me fjalët e Allahut xh.sh., i cili thotë:

<sup>120</sup> Islami në Fokus, fq. 341-342.

بَلْ نَقَدِفُ بِالْحَقِّ عَلَى الْبَاطِلِ فَيَدْمَغُهُ فَإِذَا هُوَ زَاهِقٌ

وَلَكُمْ أَلْوِيلٌ مِمَّا تَصِفُونَ ﴿١٨﴾

**“Përkundrazi, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën dhe ajo (e vërteta) triumfon mbi të ndërsa ajo (gënjeshtria) zhduket”.** (El Enbija: 18)

يُرِيدُونَ لِيُطْفِئُوا نُورَ اللَّهِ بِأَفْوَاهِهِمْ وَاللَّهُ مُتِمُّ نُورِهِ

وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ ﴿٨﴾ هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِأَهْدَى

وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ وَلَوْ كَرِهَ الْمُشْرِكُونَ ﴿٩﴾

**“Ata duan ta shuajnë dritën e All-llahut me gojët e tyre, po All-llahu e plotëson (e përhap) dritën e vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët. Ai (All-llahu) është që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fe të vërtetë për ta bërë mbizotërues mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë”.** (Es Saff: 8-9)

Prandaj, lutja jonë e fundit është: **“Gjithë falënderimet dhe lavdërimet qofshin për Allahun, zotin e botëve!”**

Mendime objektive të dijetarëve me famë  
botërore rreth Islamit, Kur'anit dhe Muhamedit  
S.a.v.S.

**Thënie rreth Fesë Islame**

Në këtë kapitull do të përmbledhim fjalët dhe mendimet e disa mendimtarëve të shquar botëror, të cilët, pas studimeve të thella, kanë dhënë deklaratat e tyre për fenë Islame, Kur'anin e Madhërisëm dhe për Muhamedin s.a.v.s. Feja Islame, e cila iu shpall Muhamedit s.a.v.s., ishte dhe mbetet vazhdimi dhe kulminacioni i të gjitha religjioneve të shpallura të të gjitha kohëve. Pra, këtë herë nuk do t'aj gjurmojmë thëniet e dijetarëve islamë, por do të paraqesim pohimet e jo-ithtarëve të Islamit, një pjesë e të cilëve u konvertuan në muslimanë.<sup>121</sup>

**TOMAS ARNOLD** ÷Thirrja në Islamö - *“Ne asnjëherë nuk kemi dëgjuar për ndonjë përpjekje për të detyruar jo-muslimanët për të pranuar Islamin apo për ndonjë*

<sup>121</sup> Të gjitha këto citate që do të cekën më poshtë i gjeni në këto burime: Dituria Islame: Nr. 1, viti 1986; Nr. 20, viti 1990; Nr. 22-23, viti 1991; Nr. 24, viti 1991; Nr. 25, viti 1991; Nr. 30-31, viti 1991; Nr. 36 viti 1992; Nr. 51, viti 1993; Nr. 71, viti 1995; Nr. 98, viti 1998; Nr. 99, viti 1998

*persekutim të organizuar që ka për qëllim zhdukjen e Krishterimit. Në qoftë se halifët do të kishin zgjedhur një nga këto plane, ata do ta kishin fshirë Krishterimin nga faqa e dheut po aq lehtë siç u bë me Islamin gjatë kohës së Ferdinandit dhe Isabelës në Spanjë; me të njëjtën metodë që ndoqi Luigji XIV për ta bërë Protestanizmin një besim ndjekësit e të cilit dënoheshin me vdekje; apo me të njëjtën lehtësi që u mbajtën hebretë larg Britanisë për më tepër se 350 vjet...”*

**DE LACY O'LEARY** ÷Islam at the Crossroadsö, London, 1923, pp. 8 - *“Historia, ndërkaq, na mëson se legjenda mbi muslimanët fanatikë që kaluan botën me furi dhe që i detyruan racat e pushtuara ta përqaфонin Islamit nën majat e shpatave të tyre, është njëra ndër mitet më absurde fantastike, të cilën historianët ndonjëherë e kanë përsëritur.”*

**M. L. STODDARD** ÷The Religion of All Prophetsö, Pakistan, pp. 56 - *“Ngritja e Islamit është mbase ngjarja më e çuditshme në historinë e njerëzimit. Duke buruar nga një vend dhe nga një popull i papërfillur më parë, Islami brenda një shekulli u përhap në më shumë se gjysmën e rruzullit tokësor duke zhdukur perandori të mëdha, duke përmbysur religjione më të vjetra, duke reformuar shpirtërat e forcave dhe duke ndërtuar një botë të re, botën e Islamit”.*

**W. MONTGOMERY** ÷Watt, Islam and Christianity Todayö, London, 1983, pp. IX.- *“Mendoj se shprehjet e ngulitura në Kur'an dhe shprehjet e tjera të vizionit isla-*

*mik janë një thesar i madh i së vërtetës hyjnore, nga të cilat unë dhe oksidentalistët e tjerë mund të mësojmë akoma shumë. Islami është një luftëtar i fuqishëm për të na dhënë skeletin themelor të një religjioni të së ardhmes.”*

**H. A. R. GIBB** ÷Wither Islamö, London, 1932, pp. 379.-  
*“Mirëpo, Islami ka për t’i ofruar kauzës së njerëzimit edhe një shërbim. Fundja, ai qëndron më afër Lindjes së njëmendte sesa Evropa dhe posedon një traditë të shkëlqyer të mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet racave. Asnjë shoqëri tjetër nuk ka arritur sukses më të madh në bashkimin e më shumë racave të ndryshme njerëzore... Islami e ka ende fuqinë e pajtimit të elementeve, në dukje të papajtueshme, racore dhe të traditës.”*

Gjithashtu për Islamin flasin edhe CANNON TAYLOR, SAROJINI NADIU, G.B. SHAW, A.J. TOYNBEE, EDWARD MONTET, e shumë të tjerë.

## Thënie rreth Kur’anit Famëlartë

Ne dimë se çëndjenja ngjall ky libër për ata që e lexojnë në gjuhën e pastër dhe të qartë arabe, si i zëvendëson idetë dhe mendimet, si ndryshon ndjenjat shpirtërore duke shkaktuar dridhje në emocionet e njeriut dhe sikur i thotë lexuesit dhe dëgjuesit me zë të heshtur se *“unë nuk jam libër si librat e tjerë, nuk jam vepër si veprat e tjera, nuk jam....”*

Pjesa dërmuese e orientalistëve janë të një mendimi se teksti i Kur’anit dallon nga të gjitha tekstet e librave të shpallur fetar. Kur’ani është i ruajtur nga çdo e metë, i pandryshuar; atë nuk e ka prekur dorë e huaj, nuk është shtuar as hequr asgjë nga teksti origjinal i tij. Mbeti i njëjtë gjatë gjithë historisë, siç i ishte shpallur Muhamedit s.a.v.s., i shkruar në letër, i ruajtur në zemrat e njerëzve fjalë për fjalë, verset për verset dhe kaptinë për kaptinë. Që nga momentet e para të zbritjes së Kur’anit, Muhamedi s.a.v.s. bashkë me shokët e tij e lexonin atë, e mësonin përmendsh dhe e shkruanin me pendë. Pra, qysh në fillim Kur’ani dallohet për dy elemente të shëndosha që nuk i kanë librat e tjerë. Këto elemente bënë që ai përfundimisht të tubohej me një saktësi dhe besnikëri të lartë dhe të mbetet i saktë, gjeneratë pas gjenerate deri në ditët e sotme.

**SUSEH** (orientalist çifut) - Kur bën dallimin në mes tekstit kur’anor dhe librave të tjerë qiellorë, vërteton faktin për zëvendësimet dhe ndryshimet që pësuan librat e shenjtë

te çifutët dhe te krishterët. Kjo është një e vërtetë për të cilën të gjithë mendimtarët e mirëfillt të religjioneve pajtohen. “*Kur’anin muslimanët e ruajtën me besnikëri dhe emanet të lartë. Ai është libri i vetëm i shenjtë, i ruajtur dhe i shpëtuar nga devijimet dhe ndryshimet eventuale. Studiuesit e huaj të Kur’anit shpeshherë gjuajnë shigjeta helmuese kundër Islamit, mirëpo realiteti dhe argumentet historike janë më se të qarta, ato nuk lënë vend për dyshim, sepse Kur’ani në të vërtetë nuk pësoi ndryshime dhe modifikime. Është më se e vërtetë se ai që nuk e njeh gjuhën arabe, sintaksën, gramatikën dhe retorikën e saj, asnjëherë nuk mund të kuptojë rëndësinë dhe ajkën e Kur’anit*”.

**LANDO** (orientalist çifut) - “*Osmani r.a. bëri një punë të madhe rreth Kur’anit. Ai kishte ngarkuar Zejd ibën Thabitin që të bënte tubimin e ajeteve në formë të librit, dhe që nga ajo kohë Kur’ani mori formën e tij zyrtare për të arritur tek ne, i shëndoshë, pa ndonjë ndryshim, sado i vogël qoftë ai.*”

**LORA FAGLIRI** (studiuese Italiane) - “*Deri te brezi ynë, Kur’ani është përcjellë me një transmetim të përpiktë përmes një zinxhiri të pashkëputur dhe teksti i tij mbeti i pastër, i pandryshuar gjatë shekujve, dhe i tillë do të mbetet derisa të ekzistojë jeta në sipërfaqen e tokës.*”

**BLASHIRI** (orientalist francez) - “*Merita më e madhe për ruajtjen e Kur’anit, pas Pejgamberit, i takon halifit Osman r.a. në vitin 655 h. i cili me kohë kishte vërejtur rrezikun që filloi t’i kanosej Kur’anit me lindjen e për-*

*çarjeve rreth leximit të drejtë të tij. Ai kishte formuar komisionin për verifikimin e shkrimit origjinal të Kur’anit, ashtu siç kishte zbritur në kohën e Muhamedit, duke mos lejuar futjen e asnjë elementi të huaj në të ose largimin e ndonjë pjese prej tij.*”

**DI KASTRO** (studiues francez) - “*Neve, evropianëve, deri tani nuk na është dhënë rasti të kuptojmë domethënien e saktë të Kur’anit, ndoshta pse nuk arritëm të kuptojmë metodën e ligjërimit të tij, apo pse doktrina e tij ishte kundër disa parimeve tona dhe nuk përputhej me mentalitetin tonë, mirëpo injorimi ynë kurrsesi nuk do të thotë se Kur’ani nuk ishte dhe nuk vazhdon të jetë libër hyjnor me ndikim të madh në psikologjinë e njeriut.*”

**FILIP HITI** për metodën e ligjërimit të Kur’anit thotë: “*Ajo është aq e lartë, saqë nuk mund të krahasohet me të tjera, nuk mund të kopjohet, të emitohet etj.*”

**XHORXH SARTUN** (studiues amerikan) - “*Gjuha e Kur’anit konsiderohet si gjuhë e Zotit, ajo është e plotë në një definim dhe përcaktim të tillë; kjo ka bërë që gjuha arabe të ngrihet më lart se çdo gjuhë tjetër e botës.*”

**NASRIJ SELEHEB** - “*Gjuha e tij është aq e lartë dhe superiore, saqë është e pamundur për joarabin ta kuptojë dhe të ndiejë kënaqësinë dhe bukurinë e saj. Është gjuhë që e zgjodhi Zoti dhe e bëri më të vlefshme se çdo gjuhë tjetër, kurse Kur’ani është vlera më e çmuar e saj, sepse është Fjala e Allahut.*”

*Gjithashtu, Nasrij Seleheb tregon se si sahabët i çmonin citatet e Kur'anit më të shtrenjta nga çdo thesar i tokës. Ai gjithashtu pohon faktin se asnjë nga librat e tjerë hyjnorë nuk pati kujdesin që pati Kur'ani, asnjë nga librat e tjerë nuk arriti t'i shpëtonte ndërhyrjes së dorës së njeriut, siç arriti Kur'ani."*

**ZHAK VISLER** (studiues francez) - *"Çdo përkthim i Kur'anit, qoftë ai edhe i shkollës më të lartë, nuk mund të jetë zëvendësim i tij. Që të kuptohet drejt, ai duhet të lexohet me gjuhën e tij, e nuk ka gjuhë në botë që mund ta zëvendësojë atë. Përkthimi i Kur'anit është i ngjashëm me shkëputjen e lules nga rrënjët e saj."*

**RISLER** - *"Kur'ani, përveç që është libër fetar, në vete përmban edhe esencën e të gjitha njohurive. Aty njeriu gjen zgjidhje për të gjitha çështjet."*

**MARSIL** (orientalist francez) - *"Kur'ani është fjalë e gjallë në zemrat e shumë njerëzve-hafëzëve, është ndërmjetësues në mes njeriut dhe Allahut, udhëzues shpirtëror, sistem moral dhe ligji i botës. Ai nuk është libër që i dedikohet vetëm një shoqërie ose një periudhe të caktuar kohore. Kur'ani është libër me një ligj të përjetshëm, të plotë dhe të përsosur. Është Fjala e fundit e Zotit, e cila nuk shtrembërohet dhe nuk zëvendësohet; libër i cili njeriut i ligjëron përmes ndjenjave të tij të brendshme, mendjes dhe natyrës së tij krijuese."*

**LJUBILDD WEISS** (studiues i Kur'anit) - *"Tani e kuptova se libri të cilin e mbaja në dorë ishte libër i shpallur nga Zoti, libër të cilit, edhe pse kaloi në duart e njerëzve*

*më tepër se 13 shekuj, studiuesit nuk arritën t'ia zbulojnë fshehtësitë filozofike. Nga Kur'ani mua më del një zë më madhështor sesa zëri i Muhamedit a.s.. Kur'ani, që u ligjërohej arabëve në shekullin VII dhe tundte thellësitë e tyre shpirtërore, ka edhe sot të njëjtën fuqi, si për lexuesin e shekullit të XX-të, ashtu edhe për atë të shekullit të XXV-të".*

**Një i krishterë Indian** thotë: *"Kur'ani është libri i vetëm qiellor, i cili mësohet përmendsh nga mijëra njerëz nga të gjitha anët e botës, kurse librat e tjerë të shenjtë i gjejmë të ruajtura vetëm si shkrime të shtypura. Po të ndodhë për ndonjë arsye që librat e shkruar në letra të treten nga njerëzit, Kur'ani do të mbetet libri i vetëm i ruajtur në gjoksa".*

Gjithashtu si **DERMINGEMI** (orientalist francez), **SIDJU** (orientalist francez), **JOGEL** (orientalist anglez), **ZHAN ZHAK RUSOI**, **GOETHE**, **DR. STEINGASS**, **MAURICE BUCAILLE**, **ARTHUR J. ARBERRY** etj. etj., tregojnë se Kur'ani është libër i Zotit dhe jo vepër e Muhamedit s.a.v.s..

### Thënie rreth Muhamedit s.a.v.s.

Të gjithë dijetarët botëror, të cilët e kanë studiuar biografinë e Pejgamberit të Islamit në mënyrë objektive, në fund kanë dëshmuar për madhësinë e personalitetit të tij. Po përmendim disa nga ta:

**NAPOLEONI** - Napoleoni i parë (1769-1821), imperator i Francës, në histori njihet si një burrë shteti dhe luftëtar i madh. Në vitin 1812, kur hyri në Egjipt, u mahnit pas drejtësisë dhe madhësisë së besimit Islam. Rreshtat e poshtëshënuar janë marrë nga vepra *ōBonaparte et Islamō* të Cherfilsit. Napoleoni thoshte:

*“Musai (a.s.) popullin e vet, Isai (a.s.) ithtarët e vet, kurse Muhamedi (a.s.) tërë botën e ka lajmëruar se ekziston Allahu i Madhërishtëm dhe është vetëm Një. Në Gadishullin Ballkanik dominonte paganizmi. Gjashtë shekuj pas Isait, Muhamedi (a.s.) ua predikoi arabëve Allahun e Madhërishtëm, për të cilën u munduan edhe Ibrahim (a.s.), Isai (a.s.), Musai (a.s.). Arianëve (të krishterët që i takojnë Ariusit), që iu bashkangjitën arabëve dhe atyre që dëshironin të përhapnin një besim të ri me tre zota (Allahu, i biri i Allahut, Shpirti i Shenjtë) me qëllim që të prishnin krejtësisht rehatinë dhe paqen në lindje, Muhamedi a.s. ua tregoi rrugën e drejtë. U tha arabëve se Allahu (xh.sh.) është Një dhe Ai as nuk ka baba, e as bir. Besimi në shumë zota është një zakon i pakuptimtë, që ka mbetur nga paganizmi”.*

Në një pjesë tjetër të librit gjenden këto fjalë të Napoleonit: *“Mendoj se së shpejti do të kem mundësi të formoj një shtet ku do t’i tuboj të gjithë personat e dalluar e të mençur të botës dhe ta udhëheq këtë shtet sipas parimeve të shkruara në Kur’an. Besoj vetëm në drejtësinë e këtyre parimeve islame, dhe në sajë të këtyre parimeve njerëzit do ta arrijnë lumturinë.”*

**ANNIE BESANT** - *ōThe life and Teachings of Muhammadō*, Madras, 1932, p.p. 4. - *“Kushdo që studion jetën dhe karakterin e Pejgamberit të madh të Arabisë dhe që e di se si mësoi dhe jetoj ai, do të ndiejë diçka tjetër, përveç respektit të thellë ndaj tij. Shumë nga këto që po i them, më janë të njohura që më parë, po megjithatë, sa herë që i rilexoj, më kaplon një ndjenjë e re admirimi dhe respekti ndaj mësuesit të madh arab”.*

**W. MONTGOMERY** *ōMohammad at Meccaō*, Oxford, 1953, p.p. 52. - *“Gatishmëria e tij për të përjetuar persekutime për shkak të besimit, morali i lartë i njerëzve që i besonin dhe që e konsideronin udhëheqës, si dhe madhështia e arritjeve të përnjëhershme, dëshmojnë për integritetin e tij. Ta konsiderosh Muhamedin mashtrues, më shumë shkakton probleme sesa i zgjidh ato”.*

**DR. MICHAEL H. HEART** - Në librin e tij të famshëm *ōKlasifikimi i 100 personaliteteve me ndikim më të madh në historiō* thotë: *“Vënia e Muhamedit a.s. në krye të listës së personaliteteve më me influencë në histori, mund t’i befasojë lexuesit, por e vërteta është se ai ishte njeriu më i suksesshëm në aspektin fetar e jetësor. Ai*



*ishte i vetmi që e kompletoi misionin e tij fetar, i përsosi ligjet e fesë dhe në të besuan popuj të tërë gjatë jetës së tij. Përveç përsosjes së fesë, ai themeloi edhe shtetin e ri, duke i bashkuar fiset në popull dhe popujt në umet. Dhe për umetin e vet vuri bazat e jetës së tij fetare. Ai, pra, e filloi misionin e tij fetar dhe jetësor dhe e përfundoi atë”.*

**ENCIKLOPEDIA BRITANICA** - “Muhamedi ishte Profeti më i suksesshëm i të gjithë Profetëve dhe personaliteteve religjioze.”

**BERNARD SHOW** - “Unë jam thellë i bindur se, sikur një personalitet i rangut të Muhamedit të sundonte botën e sotme, do të kishte sukses në zgjidhjen e problemeve botërore dhe do ta çonte botën kah paqja dhe shpëtimi.”  
 “Në kohën e tashme, shumë nga të afërmit e mi evropianë kalojnë në fenë e Muhamedit dhe mund të thuhet se konvertimi i Evropës në Islam tashmë ka filluar”.

**EMILE DERMENGHEM** - “Muhamedi është sigurisht një Profet nga radha biblike”.

**LA MARTINE** - Historian francez, në librin e tij *Historia e Turqve*, duke folur për Muhamedin s.a.v.s. thotë: “Filozof, orator, profet, ligjvënës, luftëtar, ngadhënjimtar idesh, rilindës i sërishëm i fesë së logjikës dhe Zotit, pa idhuj dhe afreke; themelues i njëzet mbretërive të botës dhe i një mbretërie shpirtërore. Ai është Muhamedi”.  
 “Muhamedi është më pak se një Zot- një Profet.”

**OTO VON BIZMARK** - “O Muhamed, më vjen keq që nuk isha bashkëkohësi yt!”

**MAHATMA GANDHI** - “Feja Islame urdhëron që të adhurohet Allahu dhe vepra e Tij. Ndërkohë që Perëndimi ishte në një errësirë të tmerrshme, ylli Islam në Lindje kishte sjellë rehati, paqe dhe dritë. Feja islame nuk është gënjeshitare... Unë i kam lexuar veprat lidhur me jetën e Profetëve të besimit Islam dhe atyre që janë pranë tij. Këto vepra ma kanë tërhequr shumë vëmendjen, saqë, kur i përfundova, më erdhi keq që nuk kishte më. Unë nxora përfundimin se përhapja kaq e shpejtë e fesë islame nuk është bërë për shkak të dhunës... Njerëzit me dëshirë e kanë pranuar fenë islame. Në myslimanizëm nuk ka ndërmjetësues ndërmjet Allahut dhe robit të tij. Meqë krishtërimi kishte shumë mungesa, ishte e nevojshme të bëheshin reforma të ndryshme. Kurse në myslimanizëm çdo gjë është ashtu siç ka qenë në fillim. Nuk ka qenë nevoja për asnjë ndryshim.”

**LLAV NIKOLLAJEVIQ TOLSTOJ** - “S’ka dyshim se Profeti Muhamed është një ndër reformatorët më të mëdhenj të njerëzisë. Atij i takon lavdi më e madhe, sepse njerëzinë e udhëzoi drejt dritës më të madhe, drejtësisë dhe paqes, e pengoi derdhjen e gjakut të pafajshëm njerëzor dhe kështu i hapi rrugën përparimit dhe civilizimit. Këtë vepër të madhe nuk do të mund ta zbatonte askush tjetër, përveç një njeriu me fuqi mbinatyrore”.

**RILKE** - “Kurrë s’ka lexuar, kurse tani-shiko! Një fjalë e tillë dhe për dijetarin është e paarritshme.”

**EDWARD GIBBON DHE SIMON OCKLAY**, “*History of the Saracen Empire*”, London, 1870, p.p. 54. – “Unë besoj në një Perëndi dhe në Muhamedin a.s., të Dërguarin e Perëndisë. Ky është predikim i thjeshtë dhe i pandryshuar i Islamit. Imazhi intelektual i Hyjnisë asnjëherë nuk është degraduar me ndonjë idhull të dukshëm. Nderimet e Pejgamberit kurrë nuk e tejkaluan masën e virtytë njerëzore, kurse parimet jetësore të tij e mbajtën mirënjohjen e ithtarëve të vet brenda kufijve të arsyes dhe fesë”.

Po ashtu Gibboni, në librin e tij “*Ngritja dhe shkatërrimi i Perandorisë Romake*”, jep mendimin e tij për Kur’anin dhe fenë Islame: “Në fenë e Muhamedit nuk ka vend për dyshim, kurse Kur’ani është dritë e dëshmisë për njëshmërinë e Zotit”.

**TOMAS CARLYLE** ó “Ka pasur edhe njerëz të tjerë që kanë predikuar monoteizmin, por asnjë s’ka qenë i barabartë me besimin e tij të fortë dhe të pastër në një Zot.”

**BOSWORTH SMITH** ó “Muhamedi ishte krijues i ume-tit, themelues i perandorisë dhe rimëkëmbës i fesë në të njëjtën kohë. Atij, edhe pse analfabet, i është shpallur libri që përmban letërsi, jurisprudencë, norma morale të përgjithshme, si dhe libra të shenjtë, të përfshirë në një libër. Dhe ai e ka shenjtërinë e vet edhe sot e kësaj dite në një të gjashtën e njerëzimit”.

Po ashtu, si JAMES H. HEART, JAMES A. MICHE-  
NER, FERLONG, S. H. LEEDER, JOHN WILLIAM  
DRAPER, CARL BRACKELMANN, D. V. BODLY,  
ANDRIN SERVE, JULES MESERMAN, edhe shumë me-  
ndimtarë të tjerë të shquar botëror kanë dhënë mendimet e  
tyre mbi Islamit dhe Profetin Muhamed s.a.v.s.

## Literatura

1. Kur'ani ó Përkthim me komentim i H. Sherif Ahmetit.
2. Bibla ó Diodati i Ri përkthim 1991-94.
3. Abdulati, Hamude, “*Islami në Fokus*”, Shkup 2000.
4. Bucaille, Dr. Maurice, “*Bibla, Kur’ani dhe Shkenca*”, Gjakovë (pa vit botimi).
5. Bislimi, Taxhedin, “*Hyrje në shkencën e Usuli Fikhut*”, Shkup 2003.
6. Cvitkovi , Dr. Ivan, *ðRjeçnik religjijski pojmová*”, Sarajevo 2005.
7. Deedat, Ahmed, “*Kur’ani- Mrekullia e mrekullive*”, Podujevë (pa vit botimit).
8. El-Mubarekfuri, Saffijjurr Rahman, “*Nektari i Vulosur i Xhennetit*”, Prishtinë 2001.
9. Esh-Sharavi, Muhamed Muteveli, “*Mrekullia e Kur’anit*”, Prishtinë 1996.
10. El-Hindi, Rahmetullah, “*Triumfi i të Vërtetës*”, Shkup 1998.
11. *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë 1980.
12. Findley, Paul, “*Mjaft me heshtje*”, Shqipëri 2004
13. Gylen, M. Fethullah, “*Nen hijen e Besimit-2ð*”, Tiranë 2004.
14. Gylen, M. Fethullah, “*Lëkundjet që solli shekulli*”, Tiranë 1998.
15. Ghonem, Mohamed, “*200+ ways the Quran corrects the Bible*”, Brooklyn NY.
16. Ibrahim, Halil, “*Islami dhe Krishterimi*”, botim i parë 2004
17. Imam Neveviu, “*Rijadus-Salihin*”, Prishtinë 1997
18. Irfan Abazi, Taxhedin Beslimi, Faredin Ebibi, Jusuf Zimeri, “*E drejta familjare në Islam*”, Shkup 1996
19. Jahja, Harun, “*Mrekullitë e Kur’anit*”, Stamboll 2002
20. Jahja, Harun, “*Popujt e zhdukur*”, Stamboll 2002
21. Kukaj, Tahir, “*Besueshmëria e civateve Kur’anore dhe atyre Biblike*”, Prishtinë 2005.
22. Kardavi, Dr. Jusuf, “*Fetva Bashkohore II*”, Prishtinë 2002.
23. Lings, Martin, “*MUHAMMAD, his life based on the earliest sources*”, Australia 1983.
24. Musavi Llari, Sejjid Muxhtebe, “*Islami dhe Civilizimi Perëndimorë*”, Gjilan 2004.
25. Murtezai, Ekrem, “*Fjalori i feve*”, Prishtinë 2000.
26. Nicholas, Mustafa Steven & Nelson, Tariq, “*Kush e shkroi Kur’anin*”, Prishtinë 2006.
27. Nijazi, Hamza Mustafa, “*Burimet e Kur’anit*”, Mitrovicë 1996.
28. Rida, Muhamed Rashid, “*Të drejtat e gruas në Islam*”, Tiranë 2006.
29. Sytari, Muhamed, “*Përpjekje të dështuara*”, Shkodër 2003.
30. Sytari, Muhamed, “*Hap pas hapi me ‘Udhën Islame’*”, Shkodër 2004
31. Sinani, Ajni, “*Të tjerët për Islamín*”, Prishtinë 2005
32. Sabuni, Muhamed Ali, “*Dyshimet dhe të pavërtetat rreth shumësisë së grave të Pejgamberit a.s.*”, Tiranë 2000

33. Smith, Joseph, “*Muhamedi- A është Profet?*”, Prishtinë 2001
34. Topalliogllu, prof. Dr. Beqir, “*Gruaja në Islam*”, Stamboll 2000
35. Topbash, Osman Nuri, “*Frymera meshire nga Muhamedi*”, Stamboll 2004
36. Një pyetje drejtuar dijetarëve musliman dhe përgjigja e A. Guliamit, Tiranë 2005
37. Edukata Islame, nr. 24, Prishtinë 1979
38. Edukata Islame, viti XXXV, nr. 77, Prishtinë 2005
39. Edukata Islame, nr. 78, Prishtinë 2006
40. Takvim 1993, Prishtinë, “*Jomuslimanët për Kur’anin*”- Hajrullah Hoxha
41. Dituria Islame, viti IX, nr.178, Maj 2005, Prishtinë, “*Koncepti i Zotit në Bibel dhe në Kur’an*” ó Senad Makoviq
42. Dituria Islame, viti IX, nr.180-181, Korrik - Gusht 2005, Prishtinë, “*Koncepti Pejgamberik në Bibel dhe në Kur’an*” ó Senad Makoviq
43. Dituria Islame: Nr. 1, viti 1986; Nr. 20, viti 1990; Nr. 22-23, viti 1991; Nr. 24, viti 1991; Nr. 25, viti 1991; Nr. 30-31, viti 1991; Nr. 36 viti 1992; Nr. 51, viti 1993; Nr. 71, viti 1995; Nr. 98, viti 1998; Nr. 99, viti 1998.
44. Zgjimi Islam, viti IX, nr. 5/ Qershorë 2004, Prishtinë, “*Thëniet e mendimtarëve me famë botërore rreth: Islamit, Kur’anit dhe Muhamedit a.s.*”- Senad Makoviq
45. [www.islamidhekrishterimi.com](http://www.islamidhekrishterimi.com)

## Përmbajtja

Parathënie.....	5
<b>Fenomeni i shpifjeve ndaj Kur'anit Famëlartë .....</b>	<b>11</b>
Hyrje.....	11
A është Muhamedi autorë i Kur'anit.....	14
Përfitimi material si motiv?.....	20
Dëshira për pushtet dhe lavdi? .....	24
Bashkimi dhe çlirimi i arabëve?.....	26
A janë Arabët autorë të Kur'anit? .....	34
A janë xhinët autorë të Kur'anit?.....	39
A është Kur'ani kopje e burimeve hebreo-krishtere?.....	41
KUR'ANI ó Fjala e përjetshme e Zotit drejtuar njerëzimit.....	49
Kur'ani është padyshim vepër e Allahu xh.sh.....	64
Përfundim.....	68
<b>Fenomeni i shpifjeve rreth shumësisë së bashkëshortëve të Pejgamberit s.a.v.s. ....</b>	<b>71</b>
Hyrje.....	71
A ishte Muhamedi s.a.v.s. i dhënë pas epsheve?.....	72
Urtësitë dhe qëllimet e martesave .....	77
Urtësia e martesës për motive të dijes.....	81

Urtësia e martesës për motive ligjsjellëse (ligjvënës) .....	83
Urtësia e martesës për motive politike .....	87
Urtësia e martesës për motive shoqërore.....	89
Falsifikimet e viteve të moshës së Pejgamberit s.a.v.s.....	91
Poligamia në Bibël .....	96
Përfundim .....	100

### Mendime objektive të dijetarëve me famë botërore

#### rreth Islamit, Kur'anit dhe Muhamedit s.a.v.s. ....103

Thënie rreth Fesë Islame .....	103
Thënie rreth Kur'anit Famëlartë.....	106
Thënie rreth Muhamedit s.a.v.s.....	111
Literatura .....	117
Përmbajtja .....	121

**Shpifjet ndaj të vërtetave Islame**

Autori:

**Senad Maku**

E-Mail kontaktues:

**senad\_maku@yahoo.com**

**senadmaku@gmail.com**

Shtypi: **“Mozaiku”** Podujevë

Botim Privat

Tirazhi: 1000

Katalogimi në botim ó (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

297

Maku, Senad

Shpifjet ndaj të vërtetave Islame / Senad Maku. -  
Botimi 1. - Prishtinë : Autori, 2007 (Podujevë :  
Mozaiku). - 124 f. ; 17 cm.

Parathënie : f. 5-9. - Literatura : f. 117-119

**ISBN 978-9951-8736-0-4**